

Qershor 2018
Numri: 123
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



INJORANCA E ARSIMUAR



revistaetika



progresibotime

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Qershor 2018

VITI: XII

NUMRI: 123

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Të thuash: **“Unë jam mysliman”** nënkupton marrjen e disa vendimeve në lidhje me këtë botë dhe tjetrën.

Të thuash: **“Unë jam mysliman”** ka kuptimin e të mos harruarit të vërtetën se **“Ahireti është jeta e vërtetë”**. Myslimani jeton i djegur nga malli e dashuria për jetën e përjetshme, për jetën e vërtetë.

Sigurisht që ky vendim nuk është aq i lehtë sa mund t'i duket gojës.

Ky është një vendim që duhet të mbahet i gjallë vazhdimisht dhe kërkon një shpirt delikat, që mund ta mbajë gjallë këtë ndjenjë.

Kjo nuk është e mundur nëse nuk ekziston ajo që quhet **“vetëdija për frymën e fundit”**.

Nëse një vetëdije e tillë kthehet në disiplinë jete, myslimani është vazhdimisht i shqetësuar dhe pyet veten: **“Po sikur kjo të jetë fryma ime e fundit”**. Askush nuk e di se kur do e japë frymën e fundit prandaj dëshira e flaktë për të vdekur si mysliman është pjesë thelbësore e ndjeshmërisë së shpirtit të myslimanit.

Për të realizuar këtë dëshirë, myslimani duhet të bëjë kujdes në të gjitha fushat e jetës. Ai e vëzhgon jetën e vet me kujdes. I kalon nga radari si zemrën ashtu edhe veprat. Jeta e myslimanit sillet rreth e rrotull pyetjes: **“Kur Zoti im hedh sytë aty, çfarë shikon?”**. Myslimani vëzhgon në mënyrë të detajuar qëllimet e veta, veprat dhe lidhjen mes qëllimit dhe veprës. I vëzhgon me qëllimin për të kuptuar nëse janë në përputhje me atë që kërkon Allahu.

Mënyra më e mirë për të gjykuar jetën tonë është duke marrë parasysh shembullin e Resulullahut tonë të nderuar.

- Si mund ta vendosim sërish në krye **“Njeriun mysliman të mëshirës”**? Tani që njerëzimi është i etur për Islam dhe për thirrjen e Rrahmanit, cilit mysliman mund t'ia drejtojmë gishtin e të themi me krenari: **“Ja një mysliman që e përfaqëson bukur Islamin”**? Nënë myslimane, baba, fëmijë, grua, burrë, të ri, plak, drejtues, biznesmen, punëtor, të pasur, të varfër... Njeri... Sa do kemi mundësi që t'i shfaqim botës cilësitë njerëzore?

Islami është poema e jetës. Ajo është një poemë që fillon me **“Amentu”** dhe vazhdon për sa kohë marrim e japim frymë duke mos harruar asnjëherë lidhjen me **“Krijuesin”**. Nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për kujdesin e të genit falënderues në çdo moment, për drejtimin e vendit apo për sjelljen ndaj të gjitha krijesave... Edhe gjërat e vogla si buzëqeshja, rrudhja e vetullave e zemërimi kanë masat e tyre... Ashtu si është gabim që të zemërohesh pa të drejtë, ashtu është gabim që të mos zemërosh aty ku e kërkojnë ligjet e Allahut... Edhe dashuria ka masën e saj, ashtu edhe urrejtja...

Të gjithë pohojmë se **“Jam mysliman”**. Prandaj ka rëndësi jetike që të pyesim veten: **“A jam unë mysliman?”**



Ma'kil ibn Sinan El-Eshxha
Mustafa Erish

18

Përmbajtja



12

Injoranca e arsimuar
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan



Shpirti nuk mund të ketë festë
pa vaujtur nëfsi
Osman Nuri Topbash

34



30

22


Shqetësohu, ji besnik, ji trëndafil!
Halit Jasir Ozogyl



- 5 Disiplina e llogaritjeve
Ahmet Tashgetiren
- 7 Ta akuzosh si mosbesimtar
atë që thërret tekbinin(!)
Ali Riza Temel
- 10 Jemi në mes të xhihadit
Nuredin Jëlldëz
- 11 Le ta rrisim bashkimin në duart tona
Xhemal Nar
- 14 Duaja e Hz. Ibrahimit dhe brezit prijës
Xhafer Durmush
- 16 Në lidhje me "Ululhijet"-in
Prof. dr. Irfan Gyndyz
- 20 Si të shpëtojmë nga kurthi i hedonizmit?
Ajnur Tutkun
- 23 Pëshpëritjet e së vërtetës
Ali Byjyqçapar



- Sulejman Pasha 24
Dr. Ardian Muhaj
- Dy lloje pushtimesh 28
Edison Çeraj
- Imagjinata dhe realiteti 29
Urtësi
- Planeti në të cilin lind dielli nga perëndimit 30
Muaz Erdem
- Një Ajet-Një Hadith 32
- Kabid-Basit 40
Ilir Hoxha
- Refleksione -4 42
Nuredin Nazarko
- Ismail Muçej, jeta dhe vepra 44
Gilman S. Kazazi
- Rrugët moderne që të shpien në imoralitet 46
Sami Byjykkajnak
- Aventura martesore 52
Esin Akdeniz Tyxhar



26

Ibrahimi: persekutim,
shpëtim dhe përtëritje
Hatem Bazian



Kitheu tek Allahu
Ferit Piku

48

Disiplina e llogaritjeve

— Ahmet Tashgetiren —

Të thuash: **“Unë jam mysliman”** nënkupton marrjen e disa vendimeve në lidhje me këtë botë dhe tjetrën.

Të thuash: **“Unë jam mysliman”** ka kuptimin e të mos harruarit të vërtetën se **“Ahireti është jeta e vërtetë”**. Myslimani jeton i djegur nga malli e dashuria për jetën e përjetshme, për jetën e vërtetë.

Sigurisht që ky vendim nuk është aq i lehtë sa mund t’i duket gojës.

Ky është një vendim që duhet të mbahet i gjallë vazhdimisht dhe kërkon një shpirt delikat, që mund ta mbajë gjallë këtë ndjenjë.

Kjo nuk është e mundur nëse nuk ekziston ajo që quhet “vetëdija për frymën e fundit”.

Nëse një vetëdije e tillë kthehet në disiplinë jete, myslimani është vazhdimisht i shqetësuar dhe pyet veten: **“Po sikur kjo**

të jetë fryma ime e fundit”. Askush nuk e di se kur do e japë frymën e fundit prandaj dëshira e flaktë për të vdekur si mysliman është pjesë thelbësore e ndjeshmërisë së shpirtit të myslimanit.

Për të realizuar këtë dëshirë, myslimani duhet të bëjë kujdes në të gjitha fushat e jetës. Ai e vëzhgon jetën e vet me kujdes. I kalon nga radari si zemrën ashtu edhe veprat. Jeta e myslimanit sillet rreth e rrotull pyetjes: **“Kur Zoti im hedh sytë aty, çfarë shikon?”**. Myslimani vëzhgon në mënyrë të detajuar qëllimet e veta, veprat dhe lidhjen mes qëllimit dhe veprës. I vëzhgon me qëllimin për të kuptuar nëse janë në përputhje me atë që kërkon Allahu.

Mënyra më e mirë për të gjykuar jetën tonë është duke marrë parasysh shembullin e Resulullahut tonë të nderuar.

Një njeri që nuk e njeh jetën e Resulullahut dhe nuk e kupton se sa thellë i kishte groposur ai vlerat e veta, e ka të pamundur të bëjë llogaritë e jetës së vet.

Mbase problemi më i madh i myslimanëve të sotëm është fakti që nuk është zbuluar një makineri që ekzekuton “Disiplinën e llogaritjeve”. Le të supozojmë se në momentin kur ftojme dikë për **“të bërë llogaritje”**, nëse ky është njeri i kënaqur nga vetja, nuk do të çuditemi aspak nëse na përgjigjet: **“Pse çfarë kam keq unë?”**. Si mund ta gjykojmë në mënyrë të saktë se sa e dimë Kuranin, sa e njohim jetën shembullore të Resulullahut, sa e duhur është jeta jonë private dhe ajo si ymet, sa përshtatet jeta jonë me rregullat që na ka vendosur Krijuesi?



Kur flasim për “**Llogarinë**” në mendje vijnë shumë pyetje:

- Mbase duhet ta fillojmë me një pyetje tronditëse: “**A jam unë mysliman?**”. Shumë dijetarë të kohëve tona kanë shkruar libra me këtë titull duke vendosur në pyetje, fillimisht jetën e tyre dhe më pas atë të të gjithë ymetit. Drejtimi i pyetjes “**A jam unë mysliman?**” dhe mundësia për t’iu përgjigjur sinqerisht: “**Elhamdulillah**” mbase është themeli i të gjitha “**Llogaritjeve**”.

- Po namazi ynë a është i saktë? A nuk ke frikë se kur të shikosh Resulullahun, ai do të thotë: “**Namazi yt nuk ka qenë i saktë.**” A ta shkruajnë melekët namazin? A ka ndonjë namaz diçka që në Ditën e Gjykimit do të na përplaset në fytyrë? A na jep namazi vetëdijen se jemi në prani të Allahut?

- A e ka gjallërinë e duhur fjala e shehadetit? A e themi gjithmonë me dashuri dhe emocion?

- A janë dashuritë tonë “**Dashuri për hir të Allahut?**” Po zemërimet tona, a janë ato “**Zemërimet për hir të Allahut?**”

- Po kur shohim jetën tonë familjare, a jemi të sigurt se po mbajmë mbi vete “**Kodet e një familjeje myslimane?**”

- Në aspektin e jetës profesionale, në rolet që na jepen, a kemi atë që quhet: “**Personalitetet mysliman?**”

- Cilat janë llogaritë në lidhje me “**Lavdinë e Islamit?**” Fjalët e poetit: “**Ymeti më fisnik ishte ai i Muhamedit**”, a janë thënë për ymetin e ditëve tona? Çfarë kemi humbur dhe çfarë ka ndodhur? A ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë mes fatkeqësive që po përjeton sot ymeti dhe cilësisë së myslimanëve të ditëve të sotme?

- A jemi të vetëdijshëm për fuqinë tonë?

- Pse jemi nën shënjestrën e terrorizmit? Pse nuk shpëtojmë dot prej tij? Si na i grabitën zemrat e fëmijëve tanë? Cila vorbull i shkatërroi karakteret tona?

- Sa e fortë është lidhja jonë me diturinë? A prodhojmë dituri të fuqishme sa për të ndriçuar

fushat e të gjithë njerëzimit?

- Si mund ta vendosim sërish në krye “**Njeriun mysliman të mëshirës?**” Tani që njerëzimi është i etur për Islam dhe për thirrjen e Rrahmanit, cilit mysliman mund t’ia drejtojmë gishtin e të themi me krenari: “Ja një mysliman që e përfaqëson bukur Islamin”? Nënë myslimane, baba, fëmijë, grua, burrë, të ri, plak, drejtues, biznesmen, punëtor, të pasur, të varfër... Njeri... Sa do kemi mundësi që t’i shfaqim botës cilësitë njerëzore?

Islami është poema e jetës. Ajo është një poemë që fillon me “**Amentu**” dhe vazhdon për sa kohë marrim e japim frymë duke mos harruar asnjëherë lidhjen me “**Krijuesin**”. Nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për kujdesin e të qenit falënderues në çdo moment, për drejtimin e vendit apo për sjelljen ndaj të gjitha krijesave... Edhe gjërat e vogla si buzëqeshja, rrudhja e vetullave e zemërimi kanë masat e tyre... Ashtu si është gabim që të zemërohesh pa të drejtë, ashtu është gabim që të mos zemërosh aty ku e kërkojnë ligjet e Allahut... Edhe dashuria ka masën e saj, ashtu edhe urrejtja...

Të gjithë pohojmë se “**Jam mysliman**”. Prandaj ka rëndësi jetike që të pyesim veten: “**A jam unë mysliman?**”

Që prej këtij momenti, le të përdorim një “**Fletore llogaritjesh**” në të cilën do të shënojmë të gjitha pyetjet e mësipërme dhe çdo ditë të kontrollojmë veten duke shtuar pluse e minuse. Njeriu që e humb disiplinën e të bërit llogaritje, në ditën kur t’i vijë libri i veprave do të shkatërrohet krejtësisht kur të shoh se çfarë ka bërë.

Në fund do t’i thuhet: “**Lexoje librin**” ose “**Shikoje filmin e jetës tënde**”. Në atë moment duhet të dalin faqebardhë. Nuk duhet të jemi prej atyre që do të thonë: “Oh mos, si ka mundësi që nuk është lënë pas dore asnjë gjë sado e vogël, qenkan shkruar të gjitha, një nga një...” Myslimani duhet të jetë prej atyre që do t’i thuhet: “**Hajde në mesin e robërve të Mi, eja në Xhenetin Tim**”.



Që prej këtij momenti, le të përdorim një “Fletore llogaritjesh” në të cilën do të shënojmë të gjitha pyetjet e mësipërme dhe çdo ditë të kontrollojmë veten duke shtuar pluse e minuse. Njeriu që e humb disiplinën e të bërit llogaritje, në ditën kur t’i vijë libri i veprave do të shkatërrohet krejtësisht kur të shoh se çfarë ka bërë.



Ta akuzosh si atë që thërret

— Ali Riza Temel —

Fitimi më i madh arrihet kur shpëton besimin, rrjedhimisht edhe Ahiretin e një njeriu. Gjatë luftës së Hajberit, Hz. Pejgamberi (a.s.), i tha Hz. Aliut: *“Betohem në Allah se të bërit shkak për udhëzimin e një njeriu është më e mirë se të kesh deve të kuqe.”* (Buhari, Xhihad, Numri i hadithit: 2942.) Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: *“më i mirë se bota dhe çdo gjë e saj.”*

Asgjë nuk ka më shumë vlerë se të bëhesh shkak që një njeri të udhëzohet me Islam. Mbrojtja e vëllait në fe është më e çmuar se mbrojtja e vëllait biologjik. Në fund të fundit, vëllai i vërtetë mund të mos jetë mysliman. Në një rast të tillë, vëllazëria nuk ka më kuptim. Nuk ka dyshim se një vëllazëri e bashkuar nga feja dhe lidhjet familjare është akoma më e bukur. Myslmani fillimisht e ka për detyrë që të bëhet besimtar shembullor më pas të bëjë përpjekje për t'i udhëzuar edhe njerëzit e tjerë.

Myslmanët, në vend që të shtojnë miqësinë, tolerancën dhe dashurinë në mesin e tyre; janë futur në një garë që në vend të fitojnë miq, shtojnë numrin e armiqtë. E thënë ndryshe, në vend që ta bëjnë jobesimtarin mysliman, po i bëjnë myslimanët jobesimtarë.

Sëmundja e tekfirit (supozimi se një njeri ose një grup njerëzish kanë devijuar nga feja) filloi me harixhitë.

Tekfiri bëhet kur fyhet një njeri, kur myslimanin e quajmë jomyslman. Akuzimi i një myslimani si jo-besimtar, pavarësisht faktit se ai nuk ka asnjë shenjë të tillë; sjell ndëshkim të rëndë. Akuzimi i vëllait mysliman si pasojë e urrejtjes, injorancës ose shpërblimit; është e njëjtë me vendosjen e dinamitit në mesin e ymetit.

Sipas Ehli Sunetit, edhe nëse kryen gjynahe të mëdha, ehli-kible nuk mund të quhet jomyslman. Ideja e gabuar që e sheh myslimanin si jobesimtar është më e rëndë se gabimi që e sheh jobesimtarin si mysliman. Nëse njeriu ka 99% mundësi të jetë

MOSBESIMTAR TEKBIRIN(!)



jobesimtar dhe vetëm 1% që të jetë mysliman, është më mirë që të shikohet si mysliman. Në të kundërt, ai njeri është privuar në pafundësi.

Në lidhje me fajin e madh që bëhet duke e mallkuar dhe duke e quajtur jobesimtar një mysliman, Hz. Pejgamberi (s.a.v) ka thënë: “Ai që e mallkon besimtarin është sikur ta ketë vrarë atë, ai që e akuzon me mosbesim është si ta ketë masakruar atë.” (Buhari, Edeb, 44.) “Askush të mos e akuzojë tjetrin si jobesimtar. Nëse personi i akuzuar nuk është jobesimtar, kjo do të kthehet tek akuzuesi.” (Buhari, Edeb, 44.)

Esenca e besimit është në zemër, ndërsa gjuha është për të rrëfyer besimin. Duke qenë se ne nuk e kemi të mundur që të lexojmë zemrën dhe qëllimin e njerëzve, mjaftohemi duke marrë për bazë deklaratat e njeriut. Ne gjykojmë duke u bazuar tek e dukshmja, sepse të fshehtën e di vetëm Allahu. Në vend që t'i akuzojmë njerëzit për të cilët kemi dyshime, mund të krijojmë distancë me to. Ky distancim nuk është i prerë, por është i tillë sa nuk lejon afrimet të tepruar.

Teksa i gjykojmë njerëzit, nuk duhet të bazohemi tek kriteret subjektive si dashuria, urrejtja dhe interesi, por tek gjërat objektive. Mos të harrojmë se dashuria, urrejtja dhe interesi e bëjnë njeriun e verbër dhe shurdh. Gjykimi është i saktë kur bazohet në prova materiale.

Dëshirojmë që t'i ilustrojmë më mirë rrjedhajat e një gjykimi të gabuar, me ndihmën e një historie.

Midras b. Melik i popullit Fedek, ishte i vetmi që ishte bërë mysliman, në rrethin e tij nuk kishte asnjë mysliman tjetër. Hz. Pejgamberi dërgoi një togë me ushtarë nën drejtimin e Galib b. Fudale kundër këtij populli. Të gjithë ia mbathën përveç Midrasit që kishte besim tek myslimanët. Kur i shikoi kalorësit që po afroreshin, i çoi delet afër malit. Kalorësit iu afruan duke bërë tekbir. Edhe ai mori tekbir, iu afrua dhe tha shehadetin.

Por Usame b. Zejd e vrau Midrasin dhe ia mori kafshët. Hz. Pejgamberi e mësoi atë që kishte ndodhur. Ai u mërzi shumë nga kjo gjë dhe e qortoi rëndë Usamen duke i thënë: “*Ju e vratë sepse e kishit syrin tek pasuria e tij*”. Më pas i lexoi Usames këtë ajet: **“O besimtarë! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar”, me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete, ndërkohë që tek Allahu ka fitime të shumta. Të tillë keni qenë edhe ju më parë e Allahu ju dha mirësi; prandaj gjithmonë sqarojini mirë të gjitha punët! Se Allahu është Njohës i veprave tuaja.”** (Nisa, 4)

Kur dëgjoi Resulullahun, Usame iu lut me përgjërëm: “O Resulullah! Të lutem kërko falje për mua.” Pejgamberi ia priti: “*Si ka mundësi që e keni vrarë kur ai tha La ilahe il-lallah?*” Usame tha: ‘Resulullahu e përsëriti disa herë këtë fjalë. Ndërsa unë thosha me vete: Ah sikur të mos isha bërë mysliman para shumë kohësh, por të isha bërë sot.’ Më pas Resulullahu kërkoi falje për mua dhe më urdhëroi që t'i jepja lirinë një robi. (Elmali Hak Dini, 3/53-54.)

Bie në sy fakti që Usame dëshironte që ta kishte bërë këtë gjynah të madh para se të ishte bërë mysliman, sepse përfaqimi i Islamit bëhet shkak për fshirjen e të gjitha gjynaheve të mëparshme. Në disa transmetime thuhet se Resulullahu

i tha Usames: “Të paktën t’ia kishe çarë barkun për të shikuar nëse e ka thënë këtë fjalë me sinqeritet!” Shprehja: “ndarja e barkut” ka shumë kuptim, sepse askush nuk mund ta dijë qëllimin dhe fytyrën e vërtetë të njeriut. Veprimet e bazuara në dyshime e hamendje, bëhen shkak për padrejtësi. **“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah.”** (Huxhurat, 12.) **“Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin vetëm hamendjen, ndonëse hamendja nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën.”** (Nexhm, 28)

Ekzistojnë shumë prova që tregojnë se Hz. Pej-



*Si në çdo temë
tjetër, edhe në këtë rast
ne duhet të marrim
shembullin e Hz.
Pejgamberit. Ai jetoi me
mosbesimtarët, i dinte mirë
qëllimet e tyre, ra pre e
mashtrimeve dhe dredhive
të tyre, por nuk zgjodhi t'i
akuzonte ato, nuk e ndau
shoqërinë, por u mundua
t'i mbante të bashkuar.*



gamberi ishte shumë i ndjeshëm në temën e supozimeve të gabuara në lidhje me besimin e dikujt. Një prej tyre ka lidhje me Furat b. Hajjanin. Ky individ ishte spiuni i Ebu Sufjanit. Resulullahu kishte urdhëruar vrasjen e tij. Ai u përball me një grup të përbërë nga ensarët dhe tha: “Unë jam mysliman”. Pas kësaj, Resulullahu e mori për bazë pretendimin e tij dhe hoqi dorë nga vrasja e tij. (Ebu Davud, Xhihad, 109.)

Një histori tjetër tronditëse në lidhje me këtë temë është kjo: Mikdat b. Esved tregon: I thashë Resulullahut: O Resulullah! Nëse rastis në një jobesimtar dhe fillojmë të luftojmë, nëse ai pret me shpatën e tij njëren prej duarve të mia dhe më pas fshihet pas një pemë për t’u mbrojtur dhe nëse më thotë: “Unë u bëra mysliman për hir të Allahut”; çfarë duhet të bëj unë në një rast të tillë? Resulullahu më tha: “Mos guxo ta vrasësh atë”. Unë këmbëngula: “Por ai preu dorën time, më pas tha se jam bërë mysliman”. Pejgamberi ynë i nderuar më tha: “Mos guxo ta vrasësh, nëse e vret ai do të jetë në gjendjen para se e vrave ti ndërsa ti do të jesh në gjendjen para se ai tha se ishte mysliman.” (Buhari, Dijat 1, Muslim, Iman 155.) Ka shumë komente në lidhje me komentimin e këtij hadithi. Shkurtimisht mund t’i përmbledhim në këtë mënyrë: Derdhja e gjakut të luftëtarit që lufton me myslimanin është i lejueshëm. Nëse thotë se është mysliman, ai nuk preket. Nëse atë e vret një mysliman, do të vritet edhe vrasësi (kisas). Në këtë mënyrë ato barazohen në vrasje. Nuk është ashtu si thonë harixhitë: besimtari që vret dikë, shlyen gjynah të madh dhe bëhet kafir. Sipas hadithit, vrasja e një njeriu që pretendon se është bërë mysliman është haram.

Sjelljet e para të tekfirit kanë filluar me harixhitë. Në luftën e Siffinit. Ato i quajtën kafir Hz. Aliun, Muavijen dhe sahabët që e braktisën ligjin hyjnor për të luftuar me kryengritësit dhe pranuan që ta zgjidhin konfliktin duke u konsultuar me gjykatësin. Ndërkohë që Hz. Aliu, njerëzit që luftuan kundër tij në betejat Siffin dhe Xhemel; nuk i quajti kafir por: “vëllezërit tanë kryengritës”.

Në mënyrë që dikush të quhet kafir (jobesimtar), ai duhet të mohojë një bazë fetare të fesë që i zbriti Hz. Pejgamberit me anë të shpalljes. Jobesimtar është ai që mohon një prej bazave themelore të fesë, qofshin ato të lidhura me besimin ose me praktikën. Çështjet e diskutueshme

në mesin e dijetarëve nuk mund të jenë subjekt blasfemie. Akuzimi për mosbesim i një myslimani që nuk e shfaq mosbesimin e vet në mënyrë të qartë (me fjalë ose veprime) është krejtësisht i gabuar dhe i rrezikshëm.

Supozimet për mosbesim të njerëzve nuk e kanë burimin vetëm tek mangësitë e dijeve fetare, por edhe tek shtypja politike, dhuna dhe torturat. Myslimanët që po jetojnë të pashpresë nën shtypjen e tmerrshme dhe në veçanti të rinjtë që janë të pafuqishëm, e kanë si mënyrë kënaqësie psikologjike akuzimin e njerëzve që kanë përballë, duke i quajtur ato mosbesimtarë. Dhuna dhe shtypja nuk është e mirëpritur askund, por rruga për ta përballuar atë nuk kalon nga zemërimi dhe lufta me fjalë; shpëtimi do të vijë herët ose vonë pas durimit dhe marrjes së masave të qëndrueshme.

Si në çdo temë tjetër, edhe në këtë rast ne duhet të marrim shembullin e Hz. Pejgamberit. Ai jetoi me mosbesimtarët, i dinte mirë qëllimet e tyre, ra pre e mashtrimeve dhe dredhive të tyre, por nuk zgjodhi t’i akuzonte ato, nuk e ndau shoqërinë, por u mundua t’i mbante të bashkuar.

Myslimanët që janë rrethuar nga pushtuesit dhe imperia-listët, pasuritë e të cilëve janë plaçkitur dhe që përpjekjet për bashkim kundër armikut janë ndaluar; nuk duhet të fajësojnë njëri-tjetrin dhe të grinden me vëllezërit e tyre, nuk duhet t’i harxhojnë forcat në mënyrë të gabuar dhe duhet të qëndrojnë larg sjelljeve që gëzojnë armikun. Ne kemi kaq shumë armiq, si mund të ndjejmë nevojën për të krijuar të tjerë. Myslimanët e sotëm janë marrosur dhe e nxjerrin zemërimin e armikut tek miku...

Zoti na bëftë prej atyre që e njohin mikun dhe armikun. Amin!



Jemi në mes të xhihadit

— Nuredin Jëlldëz —

Xhihadi bëhet me qëllimin e ngritjes së Islamit. Mos të harrojmë se Islami ka ligje e rregulla për të gjitha fushat e jetës, prandaj edhe xhihadi i përket të gjitha këtyre fushave. Nëse jeta ka vazhdimësi me familjen; familja është një prej fushave të xhihadit. Çdo përpjekje që bëhet me qëllimin që familja të ecë në rrugën e Islamit, është xhihad. Njeriu që e mban familjen në këmbë dhe e bën këtë gjë vetëm me shpresën e shpërblimit nga Allahu, bën xhihad dhe ai vetë është muxhahid. Të qenit mashkull ose femër, plak ose i ri; nuk e ndryshon këtë të vërtetë.

Nëse jeta përparon me ndihmën e ekonomisë dhe industrisë, njeriu që e bën tregtinë dhe industrializimin në bazë të ligjeve të shariatit mund të themi se bën xhihad në këtë fushë. Tregtia dhe industria janë dy degë pa të cilat ne nuk do të mund të jetojmë dot dhe përpjekjet që bëhen në këtë fushë me qëllimin për t'i shërbyer fesë së Allahut, janë përpjekje të xhihadit.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për bujqësinë. Bile xhihadi në fushën e bujqësisë mund të jetë një gradë më lart se llojet që përmendëm pak më parë, sepse rëndësia e bujqësisë në jetën e njeriut është më e madhe se ajo e industrisë dhe si rrjedhojë, vlera e xhihadit në fushën e bujqësisë është më e madhe se ajo në fushën e industrisë.

Nëse politika përfaqëson sistemin që udhëzon jetën tonë, mund të themi se vetëm me politikë mund të ecim në rrugën e Allahut. Kjo na ndihmon që ta shikojmë politikën si një fushë në të cilën mund të bëjmë xhihad.

Nuk ka dyshim se kuptimi më i përhapur i xhihadit është lufta me armë që zhvillohet ndaj armiqve që kanë syrin tek toka dhe pasuria e besimtarëve. Në disa vende ky është më i lartë në të gjitha llojet e xhihadeve, por asnjëherë nuk mund të themi se kjo është lloji dhe alternativa e vetme e xhihadit. Rëndësia dhe vlera e një alternative nuk mund t'i eliminojë të gjitha alternativat e tjera. Rëndësia dhe sevapet e namazit nuk e eliminojnë haxhin. Një përngjasim të tillë mund ta bëjmë edhe me llojet e ndryshme të xhihadit.

Mbase mund të duket e çuditshme, por dikur qëndresa ndaj dëshirave të nefsit dhe forca për të mos rënë në haram, quhej xhihad. I riu që e ruan nderin ndaj batakut të haramit, ka bërë xhihad. Pyetjen nëse mos vallë ky i ri ka mbrojtur atdheun e vet, e quajmë pyetje injorante. Njerëzit të cilët e mendojnë xhihadin si mbrojtje të atdheut dhe dëshirë për t'u sakrifikuar për hir të kësaj kauze, nuk e dinë fare së çfarë është xhihadi. Nëse ajo që quajmë atdhe është toka e ymetit, sigurisht që do të mbrohet. Po si mund ta quajmë xhihad një vdekje për hir të

mbrojtjes së tokës ku jetojnë njerëz që e kanë humbur dëlirësinë e shpirtit?

A nuk bëhen të gjitha përpjekjet për të mbrojtur pastërtinë e njerëzve? Nuk bëhet fjalë për një tokë të shkretë, por për vlerat morale që ajo mban mbi vete. Mund të themi se virtyti i parë i rëndësishëm, pas besimit, është dëlirësia. Për këtë arsye, nëse mbrojtja e dëlirësisë ndaj armikut të dukshëm është xhihad, edhe mbrojtja e dëlirësisë ndaj armikut të padukshëm (shejtanit) është xhihad.

Nëse përpjekja që bën sot njerëzimi për ta konsumuar internetin, atë që është bërë i pazvëndësueshëm për ne, brenda kufijve të hallallit; nuk quhet xhihad, çfarë mund të quajmë tjetër? Çdo gjë qëndron në këmbë dhe merr formën e vet falë qëllimit. Si mund të mos i quajmë pjesë të xhihadit të gjitha përpjekjet që bëhen për t'i ftuar njerëzit brenda kufijve të Allahut në një kohë që i shohim të rinjtë se si shkojnë drejt humbjes së parashtruar nga interneti dhe telefonat. Si mund të mos quhet muxhahid i riu/ e reja që vazhdimisht e mbron veten ndaj tërheqjes së internetit, duke u përpëlitur nga frika e Allahut?

Tashmë jeta jonë është e përbërë prej këtyre gjërave. Ne mund ta eliminojmë krejtësisht misrin prej jetëve tona, por një gjë të tillë nuk mund ta bëjmë kurrsesi me teknologjitë e reja. Sigurisht që është e drejtë që të quhen shehid njerëzit që kanë vdekur për mbrojtjen e fushave me grurë, por duhet ta ndryshojmë konceptin që kemi për jetën. Nuk ka dyshim se kush i largohet haramit për hir të Allahut, bën xhihad. Këtë xhihad mund ta bëjë në zyrë, në shtëpi ose në rrugë. Nuk ka asnjë rëndësi se cili është emri i sheshit por rruga që ndjek.

Xhihad bëjnë ata që e sakrifikojnë jetën me dëshirën që njerëzit ta kujtojnë Allahun me dhikër dhe që janë arkitektë të zemrave të besimtarëve. Njeriu që i mëson Fatiha-në fëmijës që takoi në autobus është duke bërë xhihadin e vet.

A nuk është xhihad përpjekja e tezeve të moshuara për t'u kujtuar vajzave të reja mbulesën dhe Ahiretin? Sigurisht që vlera e secilit veprim është në bazë të qëllimit të tij. Ajo i ka mbetur në dorë Allahut Teala; punë në dukje të mëdha do të kthehen në hiç dhe vepra të vogla që neve na janë dukur të parëndësishme, do të jenë shkak për hyrjen në Xhenet. Allahu do të vendosë, ndërkohë ne na takon t'i kryejmë detyrat tonë me përpikëri.

Le ta rrisim bashkimin në duart tona

— Xhemal Nar —

Islami bashkimin dhe unitetin që i formon së pari në zemrat besimtare duke u mbështetur te besimi, i mbart në çdo fushë të jetës duke i përhapur në familje dhe shoqëri. Në të vërtetë, në shoqëritë që kanë të njëjtin besim, të njëjtat rituale dhe të njëjtat tradita, bashkimi formohet vetvetiu. Kjo sepse edhe mendja dhe logjika e duan bashkimin po aq sa feja. Ato e duan bashkimin, sepse bashkim dhe unitet do të thotë fuqi dhe fitim, do të thotë paqe dhe rend, do të thotë lumturi.

Kurani Fisnik besimtarët që i konsideron vëllezër i thërret që të bashkohen rreth Islamit dhe ua tërheq vëmendjen që të kenë kujdes ndaj përçarjes, diskriminimit, ndarjes dhe racizmit.

Edhe i Dërguari i Allahut (a.s.), gjithmonë ka ftuar në unitet, bashkim dhe xhemat pikërisht si Kurani, vazhdimisht thoshte se bashkimi është forcë e mëshirë dhe e ka këshilluar umetin që të ketë kujdes nga mendimet e veprimet që bëhen shkak për përçarje duke thënë: *“Atë që ndahet nga kopeja e ha ujku.”* (Ebu Davud, salat, 46.)

Në ditët e sotme ndërkohë që vendet e zhvilluara po fitojnë fuqi me bashkime të ndryshme si politike, ekonomike, ushtarake dhe kulturore, për fat të keq është shumë e dhimbshme dhe e turpshme të shohësh që myslimanët nuk kanë bashkim shpirtëror për shkak të ideologjive dhe sistemeve të tyre që janë në kundërshtim me besimin Islam dhe nuk kanë bashkim rajonal për shkak të përqsjeve raciste dhe krahinore.

Ndërkohë mendja, dija, ekonomia, të vërtetat politike dhe përvojat historike kërkojnë që ne të jemi të bashkuar pikërisht siç e kërkon edhe Islami.

Prandaj ne duhet të dalim urgjentisht nga kjo situatë dhe përsëri duhet të bëhemi shembull në këtë çështje për njerëzimin siç kemi qenë dje.



Injoranca e arsimuar

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Fjala “injorancë” në fjalor ka kuptimin: të mos dish, të mos njohësh, të mos kesh dijeni, të jesh i ashpër. Antonimet e saj janë: dituria dhe butësia.

Në Kuran fjala “injorancë” përmendet në dy ajete të ndryshme kuranore me kuptimet: “mos-njohje” dhe “të bësh dëm pa dashje”¹. Në ajetet e tjera kuranore ajo përdoret për të treguar sjelljet, veprimet, fjalët dhe besimet e gabuara që janë në kundërshtim me arsyen hyjnore. E thënë ndryshe, në Kuran fjala injorancë përdoret më shumë për të treguar sjelljet e pamatura ndaj Allahut Teala dhe njerëzve. Kjo quhet ndryshe edhe: injorancë me shtresa.

Fjala “injorancë” përdoret në të gjitha fushat e shkencës dhe ka pak a shumë të njëjtin kuptim, si “mosnjohje ose mungesë diturie”.

A QUHET INJORANT NJERIU QË NUK DI SHKRIM E KËNDIM?

Sikur injoranca të ishte ajo që pandehet prej disa njerëzve: “të mos dish shkrim dhe lexim” ose sikur shpallja të mos ishte burimi i diturisë, vetë Pejgamberi ynë i nderuar nuk do të mund ta kuptonte të vërtetën. Të mos dish shkrim e lexim është mangësi për njerëzit e thjeshtë, por për pejgamberët që e mësuan të vërtetën me anë të shpalljes është cilësi e veçantë dhe epërsi. Sepse njerëzit që nuk i besonin, nuk mund t’i kundërshtonin me justifikimin: “Të gjitha këto gjëra i mësojnë prej këtyre njerëzve ose prej këtyre librave”. Hz. Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, nuk dinte shkrim e këndim. Pavarësisht kësaj armiqte e tij mbetën të pafuqishëm ndaj tij.

Në kohën kur isha nxënës në medrese, kishim një mësues të historisë që ishte në moshë. Ai na thoshte se arsyeja e prapambetjes së popullit tonë ishte ardhja vonë e shtypshkronjës. Shtypja e vonë e librave bëri që njerëzit të mos mësonin shkrim e lexim. Duke qenë se mësuesi e përsëriste herë pas herë këtë ide të veten, unë nuk durova dot më dhe një ditë mora leje për të folur dhe i thashë: “Mësues, ju thoni kështu, por pas ardhjes së shtypshkronjës u rrit numri i atyre që lexojnë e shkruajnë por a u eliminua injoranca?”...

Në ditët tona, diploma njihet si çertifikata matëse e edukimit. Në të vërtetë diploma nuk tregon pjekuri, thjesht faktin se ke përfunduar një fakultet të caktuar. Në shumicën e rasteve ajo është provë e një injorance të shkolluar. Ndërkohë që pjekuria është një gjë krejt tjetër.

BURIMET E INFORMACIONIT

Sipas filozofisë iluministe, burimet e informacionit janë: mendja, vëzhgimi dhe eksperimenti. Siç mund ta shikoni edhe ju, shpallja nuk është në mesin e tyre. Në një situatë të tillë në vend që të thuhet “filozofi iluministe”, do të ishte e udhës të thuhej: “filozofi e padisiplinuar”. Allahu Teala ka thënë në Kuran: “**Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi.**”² Allahu Teala ua ka përcjellë urdhrat e Veta njerëzve me anë të pejgamberëve. Pra, për njerëzit që besojnë, shpallja është në krye të burimeve të informacionit.

Në përgjithësi, një ideologji që nuk e pranon shpalljen si burimin kryesor të informacionit dhe që nuk strukturohet me baza të përshtat-



shme për të, nuk është asgjë tjetër veçse sistem edukativ i injorancës. Mospranimi i shpalljes si burim informacioni është kryengritje që thotë: “O Zot, Ti na ke krijuar neve, por tani drejtimi është në duart tona. Na jep liri të plotë për të ndërtuar jetën sipas rregullave tona.” Në fund të fundit, kjo ide është shprehur dhe vazhdon të shprehet në mënyra të ndryshme. Le të kujtojmë fjalët e thëna në hapjen e parlamentit: “Tani e tutje ligjet nuk do të hartohen sipas rregullave të qiellit por sipas nevojave tona.” A nuk është kjo një ideologji sekulariste e larguar krejtësisht nga e vërteta e shpalljes?

Drejtuesi i shtetit, i cili është duke bërë fjalimin e protokollit në një konferencë fetare dhe që u drejtohet njerëzve specialistë në çështjet fetare me fjalët: “të gjitha çështjet do t’i zgjidhni në dritën e mendjes dhe të shkencës”. Ky drejtues mbase nuk e shpreh krejt haptas mospranimin e shpalljes si burim të informacionit, por nuk ka asnjë dyshim se ai e nënkupton këtë gjë.³

Injoranca e edukuar, fillimisht dhe veçanërisht është institucionalizuar me anë të asaj që është quajtur: “Historia zyrtare dhe imponimi kolonial i rrugës dominuese në sistemin arsimor”. Prezantimi i këtij sistemi si nacional është mashtrim dhe përpjekje për t’u mbrojtur. Nga njëra anë i prezantojmë si vlera kombëtare, nga ana tjetër jemi shumë të dhënë pas “vlerave perëndimore”... A nuk është kjo veçse dashuri për injorancën?

Parashtrimi i njohurive të cunguara të perëndimit si zbulime të mëdha, bën që edhe shkencëtarët myslimanë të mrekullohen dhe t’i pëlqejnë këto qasje. Kjo nuk është gjë tjetër veçse një shkallë tjetër e injorancës.

Kur Pejgamberi ynë i nderuar e fisnikëroi Medinën me ardhjen e tij, u gjend me përpjekjet e çifutëve që lexonin librat e tyre në hebraisht dhe i përkthenin e i komentonin në arabisht për t’i mashtruar myslimanët dhe për t’i nxjerrë ata nga rruga e drejtë. Në një situatë të tillë, Pejgamberi i urdhëroi myslimanët që të mbaheshin fort pas Kuranit dhe Sunetit për të mos pësuar ndotje kulturore dhe u kërkoi që të thoshin: **“Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve.”**⁴ Duke qenë i detyruar, ai u kujtoi myslimanëve se çifutët nuk ishin njerëz të besuar dhe se e kishin ndryshuar librin e tyre ndërkohë që për hir të përfitimeve të pakta, atë e paraqitnin si **“Kjo është prej Allahut”**⁵ Resulullahu e bëri të qartë faktin se libri më i saktë ishte në duart e myslimanëve dhe se çifutët do të përpiqeshin shumë për ta mohuar këtë të vërtetë; ndërkohë që ekziston edhe mundësia e një rreziku në konfirmimin e këtij mohimi nga Perëndimi.⁶ Në këtë mënyrë, Pejgamberi ynë i nderuar na paralajmëroi që në fillim për rrezikun e një injorance të edukuar dhe mundësinë e ndotjes kulturore dhe e bëri si parim një mbrojtje (të paktën minimale) ndaj këtyre rreziqeve.

Sipas nesh, paralajmërimi i Pejgamberit tonë të nderuar është aktual edhe në ditët tona. Ne duhet të ndalemi një çast para se t’i pranojmë si të mirëqena studimet që bëjnë jomyslimanët, lajmet dhe mendimet e tyre. Për sa kohë që këto lajme nuk provohen nga agjencitë myslimane, ne duhet të jemi të rezervuar. Një sjellje e tillë, është hapi i parë për të ndaluar realizimin e aspiratave të orientalistëve.


Për këtë arsye ne duhet të bëjmë kujdes me masën e “të qenit mysliman” tek orientalistët dhe të jemi të kujdesshëm teksa shqyrtojmë mendimet e atyre që nuk janë bërë akoma myslimanë. Në lidhje me ndjeshmërinë e kësaj situatë, dijetari i madh Muhamhed Hamidullah ka shkruar: “...Profesori Roger Arnaldez nuk është mysliman, por është një prej orientalistëve më të mirë francezë. Ai ka shkruar një libër për jetën e Pejgamberit. Përkthimi i këtij libri do të na sjellë dobi inshallah. Por siç e përmenda edhe më sipër, ai nuk është mysliman. Për këtë arsye, nuk duhet të mjaftohemi vetëm me përkthimin e librit, por le të vendosim edhe shënimet tona, aty ku është e nevojshme.”⁷ Fakti që M. Hamidullah e thekson dy herë faktin se autori i librit nuk është mysliman, duhet shikuar si një paralajmërim i rëndësishëm.

Duke qenë se ra fjala këtu, duhet të theksojmë se të gjitha këshillat dhe paralajmërimet e Pejgamberit tonë të nderuar janë aktive në momentet e një ndikimi, nuk kanë lidhje me marrëdhëniet kulturore-shoqërore. Për më tepër që vetë Pejgamberi ynë i nderuar ka thënë: “Nuk ka asnjë problem nëse transmetoni duke thënë: kështu kanë thënë bijtë e Izraelit.”⁸

Të gjitha përpjekjet e kohëve të fundit për t’i rregulluar si të vogla e të parëndësishme të gjitha përpjekjet shkencore që u realizuan në përputhje me paralajmërimet e Pejgamberit tonë të nderuar si edhe hedhja e dyshimeve mbi pamjaftueshmërinë e traditave profetike, nuk janë asgjë tjetër veçse përpjekje për të ndotur kulturën e myslimanëve. Ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në këtë temë dhe të mos biem pre e mashtrimeve. Në lidhje me këtë temë duhet të kujtojmë rastin kur Pejgamberi ynë i nderuar urdhëroi që të shkatërrohej e të digjej “Mesxhidi Dirar”, xhamia e nderuar me qëllimin për të dëmtuar myslimanët. Urdhri për prishjen e një xhamie na flet qartë për masat që duhet të marrim ndaj njerëzve, organizatave dhe institucioneve që kanë si qëllim rrënimin e fesë tonë.

Të gjithë pjesëtarët e ymetit kanë si detyrë që të jenë aktiv përballë kësaj injorance të arsimuar që kërkon të lërë gjurmë të thella negative në mendjet dhe zemrat e myslimanëve.

Fusnota: 1) Bekare, 273; Huxhurat, 6. 2) A'raf, 54. 3) Në konferencën e tretë është bërë një fjalim i tillë. 4) Ankebut, 46. 5) Shiko: Suren Bekare, 79. 6) Shiko: Ahmed b. Hanbel, *Musned*, III, 338, 387. 7) Shiko: *Hazreti Muhammed*, faqe.7 (istanbul, 1982. Uçdal Neshrijat). 8) Buhari, Enbija 50; Muslim Zuhd 72.



DUAJA E HZ. IBRAHIMIT DHE BREZIT PRIJËS

— Xhafer Durmush —

Puna dhe përpjekjet për të edukuar breza që do të bëhen prijës të njerëzimit është investimi më i vlefshëm që mund të bëhet. Gjithashtu edhe dhënia e ndihmës në këtë fushë është shumë e rëndësishme... Kurani Kerim e përmend Hazreti Ibrahimin (a.s.), si një prej njerëzve të parë që e mori përsipër këtë detyrë. Ai lavdërohet me këto fjalë: **“Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet:”**¹... Në një sure tjetër ai quhet “shembull i mrekullueshëm”², epitete që përdorej vetëm për Resulullahun (a.s.). Nëse pyesim për arsyen e kësaj na vjen në ndihmë duaaja që ai bëri kur së bashku me Hz. Haxherin dhe Ismailin, u shpërngul për në kufijtë e sotëm të Qabes: **“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin.”**³ Pra, për të gjëja më e rëndësishme ishte që besimtari që falte namazin.


Pasi u sprovua në disa fusha të ndryshme dhe doli me sukses, mori lajmin e mirë: **“Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!”**; Ibrahim (a.s.), iu lut: **“Po pasardhësit e mi?”** (bëji edhe ata prijës)⁴ dhe **“O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit**

me të mirët! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme”⁵...

Duhet të kuptojmë se ekzistojnë disa arsye pse Hz. Ibrahim (a.s.), në ajete Kuranore përmendet si “me karakter të butë dhe i durueshëm”, theksohet fakti që ai ishte “besnik”, quhet “shembull i mrekullueshëm” dhe thirret me titullin “halil/mik”. Fillimisht mund të themi se ai dëshironte që jeta e pjesëtarëve të familjes së tij, por edhe e gjithë ymetit, të formësohej rreth namazit. Ai mendonte se kjo ishte mënyra më e mirë për t’u larguar prej veprave të këqija.

Nga ajetet vijuese që përmbajnë lutjet e Ibrahim (a.s.), mësojmë se besimtari duhet të ketë horizont të gjerë. Pra, ai duhet të punojë fort për shpëtimin e brezave të ardhshëm, duhet të përgatis terrenin dhe të lutet për të nesërme të arta. Myslimani nuk lartësohet nëse kryen vetëm detyrat e veta personale. Të qenit mysliiman merr kuptim të vërtetë me marrjen përsipër të përgjegjësiive shoqërore.

E përmendëm edhe më sipër faktin që Ibrahim (a.s.), pasi u sprovua disa herë mori lajmin



e mirë: **“Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!”** Sigurisht që ky provim nuk ishte vetëm për të, siç thuhet edhe në Kuran: **“Vërtet mendoni të hyni në Xhenet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush?”**⁶; të gjithë ne do të sprovohemi në pasuri, jetë dhe fëmijë. Për këtë arsye mund të themi se rruga e atyre që dëshirojnë të jenë prijës dhe she-mbull të brezave të ri, do të jetë e gjatë dhe e lodhshme. Njeriu në bazë të sprovave që përjeton dhe sinqeritetit me të cilin i kalon, do ta shohë të ardhmen nga horizonti i pejgamberëve. Besimtari i vërtetë duhet të ketë zemër bujare e të lutet për të ardhmen e njerëzve ashtu si bëri Resulullahu (a.s.) në Taif: **“Shpresoj që nga brezi i tyre të vijnë njerëz që adhurojnë vetëm Allahun dhe që nuk i bëjnë Atij asnjë ortak.”**⁷

Së dyti duam të theksojmë faktin që Ibrahim (a.s) nuk ka bërë asnjë dallim mes bashkëkohësve të tij me brezat e së ardhmes, kur e pyeste Allahun që: **“Po pasardhësit e mi?”** dhe kur i lutej Atij me fjalët: **“Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme.”** ai shqetësohej për lartësimin e Islamit.

Tani mendo pak, ekzistojnë njerëz të cilët jetojnë për të plotësuar dëshirat e egos. Ata nuk mendojnë as për të ardhmen e fëmijës së vet. Nga ana tjetër ka edhe njerëz që shqetësohen për pjesëtarët e familjes, të afërmit, fqinjët e bashkëqytetarët. Ndërsa akoma më të rrallë janë njerëzit që e shohin si përgjegjësi personale të gjithë njerëzimin

dhe e hapin zemrën për shqetësimet e gjithë botës. Njerëzit mendojnë: **“Asnjë njeri i kohës sonë nuk duhet të qëndrojë i pandriçuar nga Islami dhe të njëjtat masa duhet t’i marrim edhe për brezat e ardhshëm.”** Këta janë njerëz që ecin në gjurmët profetike. Të gjithë duhet të bëjnë përpjekje për të qenë prej pjesëtarëve të këtij grupi.

Dëshira për vazhdimësi është e fshehur thellë në natyrën njerëzore; secili prej nesh dëshiron që emrin, zanatin, besimin dhe qëllimin e jetës; t’ia përcjellë brezave të ardhshëm. Për këtë arsye besimtari duhet të lutet që prej brezit të tij të vijnë njerëz të drejtë. Mos të harrojmë që vetëm projektet me rrënjë të forta mund të kenë sukses dhe punët që bëhen me synime afatgjate do t’i rezistojnë kohës. Sigurisht që të gjitha këto duhet të ushqehen me lutje të sinqerta dhe duke pritur shpërblimin veç nga Allahu.

Kurani- Kerim është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kur lexohet ai i hap dyert e fshehta. Mjafton që ne të ndjekim shembujt e bukur që na janë dhënë dhe të mundohemi që të përfitojmë aq sa kemi mundësi.



Lexo-Mendo!

T’IA BËSH DETYRIM VETES MËSHIRËN

Në suren En’am thuhet: **“Ai ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën.”**⁸ dhe ky lajm i mirë na i ngroh zemrat me shpresë e dashuri.

Pa mendoni; Allahu Teala, që është Krijuesi i qiejve dhe tokës mund t’i ndëshkojë menjëherë gjynahqarët dhe jobesimtarët. Por edhe pse nuk është i detyruar, Ai është i mëshirshëm me robërit e Vet. Allahu nuk i ndëshkon menjëherë robërit mosmirënjohës por i jep kohë për të ndryshuar rrugë dhe kur pendohen sinqerisht i falë.

Pa mendoni pak për gjerësinë e mëshirës Hyjnore: njeriut që bën një të mirë do t’i llogariten të paktën 10 sevape. Ndërsa ai që bën një të keqe ndëshkohet me një gjynah. **“Mëshira Ime është më e madhe se ndëshkimi Im.”**⁹ Ndërkohë kur i kërkuan të Dërguarit të Allahut që t’i mallkonte mosbesimtarët ai iu përgjigj: **“Unë nuk jam dërguar për të mallkuar. Unë jam dërguar si shenjë e mëshirës.”**¹⁰

Fusnota: 1) Surja Nexhm, 53/37. 2) Surja Mumtehine, 60/4. 3) Surja Ibrahim, 14/37. 4) Shiko: surja Bekare, 2/124. 5) Surja Shu’ara, 26/83-84. 6) Surja Bekare, 2/214. 7) Buhariu, Bedul Hallk, 7. 8) 6/12. 9) Buhariu, Teuhid 15. 10) Muslim, Birr, 87.

Në lidhje me “ULUHIJET”-in..

— Prof. dr. Irfan Gyndyz —

Në mënyrë që ta perceptojmë sa më saktë rëndësinë e “teuhidit”, fillimisht duhet të mendojmë gjatë në lidhje me termin: “ilah”. Si fjalë ajo ka kuptimin: të qenit rob, mbrojtje, admirim, strehim, mbështetje tek një Qenie supreme. Kjo fjalë arabe vjen nga folja: “elihe” dhe kur përdoret në formën pësore merr kuptimin: “qenie që adhurohet”. Ndërsa fjala: “uluhijet” është infinitivi i fjalës “ilah” dhe ka kuptimin: “të bësh dikë perëndi”.

Ajetet kuranore që thonë: **“që dëshirat e veta i ka bërë zot”**; **“Moskërkimi i asnjë sulltani përveç Allahut.”**, na tregojnë se “perënditë” nuk ndodhen vetëm jashtë, por edhe brenda. **“Allahu nuk i ka dhënë asnjë njeriu dy zemra në kraharor.”** Nga ky ajet kuranor kuptojmë se zemra ka autoritet sundues dhe brenda saj nuk mund të ketë njëkohësisht dashuri për Allahun edhe për gjërat materiale të kësaj bote. Nëse merrni parasysh furtunën që mund të krijojnë ndeshjet mes melekut e shejtanit, shpirtit dhe egos; mund ta kuptoni më mirë temën e sipërpërmendur. Cila të jetë më e dashur për shpirtin, fjala e saj do të jetë më e fuqishme. Ndërkohë që mendja dhe organet e tjera do të ndjekin urdhrin pa pasur mundësi për ta refuzuar. Pejgamberi ynë na ka këshilluar vazhdimisht që të bëjmë kujdes me zemrën, mos të harrojmë atë që ka thënë në lidhje me këtë temë: **“Kur rregullohet ajo, rregullohet i gjithë trupi, kur priset ajo priset i gjithë trupi.”**

Teuhidi nuk nënkupton besimin në njësinë e Allahut Teala; ai duhet të shpallë bindjen e plotë në një autoritet absolut dhe kjo duhet të kuptohet nga çdo sjellje e njeriut, nga buzëqeshja e nga heshtja. Për këtë arsye, ne duhet të konkretizojmë fjalën e teuhidit: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij.” dhe të lartësojmë çdo fuqi, vullnet, autoritet dhe sovranitet të gabuar. Allahu Teala i ka krijuar njerëzit dhe xhindet që të jenë robër të Tij. Për këtë arsye, kryerja e detyrave tona si rob është edhe detyra edhe fati ynë. Disa njerëz adhurojnë vetëm Allahun dhe kërkojnë ndihmë vetëm prej Tij; ndërsa disa të tjerë

shkojnë në rrugë të gabuar dhe adhurojnë zota të rremë. Njerëzit që nuk adhurojnë Allahun, bëhen robër të disa zotave të cilëve nuk mund t'i vendosin dot as emër. Nganjëherë këta zota janë kënaqësi dhe dëshira momentale nganjëherë përfitime materiale. Ndërkohë që njeriu mund të robërohet vetëm prej dikujt. Nuk mund të jesh rob i dy dyerve.

Ajo që quhet “hyjni” është arsyeja që ka ndikim mbi njeriun dhe që ka fuqi mbi mendimet dhe sjelljet e tij. Kur e pyetën një prej sahabëve më të rinj dhe të pasur, Kab Ibn Malik se përse nuk mori pjesë në një luftë aq të rëndësishme si lufta e Tebukut, luftë e zhvilluar nën drejtimin e Hz. Pejgamberit, ai iu përgjigj: “Isha shumë i ri dhe shumë i pasur. Kjo luftë u bë në një stinë shumë të nxehtë dhe në një vend të largët. Ndërsa unë isha njeri që në të nxehtë e doja hijen ndërsa në udhëtim i doja frutat. Dyshimi se nuk do t'i kem dot këto më ndaloi nga marrja pjesë në këtë luftë.” Pa shiko arsyet që e lanë një sahab pa marrë pjesë në luftë. Një dobësi e thjeshtë, një zakon i rëndomtë. Kjo është fuqia që ka egoja tek ne. Nga kjo kuptojmë se në edukimin e moralit dhe pjekjen e njeriut nuk mjafton teuhidi me fjalë dhe për kthimin e saj në esencë të jetës nevojitet që ai të lind në zemër dhe të burojë prej saj.

Sipas Islamit, Allahu është një dhe Ai është Zoti i Plotfuqishëm. Myslimanët nuk ia atribuojnë një cilësi të tillë askujt tjetër. Nëse ndodh një gjë e tillë, kuptohet se ka pasur një shkarje nga rruga e drejtë. Askush

nuk mund ta përdor trupin sipas dëshirës e të thotë: “Mos u përziej me trupin tim, unë e përdor si dua dhe nuk i intereson askujt.” Asgjë që na është dhënë si amanet nuk mund ta përdorim sipas dëshirës, ne duhet ta përdorim në shërbim të arsyes së krijimit. Allahu na ka krijuar në formën më të përsosur. Nga ky këndvështrim mund të themi se Krijuesi ka të drejtë mbi njeriun, të paktën aq sa ka shpikësi mbi shpikjen që ka patentuar.

Njeriu që atributet e Allahut ia jep një krijese tjetër dhe që fjalët e saj i bën ligje të jetës, e ka hyjnizuar atë. Imani është



*Teuhidi
nuk nënkupton besimin
në njësinë e Allahut
Teala; ai duhet të
shpalosë bindjen e plotë
në një autoritet absolut
dhe kjo duhet të kuptohet
nga çdo sjellje e njeriut,
nga buzëqeshja e nga
heshtja.*



të deklarimi se: “Unë e pranoj me vetëdijen time të plotë madhëstinë dhe fuqinë e Allahut. Jap fjalën se do të jetoj sipas ligjeve të Allahut dhe jo ligjeve të mia.” Në këtë mënyrë njeriu shpëton nga rënia në boshllëk dhe nga kotësia.

Nuk është e thënë që njeriu t’ia atribuojë të gjitha cilësitë e Allahut dikujt tjetër ose egos së vet; mjafton që këtë gjë ta bëjë më një cilësi ose një pjesë të saj; në këtë rast ai ka pranuar si përëndi dikë tjetër.

Surja Hixhr, 42 : **“Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.”**

Surja en- Nahl, 16/99 : **“sepse, në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre.”**

Surja Isra, 17/65: **“Por në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi! Zoti yt mjafton si mbrojtës (i tyre)!”** Të gjitha këto ajete tregojnë për një forcë që sundon nga fronti i zemrës dhe që drejton “shtetin” e quajtur trup. Hz. Mevlana thotë se trupi duhet t’i ngjasojë kalit, ndërsa shpirti kalorësit: “Nëse kalorësi është më i fuqishëm, ai do e drejtojë kalin tek një vend i bukur, ndërsa nëse kali sundon kalorësin ai do të shkojë drejt hangarit.” E gjithë çështja është përpjekja për të shuar luftën mes egos e shpirtit, engjëjve e shejtanëve dhe për të sunduar në bazë të arsyes hyjnore. Qëllimi ynë në jetë është që në këtë lumë të jetës të mund të shpëtojmë Musain dhe të eliminojmë Faraonin.



MA'KIL IBN SINAN EL ESHXHA

FLAMURTARI I FISIT ESHXHA

— Mustafa Erish —

Makil ibn Sinan el-Eshxhai, radijallahu anh, është një prej fatlumëve të parë prej fisit të vet, që e njohu dhe e pranoi profecinë e Resulullahut, salallahu alejhi ve selem!..

Ai është trimi i parë prej fisit Eshxha që u bekuu me Islam!..

Ai është njeriu guximtar, të cilin Resulullahu salallahu alejhi ve selem, e dërgoi si thirrës të Islamit tek fisi Beni Hilal Amir!..

Ai është heroi që në çlirimin e Mekes, mbajti flamurin e fisit Eshxha!..

Ai është pjesëtar i klanit Kah, i fisit Eshxha. Ai përmendej me etiketat: Ebu Abdurrahman, Ebu Jezid, Ebu Isa dhe Ebu Sinan. Ai është fatlumi që pranoi i pari Islamit në mesin e rrethit të tij.

Beni Eshxhatë, kishin prejardhje nga klani Kah dhe njiheshin me emrin e babait së tyre, Eshxha. Ata jetonin në rrethinat e Medinës.

Në vitin e Hendekut, një njësi luftarake prej 400 pjesëtarësh të fisit Eshxha, që ishin nën komandën e Mesud ibn Ruhajle, u bashkua me ushtrinë e Ebu Sufjanit, kundër Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem. Pas luftës së Beni Kurajdha, një grup prej 700 njerëzish pavarësisht faktit se përsëri ishin në drejtimin e Mesud ibn Ruhajles, u vendos në rrethinat e Medinës, në luginën e malit Sel.

Pejgamberi ynë i nderuar, salallahu alejhi ve se-

lem, sapo mori vesh se fisi Eshxha ishte vendosur në një vend të afërt me Medinën, shkoi t'i vizitonte. Ndërkohë i urdhëroi sahabët e vet që t'i ngarkonin hurma për t'i gostitur.

Njerëzit e eshxhave u gëzuan shumë nga vizita e Pejgamberit të nderuar. Zemrat e tyre u ngrohën dhe u ndriçuan duke u ngrohur nga respekti për Islamit. Të ndodhur në një situatë të tillë, bënë këtë ofertë:

“O Muhammed!.. Ne nuk njohim askënd në tokat arabe që është më afër jush se ne dhe më të paktë në numër. Ne jemi më të afërmit tuaj. Ne heqim dorë nga armiqësia me ju! Kemi ardhur për të bërë një marrëveshje me ju!”

Dielli i dy botëve iu përgjigj pozitivisht kësaj kërkesë, pa e zgatur aspak. Ai e shikoi këtë si rast për t'i ftuar në Islam dhe e pranoi marrëveshjen. Pas kësaj marrëveshjeje, ata u bekuan me Islam.” (Ibn Sad, Tabakat vëllimi 1 faqe 306; M. Asim Këksal, Historia Islame 4/349-350)

Makil Ibn Sinan, radijallahu anh, jetoi ashtu si të gjithë sahabët e tjerë, si një shembull i përkryer i besimtarit të sinqertë. Jeta e tij kaloi me përpjekje për të jetuar si mysliman dhe për t'i ndihmuar të tjerët që të bëjnë të njëjtën gjë. Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, e dërgoi si thirrës islam tek fisi Beni Hilal Ibn Amir.



Ky fis ishte pjesë e klanit Kah dhe jetonte në rrethinat e Mekës. Dielli i dy botëve i dha si detyrë Makil ibn Sinanit që t'i njihnte ata me bukuritë e Islamit. I kërkoi t'u fliste për Islamit, më pas t'i ftonte në pranimin e tij.

Makil ibn Sinan, radijallahu anh, mori pjesë edhe në luftëra, si mbajtës i flamurit. Në çlirimin e Mekës, Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, i dha detyrën e mbajtjes së flamurit të fisit të vet. (Isabe, VI, 143-144.)

Pas çlirimit, ai qëndroi për disa kohë aty, më pas u kthye në Medinë. Sipas disa transmetimeve thuhet se për disa kohë qëndroi në Kufe, ndërsa në kohën e Hazreti Omerit, radijallahu anh, u kthye për të jetuar në Medinë.

Makil ibn Sinan njihej për guximin dhe fisnikërinë e tij. Ai ishte një i ri me virtyte dhe devotshmëri. Në tema ku e dinte se kishte të drejtë, nuk hidhte asnjë hap pas dhe nuk kishte frikë nga askush. Ai e shprehte me patjetër mendimin e vet, nuk heshte. Ra shëhid në ngjarjen e Harresë. (Istian, III, 1431-1432.)

Ai ka transmetuar një hadith nga Resulullahu, salallahu alejhi ve selem. Ky hadith gjendet tek librat e Ebu Davudit, Tirmidhiut, Ibn Maxhe dhe Nesai. Transmetimi është ky:

“Një burrë shkoi tek Abdullah ibn Mesudi, radi-

jallahu anh, dhe i bëri këtë pyetje:

“Çfarë ndodh nëse një burrë martohet me një grua pa e përcaktuar mehrin dhe vdes pa u veçuar me gruan e vet, pa pasur marrëdhënie me të?”

Abdullah ibn Mesudi, radijallahu anh, iu përgjigj: “Gruaja ka të drejtën e mehrit. Shikohet sa është vlera e mehrit në atë zonë dhe i jepet aq. Gruaja nuk dëmtohet dhe nuk dhunohet. Gruaja pret aq sa është periudha e caktuar dhe merr pjesën e vet nga trashëgimia.”

Makil ibn Sinan el- Eshxhai, që ndodhej në atë grumbullim, u ngrit në këmbë dhe transmetoi këtë hadith të dëgjuar nga Pejgamberi ynë i nderuar:

“Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka dhënë të njëjtin vendim për një grua nga fisi ynë, Verva binti Vasik.” (Ebu Davud, NumërL 2114; Tirmidhiu, numër:1145.)

Abdullah ibn Mesudi, radijallahu anh, u gëzua shumë nga kjo përgjigje. Ai u lumturua kur e dëgjoi hadithin. Ndërkohë që hadithi u bë i famshëm në libra dhe njihet me titullin: “Kissatu Berva” (Usdul-gabe, V, 221.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij.

Allahu na mundësoftë të gjithëve që të marrim pak nga guximi, virtytet dhe devotshmëria e Ma'kil ibn Sinanit, radijallahu anh. Amin.



Si të shpëtojmë nga kurthi i **HEDONIZMIT?**

— Ajnur Tutkun —

Përse njeriu ta ndalojë veten nga ushqimi, pirja, shëtitja, veshja, argëtimi, etj., domethënë, nga të jetuarit me gjërat që i japin kënaqësi? Patatinat, biskotat, pijet, etj., të cilave u është shtuar shija me gjëra të ndryshme... Rrobat që u është shtuar joshja nëpër vitrina dhe markat që e bëjnë njeriun të ndjehet mirë... Qendra tregtare madhështore dhe qendra argëtimi... Lojëra emocionuese që luhen duke harxhuar para dhe pushime që bëhen në hotele luksoze... Nëse njeriu ka para dhe nëse është i shëndetshëm, atëherë, përse të mos argëtohet pa masë?!

Hedonizmi është një rrymë filozofike e zhvilluar nga ana e mendimtarëve të lashtë grekë, Aristiposi dhe Epikuri. Kjo rrymë filozofike mbron mendimin se vlera më e lartë në jetë është kënaqësia dhe se jeta ideale mund të arrihet me anë të saj. Ndërkohë që Aristiposi mbron mendimin se kënaqësia fizike e bën njeriun të ndjehet mirë, Epikuri thekson se kënaqësia shpirtërore është më e rëndësishme dhe ideale.

Në ditët e sotme njerëzit nuk thonë haptazi: “Unë rend pas hedonizmit!” Por ata që i japin lirisë kuptimit: “Bëj çfarëdo që dëshiroj.”, ata që sillen sikur nuk kanë ndonjë hall tjetër përveçse të hanë e të pinë, të shëtisin, të dëfrehen, të argëtohen dhe të shpenzojnë, ata që nuk i kuptojnë përgjegjësitë e tyre, ata që nuk kanë asnjë qëllim dhe synim abstrakt dhe ata që bëjnë gjithmonë çfarëdo që u do qejfi, nuk janë gjë tjetër përveçse hedonistë tipikë. Ndërsa gjendja e atyre që tashmë nuk kënaqen dot me asnjë lloj argëtimi dhe kënaqësie, është patologjike dhe që ka nevojë për t’u mjekuar.

Ka shumë prej atyre që blejnë rroba menjëherë sapo t’i shohin, edhe pse nuk kanë nevojë. Ka prej atyre që formojnë grumbuj frutash e perimesh të kalbura nëpër frigoriferë duke marrë më shumë se ç’kanë nevojë dhe prej atyre që nuk arrijnë të bëhen të lumtur, edhe pse i ndryshojnë mobiliet sa herë

që dëshirojnë. Te këta lloj njerëzish, konceptet, si të mjaftuarit me atë që kanë, falënderimi i Zotit për mirësitë, kujdesi që shfaqet kundër shpenzimit të tepruar etj., nuk gjejnë dot kuptim në asnjë lloj mënyre. Tashmë ka ardhur koha dhe po kalon madje, që ne njerëzit, si të rinjtë që nuk mund t’i përballojnë dot shpenzimet e pritshmërive të tyre në kuptimin e argëtimit dhe dëfrimit, gratë që nuk mund t’i plotësojnë dot gjërat që mendojnë se u mungojnë dhe burrat që nuk u mbarojnë gjërat e nevojshme për punë, ta kuptojmë se po e çojmë individin, familjen, shoqërinë, vendin dhe të gjithë botën në prag të falimentimit!

Fëmijët që rriten duke iu plotësuar çdo lloj nevojë në moment dhe më shumë se kanë dashur, fëmijët që rriten nga prindërit e tyre duke përvetësuar një jetë me në qendër fëmijën dhe fëmijët e pangopshëm që rriten duke i ndarë kënaqësitë, por jo edhe përgjegjësitë, sigurisht që do të bëhen egoistë, hedonistë dhe komfortistë.

Prindërit që posedojnë këndvështrimin: “Unë nuk kam pasur dot, ai le të ketë! Unë nuk kam bërë rehati, ai le të bëjë! Unë jam shtypur shumë, ai le të mos shtypet!..” tashmë duhet ta kuptojnë që fëmijëve të tyre nuk po u bëjnë mirë, por po u bëjnë keq. Mbi të gjitha, edhe të rriturit duhet ta kuptojnë se po jetojnë si hedonistë në kurthin e kapitalizmit duke u kapluar nga joshja e këtij shekulli.

Në këtë kontekst, nëpër shkolla duhet të bëhet modelimi i vlerave dhe jo edukimi i këtyre të fundit! Nëse pandehim se mund t’ua mësojmë vlerat fëmijëve tanë me lojëra, poezi apo tri-katër afishe të përgatitura në lidhje me çfarëdo lloj vlere, për shembull, në lidhje me vlerën e posedimit të një qëllimi dhe ideali, gabohemi rëndë. Gjithashtu, nuk mund të besojmë dot që fëmijëve tanë t’ua mësojnë vlerat arsimtarët që lozin në lojërat e internetit përgjatë pushimit apo momenteve të lira të orëve të mësimin në klasë, që planifikojnë të takohen nëpër qendra

tregtare pasi të dalin nga shkolla, që vijnë në shkollë çdo ditë me rroba të markave të ndryshme dhe që flasin vetëm për argëtim, shëtitje e dëfrim kurdo që u jepet mundësia qoftë edhe përgjatë mësimit.

Ne nuk mund ta dimë se sa e mundur është që e gjithë njerëzia të shpëtojë nga kapitalizmi, i cili është një sistem i formuar mbi konsumin, por vendet evropiane, ekonomitë e të cilave kanë filluar të zhyten në batak për shkak të krizave, janë argumenti se ky sistem nuk është i shëndoshë. Shpresa që shtetet të bëhen kaq largpamëse sa që ta shohin apo të dëshirojnë ta shohin këtë ecuri, na duket si një imagjinatë. Luftërat që bëhen për një farë fasuleje siç ndodhin nëpër filmat fantastiko-shkencorë, është shumë e tmerrshme që të jenë fundi i njerëzimit që po e konsumon këtë botë dhe burimet e saj duke ngrënë e duke pirë.

Njerëzit e ndërgjegjshëm që mendojnë për veten, familjen, vendin dhe botën, duhet t'i thonë: "Ndal!", kësaj ecurie pa u shkatërruar dhe pa u kapluar edhe më shumë nga kjo çmenduri e konsumit dhe argëtimit. Në lidhje me këtë ecuri ka edhe statistika që tregojnë se nuk është një ecuri e mirë. Për shembull, amerikanët që nuk martohen, në mënyrë që të shëtisin dhe të jenë të lirë sa më shumë, janë ballë për ballë me probleme serioze shëndetësore dhe me rrezikun e vdekjes më të hershme. Sipas një studimi të bërë në Amerikë, është arritur në përfundimin se rreziku i vdekjes të meshkujt beqarë është 32% më i lartë se të meshkujt e martuar. Edhe sipas një studimi të botuar në revistën "American Journal of Epidemiology", është vënë re se ky rezultat te gratë është 23%. Madje, rreziku i vdekjes së beqarëve në moshën 30-39- vjeçare ka dalë 128% më i lartë se të martuarit në të njëjtën moshë. Ndërsa rreziku i vdekjes së beqarëve mbi moshën 70 vjeçare është vërejtur se rezulton 16% më i lartë se të ata të martuarit.

Shkencëtarët në "Universitetin Louisville", kanë studiuar edhe 90 punimet e bëra përgjatë këtyre 60 viteve të fundit në lidhje me këtë çështje. Ata kanë marrë në studim 500 milion njerëz. (Në këto punime, njerëzit e divorcuar nuk janë konsideruar si beqarë.)

Edhe shifrat e obezitetit janë në një shkallë alarmuese edhe në vendin tonë ashtu siç janë edhe në Amerikë dhe Evropë. Në një studim të botuar në revistën angleze "The Lancet", tregohet se obeziteti në të gjithë botën ka ndikuar te rreth 500 milion njerëz të rritur. Gjithashtu thuhet se obeziteti është shtuar dy herë më shumë në 28 vitet e fundit. Në këtë studim thuhet se kjo sëmundje ka ndikuar te 205 milion burra dhe 297 milion gra.

Lufta me sëmundjet e shekullit si zemra, damarët, tensioni, sheqeri, kolesteroli etj., në shoqërinë ku "njerëzit jetojnë për të ngrënë dhe nuk hanë për të

jetuar", po i konsumon tepër buxhetet e njerëzve dhe të shteteve. Kjo është pjesa që reflekton në shifra e rezultateve me të cilat përballen njerëzit e filozofisë së jetës me në qendër kënaqësinë (hedonizmi i Aristiposit).

Një filozofi epikuriane që mbron kënaqësinë shpirtërore sigurisht që mund të konsiderohet si një rrugëzgjdhje për vështirësitë e njeriut në këtë botë. Nëse nuk bëjmë israf, nëse nuk e çojmë dem kohën, nëse prodhojmë ndonjë gjë, nëse bëjmë ndonjë gjë për njerëzit e tjerë, nëse bëhemi të drejtë, të ndershëm, ndihmues dhe të ndërgjegjshëm, atëherë ka një lloj kënaqësie që mund ta ndiejmë në thellësitë e shpirtit tonë. Kjo kënaqësi mund të jetë edhe një faktor i fuqishëm që e bën njeriun të zgjedhë të mirën dhe të bukurën.

Ndërsa për ne myslimanët, asnjë kënaqësi fizike apo shpirtërore nuk mund të jetë dhe nuk duhet të jetë një gjë më e rëndësishme se fitimi i kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut Teala. Madje ne, argëtimin dhe dëfrimin që na e ka lejuar Ai, e kërkojmë brenda kufijve që ka vendosur Ai. Ne e dimë se, ngaqë jemi njerëz, kemi nevojë edhe për argëtim e kënaqësi. Hamë, pimë, argëtohemi dhe martohemi, por të gjitha këto e kanë një kufi. Kur ne e përjetojmë këtë kënaqësi fizike brenda këtij kufiri, në të njëjtën kohë përjetojmë edhe kënaqësinë shpirtërore që na e jep ky kufi.

Sipas mendimit të Prof. Nevzat Tarhanit, nëse njeriu e kalon me argëtim më shumë se 20% të kohës, përveç gjumit", atëherë kjo është në kundërshtim me natyrën psikologjike të njeriut. Zbavitja e njeriut deri në 20% të ditës është e mjaftueshme për sa i përket kënaqësisë që jep argëtimi. Perceptimi i këtij argëtimi ndryshon nga njeriu te njeriu. Për dikë mund të jetë argëtim ndjekja e një filmi apo organizimi i ndonjë loje, për dikë tjetër mund të jetë ndonjë gjë e zakonshme. Të lexuarit e një libri për një student që po përgatitet për provime, kryerja e pazarit për kuzhinën nga gruaja që është mërzhitur me punët e shtëpisë, shëtitja e familjes me makinë duke e çuar në ndonjë vend nga ana e burrit që është mërzhitur në punë, mund të perceptohen si argëtim. Madje, ka edhe njerëz që e konsiderojnë si argëtim preokupimin me ibadet, dhikër dhe lexim të Kuranit Fisnik.

E vërteta se liritë tona janë të kufizuara me përgjegjësitë që kemi ndaj vetes, njerëzit që na rrethojnë dhe Krijuesit dhe vlerat e qëllimit që i caktojnë këto përgjegjësi, janë faktorët më të fuqishëm që mund t'i mbrojnë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit nga rënia në kurthin e hedonizmit. Shikimi i të drejtës sonë për t'u argëtuar, mbart një rëndësi të veçantë për sa i përket lumturisë së individit, familjes dhe shoqërisë.

Shqetësohu

Ji besnik, ji trëndafil!

Halit Jasir Ozogyl

Në historinë e Lejlës dhe Mexhnunit, tregohet:

“Njëherë, Mexhnuni gjeti mundësinë dhe arriti të ulej së bashku me Lejlën, e cila për të provuar dashurinë e tij, i bëri një kërkesë:

- O ashik! Më sill çfarë ke e nuk ke!..

- Ah moj fytyrë hënë! -tha Mexhnuni. Për shkak të dashurisë ndaj teje nuk më ka mbetur as ujë, e as pus. As një pikë gjak në mëlçi, e as një pikë lot në sy. Ma bastise mendjen dhe ma vodhe gjumin. Tani kam vetëm shpirtin, urdhëromë të ta jap edhe atë!..

- Unë ta marr atë kur të dua. Por më thuaj çfarë ke tjetër?

Atë moment Mexhnuni kontrolloi veten dhe gjeti një gjilpërë që e kishte fshehur tek jaka. E nxori atë dhe ia ofroi dashurisë së tij.

- Ja, e vetmja gjë që posedojë në këtë botë është kjo gjilpërë. E nëse dëshiron të dish pse e mbaj me vete, po ta them: Kur endem nëpër shkretëtira e luginë duke të ndjekur ty, e humbas veten dhe aty më ngulen gjemba në këmbë e në trup. Dhe për t'i nxjerrë ato përdor këtë gjilpërë.

- Ja pikërisht këtë kërkova prej teje. Nëse dashuria jote do të ishte e vërtetë, si mund t'ia lejoje vetes këtë gjilpërë? Besnikëri është kjo nëse ti e nxjerr gjembin?!..”

Gjemb... të bën trëndafil, nëse je i tillë, ta merr buzëqeshjen prej fytyrës nëse je trëndafil... Ai është shqetësimi, dhimbja, kriza jote...

Me të vërtetë, po ti a ke ndonjë gjemb, apo gjemba që të marrin prej vetes, të cilët të janë ngulur në ndonjë vend, madje mu në mes të zemrës, për hir të një shqetësimi të drejtë? Përndryshe, si mund të jesh një “trëndafil”?

Në fakt, a nuk kemi ardhur në këtë botë që të bëhemi “trëndafilë”?

Të bëhesh trëndafil... Rrugëtimi hyjnor për t'u bërë rob i Zotit...

Të bëhesh trëndafil do të thotë të mund të jetosh me një gjemb apo me disa gjemba... Të dish se për ta bërë veten trëndafil, duhet të durosh gjembin që ke në gj... mbase edhe ta dashurosh...

Të të pyes edhe kështu: Ç'thotë gjembin yt? A është në vendin e vet dhe a e mban të gjallë shqetësimin tënd me atë dhimbje të mprehtë që të jep?

A e ndjen me të, përfundimin tënd absolut poshtë jastëkut kur shtrihesh dhe përball teje kur ngrihesh?

Kur ti je duke qeshur me të madhe, a i shndërron rrudhat që të formohen në fytyrë, në gjurmët e gomave që kanë frenuar buzëqeshjen tënde në mënyrë të hidhur?

Lugën e fundit të gjellës që çon drejt gojës për t'u ngopur, a të bën ta ulësh menjëherë me një shtytje magnetike? A të bën të sprovohesh me dashuritë e tua? A të ndodh që të mbetet në qiellzë shija e dashurive që ushqen pa pritur asgjë në këmbim? Apo mos ndoshta kur je duke menduar se po shijon ëmbëlsinë e lirisë, në kafazin e një jete që i ka dalë shija, të bën të ndihesh i detyruar të përshëndesësh me dorë që nga larg midis hekurave që nuk të nxënë as gishtat?

Si dukesh në përgjegjësinë e ofrimit të asaj që “ke”, atij që nuk e “ka”? A të bën ta bartësh ndër-mjet zemrave, atë që di, tek ai që nuk di, atë që gjen, tek ai që nuk mund ta gjejë, e atë që do, tek ai që nuk e njih fare?

Të mund ta ndjesh përbrenda një dhimbje në emër vëllazërisë, ndaj një padrejtësie, një hidhërimi, një fatkeqësie, një skamjeje dhe një krize, qoftë edhe diku larg, të cilën e merr vesh me mundësitë e kohës...

Ky pra është ai që quajmë “gjemb”. Ky është një shqetësim, një dhimbje, një djebie dhe një hidhërim, që duhet të të shpojë vazhdimisht ndonjë vend,

që duhet të mbetet aty dhe të të bëjë një trëndafil.

Një ndjenjë përgjegjësie që do t'i veshë një rrobë besimi të pavjetërsueshme zemrës sonë që herë pas herë hutohet me rrahje të ngurta në trupin tonë, i cili mbështillet përditë nga veshje të llojlojshme që kanë mbushur dollapët tanë deri në fyt...

Një vetëdije falënderimi që të mëson të ngresh kokën, të shohësh përreth dhe të bën t'i thuash vetes, "Çfarë halli paske ti!?"...

Mos vallë edhe ti je nga ata që, dikur e kishe për nder dhimbjen e një gjembi, ndërsa tani e ke nxjerrë prej trupit e shpirtit me një gjilpërë indiference dhe e ke flakur tutje? Në ç'gjendje je tani? A je i lumtur dhe i qetë?

A je i vetëdijshëm se barrën e shenjtë të besnikërisë që ke marrë mbi supe je duke e hedhur në një gropë të errët me zhytjen tënde në mirësitë e kësaj bote?

Ti, ishe! Tani nuk je! Ishe i shqetësuar, tani je shqetësuar...

Kush është i aftë të shqetësohet, është i aftë edhe të shpëtojë (të tjerët).

Ky gjemb duhet të mbetet aty... Aty në vendin ku është ngulur... Dhe duhet të mësohesh me nguljen e gjembave... Të mësohesh me ndjesinë e nguljes dhe dhimbjes që të jep... madje, duhet të shtosh edhe sexhdet për të falënderuar!..

Bëhu trëndafil, që të krijosh lidhje gjaku me ata që të përqafojnë!.. Bëhu trëndafil dhe barte në trupin tënd atë që do të të bartë në shpëtimin e përjetshëm!..

Bëhu trëndafil, që të bëhesh liqen për të eturit, të bëhesh mjalte për gojëmbllit, të bëhesh rrugë për të vërtetën, të bëhesh gjuhë për dashuritë, të bëhesh dorë për të rënë, të bëhesh hi me përulje, të bëhesh zile për të fjeturit...

Bëhu trëndafil!.. Bëhu ti ai trëndafil që do ta dehë botën!..

Pëshpëritjet e së vërtetës



— Ali Byjyqçapar —

Rruga për të fituar dituri është e mbushur me vështirësi. Njeriu i përvetëson në mënyrë të ndryshme njohuritë e nevojshme për jetën. Kjo periudhë që fillon me fëmijërinë, vazhdon gjatë gjithë jetës.

Kthimi i ditorisë në urtësi është kusht!

Përpara nesh shtrihen shkallët e së vërtetës dhe urtësisë, urdhëroni dhe ecni mbi to.

Njerëzimi i edukuar me adhurimin e Allahut sot po përjeton përvoja të hidhura në përpjekjet për t'i dhënë kuptim ekzistencës së vet. Njeriu e ka shumë të vështirë përballjen e përditshme me gjëgjëza të reja me shumë nivele. Teknologjia nuk ka hedhur as hapat e parë në takimin me virtytet. Mundësitë që na sjell para syve bota moderne, krijojnë tërmete në zemrat tona.

Çfarë veçantish kemi ne si myslimanë?

Altruizmin, drejtësinë, ndershmërinë, paqen, tolerancën, barazinë, kujdesin për të kursyer, dashurinë për familjen dhe patriotizmin.

Po mirë, cilat formacione na dalin para? Skllavëria, robëria, tirania, pandershmëria, intrigat, lufta, racizmi, një ndjenjë e asgjësë, konsumit, shpenzime të panevojshme, liria seksuale.

Aty janë dy anët e sprovës!

Pika jonë e fillimit është feja dhe besueshmëria. Kjo tregohet në mënyrën se si besojmë në Zot dhe se si lidhemi me Të dhe krijesat e Tij. Njeriu që beson në Allah ka mendje, shpirt, zemër dhe trup që i përshtatet këtij besimi dhe e manifeston atë në çdo aspekt. Në këtë mënyrë, ai është në paqe me veten dhe i lumtur e i suksesshëm në marrëdhëniet me të tjerët. Ai është në paqe dhe ka besim; në të njëjtën kohë plotëson nevojat e të dashurit dhe të qenit i dashur nga të tjerët. Ai është i durueshëm ndaj vështirësive dhe problemeve që i dalin përpara. Çdo gjë, e mirë dhe e keqe, ndriçohet me dritën e besimit. **"Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Ai jep jetë e vdekje dhe është i fuqishëm për çdo gjë."** (Hadid, 2)

Dashuria futet në zemër me ndihmën e emrave të Allahut. Vështirësitë e dashurisë lehtësohen dhe njeriu fiton virtyte që e lejojnë ta pranojë trëndafilin së bashku me gjembat e veta. Kur dëshira për të fituar kënaqësinë e Allahut kthehet në virtyt, qenia merr flatra dhe mëson të vërtetën universale.

Largojini dyshimet dhe ktheni përgjigje thirrjes së Allahut, asaj thirrjeje që përsëritet pesë herë në ditë. Çfarë kuptimi ka frika kur pranë nesh qëndron Krijuesi i Gjithësisë, Ai që na jep jetë?

Çdo ditë, bota krijohet nga fillimi.

Le të na shpëtojë kujtesa se në këtë botë të llogaritjeve, ekziston edhe llogaria që do japim para Krijuesit tonë... Një vetëdije e tillë do të na shpëtojë nga vështirësitë. Mëshira e Allahut do t'u sjellë paqe zemrave tona.

Allahu është i Plotfuqishëm!

SULEJMAN PASHA

NGADHNJIMTARI I DETIT TË KUQ DHE OQEANIT INDIAN

— Dr. Ardian Muhaj —



Sulejman Pasha lindur rreth vitit 1467 dhe vdekur në shtator 1547, ishte shqiptar dhe ka qenë edhe vali i Hixhazit, pra i Mekës dhe Medinës, deri sa arrin të bëhet edhe kryeministër i Perandorisë Osmane mes viteve 1541 dhe 1544.¹ Gjatë viteve 1525–1535 dhe 1537–1538, ishte guvernator i Egjiptit. Pas udhëtimeve të para të Vasko De Gamës portugezët vendosën kontrollin në rrugët tregtare të Oqeanit Indian e Detit të Kuq. Mirëpo pasi osmanët vendosin kontrollin mbi Egjiptin në vitin 1517 dhe falë masave efikase të ndërmarra nga Sulejman Pasha pozita strategjike e osmanëve në Oqeanin Indian u forcua në mënyrë të dukshme.² Suksesi i tij në përballjen me portugezët në Detin e Kuq dhe Oqeanin Indian qe shkaku kryesor i emërimit të tij në postin e Kryeministrit osman. Në kohën kur Sulejman Pasha u emërua kryeministër i shtetit osman politika e ndjekur prej tij i kishte detyruar portugezët që të kërkojnë të merren vesh me osmanët rreth tregtisë së erëzave në vend që të kundërshtojnë ekspansionin në Oqeanin Indian me forcë. Më 1540, portugezët i kishin propozuar Portës së Lartë që t'i furnizonin një sasi vjetore prej 2,500 deri në 3,000 kuintal erëzash dhe t'i shkarkonin në Basra. Porta e Lartë këmbënguli që kjo sasi të transportohej në anije osmane prej portit të pavarur të Kalkutës në Indi. Që në fillim të emërimit të tij si qeveritar i Egjiptit u shqua për gjenialitetin dhe aftësinë e tij. Më 1532 ai projektonte seriozitetin dhe kujdesin më të madh teknik hapjen e kanalit të Suezit që do të lidhte Mesdheun me Detin e Kuq, duke shfrytëzuar edhe rrjedhën e Nilit. Punimet duket se filluan por nuk u përfunduan për arsye të ndryshme.³ Sulejman Pasha dinte të mblidhte rreth vetes njerëz të aftë e me përvojë në lundrimin oqeanik.

1. «shqiptar prej memalikëve të Sulltan Sulejmanit». Kutbud-din M - hammed bin Ahmed En Nehralvi, *Kitabul Alam bil Alam Bejtullahi el Haram- Geschichte der Stadt Mekka und ihres Temples. Nach den Handschriften zu Berlin, Gotha und Leiden*, herausgegeben von Ferdinand Eüstenfeld, vëll. III, Leipzig, 1857, f. 300-301; Barros, *Quarta década da Ásia...*, kap. II, f. 636, e njëjri si jeniçer nga Morea. “de nação grego ianiçaro, natural da Morea”.

2. Giancarlo Casale, “The Ottoman Administration of the Spice Trade in the Sixteenth-Century Red Sea and Persian Gulf”, *Journal of the Economic and Social History of the Orient*, 49/ 2 (2006), f. 173

3. Salih Özbaran, *Umman'da kapısın imparatoruklar. Osmanlı ve Portekiz. Emperyal ve kutsal, muhafız ve mültezim*. Istanbul: Tarihiç Kitabevi, 2013, f. 145.

Baza mbështetëse e tij ishin këshilltarët dhe specialistët me origjinë italiane të cilët kishin një interes të veçantë në kontrollin osman në tregtinë fitimprurëse të erëzave. Këta këshilltarë të afërt të tij përfshinin anëtarë me influencë të bashkësisë hebreje iberike si Abraham Castro, që mori drejtimin e doganës së Aleksandrisë me mbështetjen e Sulejman Pashës si edhe dy venecianë të konvertuar në myslimanë Giovanni Contarini dhe Gian Francesco Giustiniani⁴, që vinin nga familje të njohura veneciane dhe madje edhe një rob portugez me përvojë në Oqeanin Indian, Diego Martins, të cilin Giustiniani e Contarini e bindën të bëhej mysliman dhe t'u bashkohej atyre në rrethin ngushtë të këshilltarëve të Sulejman Pashës dhe në orientimin e politikës osmane drejt tregtisë së erëzave të Oqeanit Indian.⁵ Simbas burimeve portugeze edhe vetë kërkesa e Sulltanit të Guzeratit për të kërkuar ndihmën e Stambollit kundër portugezëve, kishte ardhur si pasojë e ndërhyrjes së një italiani të vendosur në Indi, Hoxha Sefer nga Otranto.⁶ Ky po ashtu ishte edhe burimi kryesor i informacionit për Sulejman Pashën. Në njëfarë mënyre vetë fushata indiane e Sulejman Pashës ishte një përpjekje e sukseshme e lobit shqiptaro-italian në Egjipt për të marrë mbështetjen e Portës së Lartë në synimin e tyre për të ndërhyrë në tregtinë fitimprurëse të erëzave që ishte në duart e portugezëve.⁷

Megjithëse përballja mes flotave detare osmane dhe portugeze në shek. XVI në Oqeanin Indian zhvillohej

4. Nga fundi i shekullit XVI udhëtari veronez Filippo Pigafetta gjeti një numër të madh italianësh që punonin në bazën detare të Suezit duke përfshirë sanxhakbeun që ishte Italian nga Pontremoli. “Vi sono anche parecchi rinnegati italiani col sangiacco, che è di Pontremoli, per il servizio delle galere.” Pigafetta, “Il Golfo di Suez e il Mar Rosso,” f. 305.

5. Kronikat arabe e quajnë Sulejman Basha et-Tauashi er-Rumi, mbase në zonën e Gjirit Persik dhe të Oqeanit Indian osmanët e ardhur nga Mesdheu nuk quheshin turq por rumë. R. B. Serjeant, *The Portuguese off the South Arabian Coast. Hadrami Chronicles. With Yemeni and European Accounts of Dutch Pirates off Mocha in the Seventeenth Century*, Oxford: Clarendon Press, 1963, f. 60-85.

6. Barros, *Quarta década da Ásia...*, kap. VII, f. 653.

7. Kronisti portugez Barros, pohon se Sulejman Pasha kishte kërkuar me ngulm që ta ndërmerte ai këtë fushatë dhe se të gjitha shpenzimet do t'i mbulonte vetë, ngaqë ishte shumë i pasur dhe se nga Stambolli nuk kishte kërkuar asgjë tjetër përveç ushtarëve dhe artilerisë. Barros, *Quarta década da Ásia...*, kap. II, f. 636.

larg teatrit të Mesdheut, në fakt të dy fuqitë detare ishin në pjesën e tyre më të madhe me origjinë mesdhetare.⁸ Me gjithë këtë origjinë të përbashkët mesdhetare detarët e secilës palë e shihnin veten në këndvështrime të ndryshme. Portugezët si pjesë e një kombësie të mbështetur në lidhjen e gjakut ndërsa osmanët si pjesë e një «perandorie» kozmopolite.⁹ Duhet theksuar se çdo diskutim mbi identitetin etnik në kontekstin osman përballet me një problem të terminologjisë. Evropianët e shekullit XVI, ngjashëm me shumë autorë të sotëm zakonisht i quajnë osmanët si «turq». Në fakt, ky term është përdorur nga evropianët si një term përgjithësues për çdo mysliman të çfarëdo origjine etnike madje vetë banorët e Evropës Perëndimore që konvertoheshin në myslimanë quheshin «turq».¹⁰ Nga ana tjetër në perandorinë osmane këndvështrimi ishte krejt tjetër. Termi «turk» si etnonim përdorej rrallë dhe si rregull përshkruante fiset nomade turqishtfolëse.¹¹ I mirëinformuar Diogo do Couto shpjegon qartë se ata që në Indi quheshin «Rumë» ishin në fakt ballkanas dhe jo turq nga «Turkistani», dhe kanë të drejta të barabarta qofshin hebrenj, të krishterë apo myslimanë.¹²

Rasti i Sulejman Pashës që ishte oborrtar me origjinë nga Shqipëria nuk ishte i vetëm. Selman Reis, admiral i parë osman i Suezit ishte grek i islamizuar nga Lesbosi. Sefer Reis, që për shumë vite ushtroi korsarinë në detin Arabik dhe më pas u gradua admiral më 1560 ishte një hebre iberik i islamizuar. Një rast i veçantë e përbëjnë italianët të cilët tërhiqeshin nga karriera në flotën osmane. E njëjta gjë ndodhte edhe me flotat osmane të Mesdheut.¹³ Që në vitin 1509, kur portugezi Francisco de Almeida mundi një flotë egjiptiane e përbërë kryesisht nga vullnetarë osmanë në mesin e plaçkave të gjetura në anijet osmane, portugezët për habinë e tyre të madhe gjetën një numër librash në latinisht e italisht, madje edhe një psalter në portugalisht.¹⁴ Hoxha Sefer, nga Otranto, i marrë rob i ri ia doli të bëhej kapedan i galerës së vet dhe më pas shkoi në Indi ku u bë guvernator i Suratit dhe bashkëpunoi gjatë gjithë kohës me Sulejman Pashën gjatë rrethimit të fortesës së Diut. Një portugez çdo vit i sillte Hoxha Seferit në fortesën e tij në Surat letra

nga e ëma e tij italiane. Jihangir Khan, një «Rum» me origjinë italiane që kishte shërbyer nën sulltanët e Gujaratit, u recitonte robërve portugezë pasazhe të gjata të Petrarckës dhe Ariostos.

Edhe ekuipazhet ishin akoma edhe më të larmishëm etnikisht se sa komandantët. Kronisti venedikas që mori pjesë në këtë ekspeditë pohon se pashai shqiptar përdori si pretext shpërthimin e konfliktit me Venedikun më 1537 duke i marrë të gjithë venecianët që gjendeshin në Aleksandri, dhe i dërgoi në Kajro ku u zgjodhën artillerët, rremëtarët, marangozët dhe oficerët për tu dërguar në Suez me qëllim përgatitjen e flotës. Madje edhe 146 portugezë të zënë rob gjatë fushatës u vunë në punë nëpër anije. Mbasi osmanët morën rugën e kthimit drejt Detit të Kuq garnizoni portugez që mbronte fortesën zuri rob një numër ushtarësh që nuk kishin mundur të hipnin nëpër anije dhe të cilët i identifikuan si grekë, shqiptarë dhe siçilianë.

Gjatë kësaj fushate detare Sulejman Pasha, u tregua një komandant i aftë dhe i mençur. Më vonë kur flota osmane u rikthye nga India dhe u ankorua në Suez admiral shqiptar njoftoi se të gjithë venedikasit e detyruar për të shërbyer në këtë fushatë do të paguheshin njësoj sikur forcat e rregullta osmane.¹⁵

Por roli i Sulejman Pashës nuk mbaroi me rrethimin e fortesës indiane të Diut. Me urdhër të tij një flotë e vogël osmane nisët për të eksploruar ujërat që gjendeshin më në lindje të Indisë, duke mbërritur në Malajzi e Tajlandë. Në krye të saj Sulejman Pasha caktoi Hajredin Mehmet Reisin. Kapiteni osman është ndarë nga Sulejman Pasha në portin e Diut në Guzerat të Indisë. Duke ndjekur brigjet perëndimore të Indisë (brigjet e Malabarit) ka zbritur nga Diu, në 21 gradë gjerësi gjeografike dhe mbasi ka kaluar ngushticën e Palkut ndërmjet Indisë dhe Cejlonit, ka mbërritur në gjirin e Bengalit. Është ndaluar në Tenaserim në verilindje të gadishullit të Malajës, 12 gradë gjerësi gjeografike, në Burman e sotme. Për shkak të dëmtimit të anijeve gjatë udhëtimit iu bë e pamundur ribashkimi me flotën e Sulejman Pashës dhe u detyrua që t'i shërbejë mbretit të Siamit me një rrogë të majme duke kryer veprime ushtarake në Laos me flotën e tij.¹⁶ Mbi arsytet që e shtynë shqiptarin Sulejman Pasha të urdhërojë këtë ekspeditë drejt vendeve më të largëta të Azisë nuk mund të hamendësojmë, por fakti është se ky shqiptar u bë ideatori dhe mbështetësi i udhëtimit më të largët të kryer deri atëherë nga flota osmane në lindje. Kjo ekspeditë e mbështetur prej tij, arrin të njohë dhe të eksplorojë zona të Lindjes së Largët, të cilat prej evropianëve vetëm portugezët kishin arritur deri atëherë t'i eksploronin.

8. Özbaran, *Umman'da kapisan imparatoruklar. Osmanlı ve Portekiz...* f. 146-152.

9. Casale, «The Ethnic Composition of Ottoman Ship Crews...», f. 122-123.

10. Si në shprehjen anglisht «to turn Turk,» me kuptimin «to convert to Islam». E ilustron këtë më së miri tragjedia e autorit anglez Robert Daborne, *A Christian turn'd Turk. Or the Tragical Lives and Deaths of the Two Famous Pirates, Ward and Dansiker*, London, 1612.

11. Casale, «The Ethnic Composition of Ottoman Ship Crews...», f. 124.

12. Couto, *Da Ásia*, vol. 4, libri. 8, kap. 9.

13. «i numerosi rinnegati, pure partecipando alla vita dei Musulmani, non dimenticavano mai la parlata di origine... Numerosi erano glia Assan, Iussuf, Mami, Morato, Mustafa che si dicevano Genovesi, Napoletani, Ferraresi, Veneziani o Messinesi... e ciascuno di questi rinnegati manteneva ottime relazioni con la famiglia in Italia». Nullo Pasotti, *Italiani e Italia in Tunisia dalle origini al 1970*, Roma: Finzi editore, 1970, f. 12-13.

14. Simbas Halil Inalçik, «The Meaning of Legacy: The Ottoman Case», në *Imperial Legacy: The Ottoman Imprint on the Balkans and the Middle East*, ed. L. C. Brown. New York: Columbia University Press, 1996, f. 19: «The Ottoman Empire was not a «Turkish empire». It was a multilingual, multireligious, and multicultural political system».

15. «Relation of the Expedition of Solyman Pacha,» f. 286.

16. Taskiran, «Les relations ottomano-portugaises au XVI^e siècle», f. 134-135.

Ibrahimi: persekutim, shpëtim dhe përtëritje

— Hatem Bazian —

Kapituj të rinj të narrativës abrahamike janë duke u shkruar ndërsa refugjatët e sotëm presin me frikë dhe shpresë në rrugët, trenat e kufijtë e vendeve europiane.

Haxhi, pelegrinazhi i përvitshëm për në Mekë, haxhi, një ritual i lashtë që të çon te Ibrahimi, gjendet në prag, dhe është një rast i përsosur për ta kontekstualizuar tubimin e këtij viti me krizën e refugjatëve që nuk ka të ndalur. Sigurisht që kjo nuk është hera e parë që bota ka parë një katastrofë njerëzore me reagime të panumërta, që mbulojnë spektrin nga tejet ksenofobike të mikpritja profetike,



e çiltër dhe frymëzuese, nga njerëz në Gjermani, Suedi, Islandë, e gjetkë.

Karakteri profetik është ai çka nevojitet saktësisht sot më tepër se kurrë, dhe një reflektim mbi narrativën e Ibrahimit flet drejtpërdrejt mbi katastrofën njerëzore që po ngjet dhe mbi mënyrën e nisjes së trajtimit të saj. Narrativa e Ibrahimit ofron një tablo të rëndësishme së kurajës rinore në ngritjen e zërit për shpërndarjen, prishjen dhe besimet e gabuara të shoqërisë dhe në përballjen me to. Frika prej pasojave të ndryshimit, prej reagimit të shoqërisë, duke përfshirë të atin e Ibrahimit, ishte një mbështetje e atypëratyshme për dhunën, persekutimin dhe një dënim të shpejtë me vdekje me djegie në sy të njerëzve. Ndëshkimi nuk u dha për asnjë arsye tjetër veç thënies të së vërtetës pushtetit dhe tregimit të kontradiktave të pranishme në shoqëri.

Sigurisht, Zoti ndërhyri për ta shpëtuar Ibrahimin nga zjarri, që u pasua nga ikja dhe strehimi në tokën e Kenanit, apo të Palestinës së ditëve të sotme. Ikja nga Mesopotamia, që përfshin Irakun e sotëm, pjesë të Turqisë juglindore, Sirinë lindore dhe Iranin jugor, drejt Kenanit është e ngjashme me largimin aktual të refugjatëve drejt sigurisë, për t'i ikur luftës dhe konfliktit. Ajo çfarë ishte spikatëse atëherë, dhe që duhet të ofrojë sot frymëzim dhe udhëzim, është se kenanasit e mirëpritën dhe e lejuan Ibrahimin të jetonte në mesin e tyre.

Por historia nuk ndalon në Kenan. Ajo vazhdon me një vizitë në Egjipt, me një takim sfidues me faraonin, dhe me një kthim në Kenan, por këtë herë gjithashtu me Haxherin që hyn në narrativë. Komplexiteti shtohet ndërsa Ibrahim bashkëjeton me Haxherin, çka sjell lindjen e fëmijës së tij të parë, Ismailit. Shterpësia e Sarës dhe lindja e një fëmije nga Haxheri çon në tension, rrjedhojë e të cilit është një tjetër mërgim për një pjesë të familjes. Referenca kur'anore flet për Zotin që e urdhëron Ibrahimin t'i vendosë Haxherin dhe Ismailin në luginën e shkretë dhe të thatë të Mekës.

Muslimanët që po nisen për të kryer haxhin shkojnë në gjurmët e Haxherit dhe Ismailit. Mbetesh gojëhapur nga narrativa e Haxherit, që ka atë duke vrapuar e shpërmendur mes dy kodrave, Safës dhe Merves, në kërkim të një pike uji për të birin, Ismailin, pasi u kishte mbaruar gjithçka që kishin dhe qenë të vetëm në luginë. Zemzemi, burimi i ujit, ishte ndërhyrja e Zotit në shpëtimin e Ismailit dhe të nënës së tij, dhe vënia në lëvizje e elementit bazë të qytetit të ardhshëm të Mekës. Çka është më e rëndësishme, Haxheri u pajtua ta ndajë burimin e

Zemzemit me një fis arab që po kërkonte të ulej dhe të gjente një burim për të pirë. Është një narrativë përpjekjeje, agonie dhe ikjeje, por është po ashtu një narrativë mbi besimin në Zot, mbi këmbënguljen dhe durimin në përballimin e vështirësive që i kalojnë caqet.

Sot Haxheri përfaqëson nënat, bijat dhe motrat siriane të familjeve të ndara më dysh, të shtëpive të shkatërruara, të qyteteve të rrënuara, dhe të një bote të mpirë karshi vuajtjes. Sot Haxheri është mishërim i nënave refugjate që vërshojnë nga Iraku, Egjipti, Libia, Somalia, Republika e Afrikës Qendrore, Palestina, Tunizia, Afganistani, Mjanmari, Nigeria dhe Jemeni, për të përmendur atë çka është e dukshme dhe e njohur, por mund të përfshihen shumë më tepër. Ismaili në duart e nënës së tij mendjehumbur përfaqëson të gjithë fëmijët e hedhur përtej kufijve dhe ujit pa patur mjaftueshëm për të ngrënë, për të pirë, pa patur një shtrat të rehatshëm për të fjetur, apo pa patur një bataniye për t'i mbuluar prej natës së ftohtë.

Në këtë ditë Ismaili përfaqëson djemtë dhe vajzat e vogla që po presin prekjen e butë të babait, vëllait apo kushëririt të mbajtur larg, në qelitë e burgut, të kyçur brenda për asnjë arsye tjetër veç dëshirimit të një jetese të denjë, të drejtësisë dhe dinjitetit, që janë bazat e një shoqërie. Në të vërtetë, ca fëmijë nuk kanë për t'i parë kurrë prindërit, sepse makineritë e vdekjes e kanë marrë tanimë dhe e kanë shuar potencialin e tyre njerëzor, dhe një boshllëk do t'u jetë gjithmonë i fshehur në zemër, me besimin se kanë për t'u takuar në xhennet.

Haxheri dhe Ismaili e ndanë ujin dhe ushqimin me të huajt që erdhën duke kërkuar një pikë për të shuar etjen. Në këtë moment, në të gjithë Europën, njerëz me karakter madhështor dhe profetik po vihen në radhë për t'i mirëpritur të huajt dhe refugjatët në mesin e tyre, duke u hapur shtëpitë, kuzhinat, tokat dhe feramat, për t'i ndarë me ta. Frika dhe shpresë po ndeshet në rrugë, në trena, dhe në kufijtë e Europës, e kapituj të rinj të narrativës abrahamike po shkruhen në përmasa të vogla dhe të mëdha. Vdekja e Ajlan Kurdiut në brigjet e Mesdheut është shpërthimi simbolik i ditëve të sotme i Zemzemit, i cili njom zemra njerëzore të mbështjella nga indiferenca, frika dhe mungesa e shpresës para gjëmës së shpërfaqur. Vdekja e Kurdiut u ka dhënë mundësinë e jetës shumë të tjerëve, dhe trupi i tij i vogël i pajetë ka nxitur nisjen e një transformimi në reagimin global ndaj krizës së refugjatëve, dhe në këtë ai ka për të qenë gjithmonë i gjallë dhe i pranishëm.



DY LLOJE PUSHTIMESH

— Edison Çeraj —

Mund të biem fare mirë në ujdj që pushtimi i një vendi është i padrejtë, por, nga ana tjetër, praktikisht ka ndodhur dhe do të ndodhë gjithmonë. Një ndër të vërtetat e pakta të cilën mund ta themi me bindje të plotë është edhe i mirënjohuri ligji i xhunglës: më i forti bën ligjin (zakonisht e zhbën). Pajtohemi apo nuk pajtohemi me këtë, kjo është e vërteta. Një e vërtetë tjetër më e hidhur se kjo është se përgjithësisht të gjithë bëhen me më të fortin, por kjo është një temë tjetër.

Përtej kësaj, meqë pushtimi si i tillë është po aq i paevitueshëm sa vetë graviteti, ajo për të cilën është më e nevojshme të flasim është natyra e pushtimit, lloji i tij.

Në thelb, historia na tregon për dy lloje pushtimesh: i pari ka qasje tjetërsuese ndaj të pushtuarve, duke u imponuar (me lloje të ndryshme dhune) atyre atë që pushtuesi njih si të drejtë; kurse i dyti ua njih të pushtuarve identitetin dhe veçoritë që kanë, madje mund të themi që i mbron.

Le të marrim dy raste jo dhe aq thellë në histori, që pak a shumë kanë pasur një zhvillim paralel: pushtimet osmane dhe ato spanjolle. Pa dashur të vë gishtin se ky është i miri dhe ai i keqi, gjë që do të ishte përgjithësim, dhe për rrjedhojë gabim, dua vetëm të kujtoj këtu çfarë mbeti pasi këto perandori humbën hapësirat e ndryshme gjeografike që kishin nën sundim. Më konkretisht, Perandoria Osmane qëndroi mbi pesë shekuj në Ballkan e më gjerë, dhe kur u tërhoq nga kjo hapësirë, siç jemi dëshmitarë, popujt e ballkanit mbetën po ata, me identitetin, gjuhën dhe zakonet përkatëse. Sot shqiptari është shqiptar, serbi serb, greku grek, bullgari bullgar, kroati kroat e kështu me radhë. Por, jo e njëjta gjë ndodhi me hapësirat që pushtuan spanjollët, ku vende si Argjentina, Meksika, Kili, Bolivia, Paraguai, Kolumbia, Peruja, Ekuadori etj., në shumicë dërrmuese kanë fenë e pushtuesit dhe flasin gjuhën e tij.

Kjo është një analizë themelore jo thjesht si reflektim mbi të kaluarën, por mbi të gjitha për të përfutur dhe kuptuar më mirë të sotmen, në rastin tonë Ballkanin, një hapësirë gjeografike me kaq shumë diversitet, dhe si e tillë me kaq shumë dinamikë, gjë që nuk ndodh në Amerikën Latine.

Ky është fakt, jo interpretim, pavarësisht se sipas Nietzsche-s nuk ka fakte, por vetëm interpretime.

Në këtë rast shtrohet pyetja se si mund të shpjegohet ky ndryshim mes këtyre dy pushtimeve. Ndoshta arsyeja kryesore e këtij ndryshimi qëndron në faktin se feja islame që mbante Perandoria Osmane i njeh/

pranon fetë e tjera, kurse feja e Perandorisë Spanjolle (Krishterimi) nuk i njeh/pranon ato, si Hebraizmin dhe Islamin, pasi sipas të krishterëve, hebrenjtë mbeten vrasësit e Zotit, kurse muslimanët ndjekës të një profeti të rremë.

Siç dihet, kur ra Andaluzia dhe erdhën në pushtet Ferdinandi dhe Elizabeta, për hebrenjtë dhe muslimanët u lëshua një ultimatum: ose pranoni Krishterimin, ose duhet të largoheni nga ky vend. Dihet po ashtu se shumë hebrenj, si pasojë, emigruan në Stamboll dhe në hapësira të tjera të Perandorisë Osmane, ku iu dha mundësia të jetonin si çdo nënshitetas tjetër, madje edhe të bënin karrierë në fusha të ndryshme, një ndër to mjekësia.

Vlen të theksojmë se deri para shpikjes së kombeve në shekullin XIX, ajo që i dallonte më shumë njerëzit ishte besimi/feja, ja pse duhet pasur parasysh ky element në këtë çështje.


Një krahasim tjetër po kaq i rëndësishëm, në mos më shumë, është dhe pushtimi në të shkuarën dhe sot. Siç e thamë, pushtimi si fenomen, që lidhet me më të fortin, me sa duket është një lloj ligji natyror që shfaqet në forma të ndryshme. Pra, thelbi mbetet po ai, ndryshon vetëm forma. Sot kemi një perandori (në të gjitha kuptimet e fjalës) që e njohim si Bashkimi Europian. Ndryshe nga perandoritë e djeshme, të cilat e realizonin pushtimin duke hyrë në çdo vend ku u jepej mundësia, me perandorinë e BE-së ndodh e kundërta: janë vendet/shtetet që duan të hyjnë brenda saj, që ndryshe mund të quhet një lloj vetëpushtimi nën efektin e magjisë “integrim”.¹ Por, që integrimi i një vendi të bëhet realitet, duhet plotësuar një e ashtuquajtur paketë kushtesh. Pra, një vendi kandidat i duhet të përshtatet pothuajse në çdo gjë të rëndësishme që lidhet me identitetin e tij, që t’i hapet më pas drita jeshile e hyrjes. E thënë ndryshe, që një vend të bëhet pjesë e BE-së duhet t’i nënshtrohet një procesi çidentifikues.

Këtë presion çidentifikues BE-ja nuk e bën thjesht sot, por ka një traditë shekullore të disa prej vendeve të saj në këtë drejtim, siç e pamë në rastin e pushtimeve spanjolle dhe raste të tjera të kësaj natyre.

Sipas këtij botëkuptimi, një vend/shtet nuk duhet të jetë ai që është, por ai që “duhet” të jetë. Pikërisht këtë trysni përjeton sot edhe individi: pse jam ky që jam dhe jo një tjetër!?

1. Pushtimi fillon me dijen.

IMAGJINATA DHE REALITETI



Fëmija, shpesh herë, kishte pësuar ndërprerje mësimi në shkollën nëntëvjeçare për shkak të punës së babait të tij. Kur ishte në klasën e gjashtë, mësuesi i kërkoi që të shkruante një ese në lidhje me temën se çfarë dëshironte të bëhej dhe të bënte kur të rritej.

Fëmija u ul gjithë natën dhe shkroi një ese 7 faqëshe, në të cilin tregonte se një ditë synonte të kishte fermë kuajsh. Imagjinatën e tij e kishte shpjeguar deri në detajet më të vogla. Madje kishte vizatuar edhe planin e fermës prej 200 dynymëve që kishte në mendje. Aty kishte treguar vendin e ndërtesave, të ahureve dhe vendet e rrugëve për vrap. Planit të fermës i kishte shtuar edhe planin e detajuar të shtëpisë prej 1000 metrave që do ta bënte në fermën prej 200 dynymësh. Detyra 7 faqëshe që ia dha mësuesit ditën e nesërme ishte plotësisht zëri i zemrës së tij...

Pas dy ditësh e mori detyrën. Mbi letër ishte shkruar një "0" e madhe me stilolaps të kuq. Gjithashtu gjendej edhe urdhëri: "Eja më tako pas mësimit!"

-Përse kam marrë zero?- e pyeti fëmija pasi e takoi.

-Kjo është një imagjinatë, jo reale për një fëmijë në moshën tënde. Para nuk ke. Familja jote vazhdimisht shpërngulet nga një vend në tjetrin. Nuk keni ndonjë burim të ardhurash. Për fermën e kuajve duhen shumë para. Së pari duhet të bleh tokën... Gjithashtu duhet të marrësh edhe kafshë për mbarësim. Këtë nuk mund ta bësh dot. Nëse e bën përsëri detyrën duke vendosur synime reale, atëherë do të flasim përsëri për notën tënde.

Fëmija u kthye në shtëpi dhe mendoi gjatë e gjatë. Ai u konsultua edhe me babain e tij. Babai i tha:

-Bir, në lidhje me këtë çështje duhet ta japësh vendimin vetë. Kjo është një zgjedhje mjaft e rëndësishme për jetën tënde."

Pasi fëmija u mendua përgjatë një jave, detyrën ia çoi përsëri mësuesit pa bërë asnjë ndryshim dhe i tha:

-Ju mund të mos e ndërroni notën që më keni vendosur... Edhe unë nuk do t'i ndërroj synimet e mia...

NJË THËNIE

"Ju humbni të mirën ndërkohë që përpiqeni të gjeni më të mirën."

(William Shakespeare)

NJË LUTJE

"O Zot! Kërkoj të më japësh dashuri ndaj Teje, dashuri ndaj atij që të do Ty dhe vepër që më shpie te dashuria jote! O Zot! Bëje dashurinë Tënde për mua më të dashur se veten time, familjen time dhe ujin e ftohtë!"

(T'irmidhi, Deavat, 72)

FAKTE INTERESANTE

• *Planeti Venus (Afërdita) rrotullohet rreth vetes në anën e kundërt të të gjithë planetëve në sistemin diellor.*

• *Temperatura trupore më e lartë që mund ta durojë njeriu për të jetuar është 46,5 gradë. Ndërsa temperatura normale është 35-37 gradë.*

• *Fluturat marrin shije nëpërmjet këmbëve.*



PLANETI NË TË CILIN

DIELLI LIND NGA PERËNDIMI

— Muaz Erdem —

AFËRDITA, E CILA NJIHET SI MOTRA E TOKËS ËSHTË PREJ PLANETËVE QË E KA TËRHEQUR MË SË SHUMTI INTERESIMIN E NJERIUT. AFËRDITA ËSHTË PLANETI NË TË CILIN JANË DËRГУAR MË SHUMË MJETE KOZMIKE DHE NË SIPËRFAQEN E TË CILIT GJENDEN MË SË SHUMTI MJETE TË TILLA TË NDËRTUARA NGA NJERIU. EDHE PSE NË VITET E ARDHSHME KËTË CILËSI DO T'IA JAPË MARSIT, TANI PËR TANI SITUATA ËSHTË E TILLË.

Çdo ditë që kalon ndiejmë se po i afrohem më me shpejtësi kiametit. Kështu që kemi filluar t'i shohim një nga një shenjat e kiametit të cilat na i ka treguar i Dërguari i Allahut (a.s.). Përveç shenjave të kiametit si zbritja e Isait (a.s.), shfaqja e Jexhuxh Maxhuxhëve dhe dalja e tymit që përmeden nëpër hadithe, ka edhe një shenjë tjetër që i ka bërë njerëzit të mendojnë: “Lindja e diellit nga perëndimi”.

I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë në një hadith që transmetohet nga Buhari, Muslimi dhe Ebu Davudi: “Kiameti nuk do të ndodhë derisa dielli të lindë nga perëndimi. Kur të lindë nga perëndimi, njerëzit do ta shohin dhe të gjithë do të besojnë. Por ky besim nuk do të ketë dobi për asnjë që më parë nuk ka pas besuar apo që nuk ka arritur ndonjë mirësi me përmallimin ndaj besimit.” Fakti që lindja e diellit nga perëndimi është prej shenjave të mëdha të kiametit dhe që

do të ndodhë para të tjerave, e bën këtë fenomen shumë më të rëndësishëm.

Dalja e diellit nga Lindja është një fenomen që ka lidhje me rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj. Toka rrotullohet nga perëndimi në lindje dhe për këtë arsye, dielli sipas nesh del nga lindja dhe humbet në perëndim. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për planetët e tjerë në sistemin diellor. Përveç njërës. Ky planet në të vërtetë është një planet që e shikojnë të gjithë duke filluar që nga bariu në mal e deri te njeriu në qytet, sepse ai është objekti më i shndritshëm pas hënës në qiell përgjatë natës. Dikush atë e ka quajtur ylli i mëngjesit. Dikush e ka quajtur ylli i mbrëmjes. Dikush tjetër e ka quajtur ylli i bariut. Në të vërtetë, ai nuk është një yll, por është Afërdita e cila është planeti më i afërt me Tokën.

Afërdita, të cilës i thuhet edhe Venus, sikundër

planetëve të tjerë në sistemin diellor, rrotullohet rreth boshtit të saj nga lindja në perëndim. Për këtë arsye, dielli në Afërditë nuk del nga lindja, por nga perëndimi. Fenomenet e mbinatyrshme në Afërditë nuk janë të kufizuara me këtë. Një ditë e Afërditës e cila gjendet afërsisht 108 milion kilometra larg diellit, është më e gjatë se një vit i saj. Afërdita e plotëson rrotullimin rreth diellit për 224 ditë, ndërsa rrotullimin rreth vetes e plotëson për 243 ditë.

Edhe pse Afërdita është planeti i dytë më i afërt me diellin, ajo prapë se prapë është më e nxehtë se Merkuri i cili është planeti më i afërt me diellin. Nxehtësia në sipërfaqen e Afërditës arrin deri në 464 gradë celsius. Kjo nxehtësi e frikshme e Afërditës që të kujton xhehenemin, shkaktohet prej atmosferës së dendur. Edhe pse në të kaluarën Afërdita ka pasur përafërsisht të njëjtat vlera karboni me Tokën, ajo e ka djegur karbonin për shkak të nxehtësisë në sipërfaqe. Kështu që tashmë ka një atmosferë që 97% e saj përbëhet nga dyoksidi i karbonit. Retë e dendura që formohen nga dyoksidi i karbonit i reflektojnë në gjithësi dy të tretat e rrezeve që vijnë nga dielli. Ndërsa pjesën tjetër që mbetet e mbajnë në sipërfaqe dhe nuk i lejojnë që të dalin. Për shkak të këtij fenomeni që quhet “ndikimi serë”, Afërdita vazhdimisht përvëlohet brenda saj. Ngaqë atmosfera është e dendur e mban aq shumë nxehtësinë saqë ndryshimi i temperaturës midis natës dhe ditës nuk ka ndonjë ndryshim të madh. Trysnia e atmosferës në sipërfaqen e Afërditës është 90 herë më e madhe se në Tokë. Kjo vlerë trysnie është e barabartë me trysninë që ndjen dikush që zhytet 805 metra në thellësinë e detit në Tokë.

Afërdita, e cila njihet si motra e Tokës, duhet të jetë prej planetëve që e ka tërhequr më shumë interesimin e njeriut, sepse Afërdita është një planet në të cilin janë dërguar më shumë mjete kozmike. Edhe pse në vitet e ardhshme këtë cilësi do t’ia japë Marsit, tani për tani situata është e tillë.

Përfundimisht, Allahu i Madhëruar që e ka krijuar gjithësinë plot me fenomene të tilla misterioze, ndoshta e ka krijuar Afërditën e cila gjendet pranë nesh, ngaqë dëshiron të marrim mësim prej saj. Ndoshta Zoti (xh.sh.), dëshiron të na tregojë se kështu mund të jetë edhe fundi ynë nëse vazhdojmë me këtë ecuri duke na treguar rezultatet e “efektit serë” që e kemi dëgjuar shpesh kur bëhet fjalë për ngrohjen globale. Ndoshta Allahu Teala ua plas fytyrës këtë të vërtetë atyre që thonë: “A mund të lindë dielli nga perëndimi?”, duke dhënë mesazhin se edhe kjo mund të ndodhë. Si kanë thënë: “Daullja bie për atë që ka veshë!”



MBROJTJA GJENETIKE PREJ JEXHUXH DHE MEXHUXHVE

— Xhihan Tashtan —

Duke qenë se ne nuk kemi asnjë përgatitje kundrejt armëve kimike, nuk është për t’u çuditur se një përgatitje e tillë mungon edhe ndaj armëve të mundshme biologjike. (Emre Sonxhan, Ka plot tre vite që nuk përfundohet dot veshja ushtarake kimike.) Kjo nuk duhet kuptuar si një shpërthim i thjeshtë bombe, por duhet menduar edhe si një mekanizëm mbrojtës ndaj sëmundjeve epidemike. Sëmundja e antraksit që u bë provë në Baltimore, i frikësoi të gjithë. Tani SHBA ka përgatitur depo të tëra me vaksina që mund të shpëtojnë 3 qytete nga një sulm i mundshëm i antraksit. (Wil S. Hylton. How Ready Are We for Bioterrorism? The New York Times) Mbase një vaksinë e tillë mund të ndihmojë njerëzimin që të mos frikësohet më nga armët biologjike. Vaksinave të fëmijëve mund t’i shtohet edhe vaksina kundër bio-terrorizmit dhe çdo qytetar, gjatë gjithë jetës së vet, do të jetë i mbrojtur ndaj gripit, AIDS-it, mikrobeve vdekjeprurëse, bile edhe ndaj kancerit. (Fatma B. Dinçasllan. Mos të themi se kanceri nuk ka shërim!)

*“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj
jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj”*

(Maide, 3)

Një Ajet

Një grup dijetarësh janë të mendimit se ky është ajeti i fundit që i ka zbritur Pejgamberit (a.s.) në haxhin e lamtumirës. Në këtë ajet, Allahu u bën të ditur besimtarëve plotësimin e dhuntisë ndaj robërve të Tij, duke përsosur fenë dhe duke zgjedhur islamin si të vetmen fe të pranueshme.

Feja islame e ka zanafillën e vet që me krijimin e njeriut të parë. Përsosmërinë e ka arritur me profetin e fundit Muhamedi (a.s.). Kjo fe, e cilësuar e përsosur nga vetë Allahu, përfshin të gjitha parimet dhe normat që i duhen një shoqëri ideale, deri në Ditën e Kijametit.

Zoti i botëve e ka universalizuar dhe përkryer kumtesën e vet, të filluar qysh me Ademin (a.s.). Allahu i Madhëruar, i ka kumtuar me të njëjtën përmbajtje të gjitha çështjet që i përkasin bindjes fetare (tevhid). Ndërsa në çështjet sociale ka ndjekur metodën graduale në përshtatje me përparimin e njerëzimit, të cilit i është drejtuar.

Islami është parashtruar me një përmbajtje që t’u japë përgjigje zhvillimeve dhe përparimeve njerëzore që do të ndodhin gjer në Kijamet, meqë Allahu i Madhëruar ka deklaruar se nuk ka për të dërguar fe tjetër dhe pejgamber tjetër pas islamit. Kjo është arsyeja që islami, duke hapur portën e “ixhtihadit”, ka ofruar, nën dritën e parimeve themelore të tij, një mundësi për t’i vlerësuar sipas këtyre parimeve risitë e dinamikës së jetës. Islami ka shpjegime për tërë universin dhe jetën. Asgjë s’ka lënë jashtë fushës së interesimit.

Në ajet shprehet qartë se kjo fe nuk mund dhe nuk ka nevojë të reformohet, sepse kjo është feja e vetme e zgjedhur nga

Allahu si botëkuptim për besimtarët. Kjo është fe e natyrshme, fe e natyrës dhe e krijimit. **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, në natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** (Rum, 30)

Meqë islami është parashtruar duke u mbështetur në dijen e përgjithshme të Zotit, është një përmbledhje urdhrash dhe ndalimesh të parashtruara sipas prirjeve përkatëse të qëllimit final të krijimit të të gjitha krijesave. Allahu ka ndaluar çdo gjë që e ka parë të shëmтуar tek natyra e njeriut dhe ka urdhëruar gjërat që i ka parë të pranueshme dhe të dobishme për natyrën e tij.

Në islam, të gjitha urdhrat dhe ndalimet janë parashtruar sipas domosdoshmërisë së krijimit. Të gjitha urdhrat dhe ndalimet janë reflektime të dijeve hyjnore dhe absolute mbi prirjet e natyrshme, të cilat nuk mund të të konceptohen me anë të njohjes njerëzore. Ndërkaq, meqë natyra e krijimit mbetet gjithmonë e njëjtë, ngaqë është e pandryshueshme në esencë, kurrë nuk mund të ndodhë ndonjë mospërputhje apo humbje vlere me kalimin e kohës në parimet e kësaj feje.

Zgjedhja e islamit si botëkuptim për besimtarët, shpreh dashurinë e Allahut ndaj këtij umeti.

Ajo që i mbetet të bëjë çdo myslimani, është të falënderojë Allahun për këtë begati, të përpiqet ta kuptojë dhe zbatojë në jetë islamin brenda mundësive që ka dhe, për mangësitë që lë, t’i kërkojë falje Allahut.

Resulullahi (sal-lallahu alejhi ve sel-lem) ka thënë:

“Kush shpik në fenë tonë diçka që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”

(Buhari)

Këtë hadith e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi në koleksionet e tyre. Ai përbën një nga themelet e fesë islame. Ashtu siç shërben hadithi “Punët shpërblehen sipas qëllimit”, si peshore për vlerësimin e brendshëm të veprave, ky hadith shërben si peshore për të vlerësuar anën e dukshme të veprave. Pra, që një vepër të konsiderohet e vlefshme, duhet të plotësojë dy kushte: e para duhet t’i dedikohet vetëm Allahut dhe e dyta duhet të jetë e mbështetur në Kuran dhe Sunet.

Çdo risi, që nuk ka ekzistuar më parë në fe, quhet bidat. Muhamedi (a.s.), na tërheq vëmendjen nëpërmjet këtij hadithi që të mos pranojmë si pjesë të fesë risitë, që mund të na serviren si pjesë e saj.

Të gjitha llojet e adhurimeve, që nuk kanë bazë në fe, konsiderohen bidate dhe refuzohen në mënyrë kategorike. Ata që refuzojnë adhurimet dhe veprat që kanë baza në Kuran dhe Sunet konsiderohen bidatçinj dhe veprat e tyre nuk pranohen. Kjo nuk do të thotë në asnjë mënyrë që feja ndalon të renë dhe zhvillimin, përkundrazi feja islame nxit për çdo gjë të re që është e dobishme për individin ose shoqërinë. Është kjo arsyeja që ka lënë hapur institucionin e ixhtihadit, i cili ka autoritetin për të nxjerrë konkluzione në për-

puthje me Kuranin dhe Sunetin për çdo çështje që mund të shfaqet.

Bidati i ka shqetësuar dijetarët myslimanë gjatë gjithë historisë për rrezikun që mbart ai në nxjerrjen jashtë loje ose lënien pas dore të sunetit. E vetmja rrugë për të shmangur këtë rrezik është përhapja e kulturës së Kuranit dhe Sunetit dhe përvetësimi i tyre në mënyrë të tillë që të bëhen stil jetese. Çdo gjë që nuk bie në kundërshtim me Sunetin, Kuranin dhe konsensusin e të gjithë dijetarëve dhe që është e dobishme nuk konsiderohet bidat. Bidati ka lidhje më shumë me urdhëresat, ndalesat dhe me atë pjesë të fesë ku kufijte e veprimit janë përcaktuar qartë nga Kurani dhe Suneti. Çdo risi që ndodh jashtë kësaj fushe nuk konsiderohet bidat.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Ky hadith përbën një nga themelet e fesë islame. Çdo gjë që bie në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin, besim apo ibadet qoftë, është i refuzuar.
2. Risitë e shfaqura më vonë dhe që nuk bien në kundërshtim me Kuranin dhe Sunetin, nuk janë bidate.
3. Si ai që e shpik, si ai që e ndjek bidatin, të dy janë mëkatarë.

Mjë Hadith



SHPIRTI NUK MUND TË KETË FESTË PA VUAJTUR NEFSI



MBRETI MISTERIOZ

“Një mbret po kalonte nga një rrugë me kalin e tij. Papritur pa një burrë që po flinte nën një pemë. Në ato momente, një gjarpër i zi filloi t’i hynte nga goja burrit që po flinte. Edhe pse mbreti shkoi me kalë drejt gjarprit dhe u përpoq për ta trembur, prapë se prapë nuk ia doli dot mbanë. Gjarpri i hyri burrit në trup.

Mbreti ishte një njeri largpamës, i zgjuar dhe plot urtësi. Ai mendoi shpejt dhe vendosi ta përdorte të gjithë aftësinë dhe zgjuarsinë e tij për ta shpëtuar burrin që po flinte nga një fund i dhimbshëm dhe i trishtueshëm. Për këtë arsye, filloi ta godiste burrin me kamxhik... Burri u zgjua duke u hedhur prej dhimbjes dhe filloi të ikte i frikësuar dhe i shqetësuar për të shpëtuar nga goditjet e kamxhikut që fishkëllenin njëra pas tjetrës.

Mbreti vazhdonte ta ndiqte nga pas burrin e

shkretë. Ndërkohë që burri po ikte, arriti te një pemë molle. Mbreti e zuri burrin aty. Ai filloi t’ia fuste në gojë burrit mollët e kalbura dhe të prishura që kishin rënë në tokë. Ndërsa nga ana tjetër i bërtiste:

“O ti njeri i shkretë dhe i mjerë! Këto do t’i hash të gjitha! Këtë vuajtje do ta durosh!” Ndërsa burri i shkretë, nga njëra anë i gëlltiste me vështirësi mollët e prishura dhe të kalbura dhe nga ana tjetër e mallkonte mbretin pa pushim:

“O mbret! Çfarë të kam bërë?.. Çfarë do të bësh me mua? Cili është shkaku i kësaj padrejtësie që po më bën?.. Nëse do të më vrasësh, të paktën më gjuaj me shpatë dhe ma derdh gjakun! Përse po më bën të vuaj kaq shumë? Sa kohë e keqe paska qenë çasti kur të pashë!.. Sa njerëz fatlumë qenkan ata që nuk e kanë parë fytyrën tënde!.. As zullumqarët më të mëdhenj nuk ia



bëjnë këtë padrejtësi një njeriu që s'ka bërë asnjë faj! Siç e sheh, nga goja po më del gjak edhe kur po i them këto fjalë!.. Beto hem se nuk kam parë ndonjëherë njeri kaq të pamëshirshëm dhe të pandërgjegjshëm sa ti!.. O Zot! Ndëshkoje Ti këtë zullumqar!”

Mbreti nuk ua vuri veshin aspak këtyre fjalëve. Ai e detyroi atë t'i hante të gjitha mollët dhe pastaj përsëri filloi ta godiste me kamxhik duke i thënë: “Menjëherë vrapo në këtë luginë!”

Burri i shkretë filloi të vraponte si era prej frikës nga kamxhiku. Nganjëherë rrëzohej për tokë, por prapë ngrihej në këmbë dhe vraponte për shkak të kamxhikëve që hante. Stomaku i burrit të shkretë ishte i mbushur plot me mollë të prishura. Ndërsa fytyra i kishte marrë shumë plagë nga kamxhiku. Krahas kësaj, mbreti nuk shfaqte asnjë shenjë mëshire. Ai e bëri atë të vraponte derisa nuk i ngeli fuqi për ta hedhur hapin. Burrit të shkretë tashmë i shteroi fuqia. Stomaku i tij i mbushur me mollë të kalbura, u trazua pas gjithë atij vrapit shumë të mundimshëm. Për këtë arsye, burri i shkretë nuk duroi dot më shumë dhe filloi të villote.

Çdo gjë që kishte ngrënë, po i dilte nga goja edhe pse me vështirësi. Më së fundi, bashkë me mollët e kalbura doli jashtë edhe gjarpri i zi. Burri i shkretë u habit pa masë. Ai u tmerrua kundrejt gjarprit të frikshëm që doli nga stomaku i tij. Menjëherë e kuptoi çdo gjë. Menjëherë vrapoi dhe u përkul te këmbët e atij mbretit të devotshëm. Atij i tha:

Por!..

“Por ti paske ardhur si mëshira e Xhebrailit! Ti paske qenë një mirësi për mua! Sa kohë e bekuar paska qenë momenti kur të pashë! Po të mos ishte ti, do të kisha vdekur në një mënyrë

të tmerrshme. Ti më fale jetë. Lum për atë që e shikon fytyrën tënde apo rastësisht vjen në lagjen tënde! O ti rob i dëlirë dhe i veçantë që meriton të lavdëroresh! Sa keq më bëri të flas injoranca dhe shkujdesja ime e mëparshme! Më fal që t'i thashë ato! A do të t'i thosha ato fjalë të papërshtatshme po të kisha vetëm pak dijeni për këtë gjë! Pra, ti e fshehe të vërtetën se ishe një mjek i fuqishëm që i jep ilaç të hidhur të sëmurit, në mënyrë që ai të shërohet. Po të më kishe treguar qoftë edhe pak për këtë, nuk do të të ofendoja,

por do të të falënderoja. Ndërsa ti heshtje dhe më godisje në kokë pa reshur. Si rezultat, koka mu hutua dhe mendja më iku. Prandaj çfarë nuk të thashë prej paditurisë. Më fal dhe mos m'i merr për keq ato që t'i thashë!”

Mbreti i bekuar dhe largpamës i tha: “Nëse do të të tregoja qoftë edhe pak për atë që kishe brenda, do të të plaste tëmthi. Frika do të të shkatërronte. Do të shkatërron heshe si miu para maces dhe do të veproje si një qengj para ujkut... Po të të tregoja për tmerrin e atij gjarprit të zi, në ato

momente do të hutoheshe prej frikës. Po të kishe dijeni për përbindëshin që kishe brenda, nuk do të kishe fuqi as për t'i ngrënë ato mollët, as për të vrapuar, as për ta nxjerrë atë gjarpër të zi duke vjellë... Unë bëra durim ndaj fjalëve të tua të papërshtatshme. Në vete lutesha: “O Zot! Lehtësoja për ta nxjerrë gjarpurin! Shpëtoje këtë të shkretë!” Edhe pse ti më the fjalë të hidhura, mëshira që kam në zemër nuk më lejoi të të lija në atë gjendje, sepse krijimi im është i mbryjtur me mëshirë.”

Burri i shkretë që e kuptoi të vërtetën e këtij miku të Zotit (xh.sh.), nuk dinte çfarë të thoshte.

*“O Zot! Kërkoj mëshirën
Tënde! Mos më lër ballë
për ballë me dëshirat
vetjake as sa hap e mbyll
sytë! Ma rregullo çdo
gjendje timen! Me të
vërtetë, nuk ka zot tjetër
përveç Teje!..”*

*(Ebu Davud,
Edeb, 100-101.)*



Për këtë arsye, duke e ndjerë veten të turpëruar, tha: “O njeri i lartë! Ky i shkretë nuk ka mundësi të të falënderojë ty siç e meriton! Prandaj, Allahu të shpërbleftë për këtë mirësi!”

Në këtë histori të mbushur plot me urtësi, siç janë edhe të gjitha historitë e tjera të Mesnevisë, gjendet simbolika e profetëve dhe evliave, të cilët janë edukues të njerëzve.

Gjarpri që kemi brenda: Nefsu'l-Emmare

Njeriu që flinte, i cili u përmend në historinë e Hazreti Mevlanës, është njeriu i shkujdesur nga e vërteta. Gjarpri që i hyri brenda është nefsu'l-emma. Mbreti është udhërrëfytyrës i përsosur. Rrahja me kamxhik, ndërsa ai ishte në gjumë, për ta zgjuar dhe detyrimi për ta bërë të vraponte në fushë e luginë, janë përpjekja dhe rijazati (ushqyerja me pak për ta edukuar veten, apo preokupimi me mendime e vepra të dobishme duke e ndaluar nefsin nga gjërat e këqija). Ndërsa dalja e gjarprit është shpëtimi nga nefsu'l-emma.

Nefsu'l-emma është si një gjarpër i zi që dëshiron t'ia shkatërrojë njeriut jetën e përhershme. Ndërkohë njeriu e pandeh të pafajshme dhe të padëmshme nefsin që gjendet brenda tij dhe që i injekton atij dëshirat dhe ndjenjat e epshtit. Ndërsa pejgamberët dhe miqtë e Zotit, na paralajmërojnë për sa i përket çështjes së të këqijave të nefsit. Hazreti Jusufi thotë:

“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse nefsi (i njeriut) është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë.” (Jusuf, 53)

Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i cili ka pasur nefsin më të dëlirë, i është lutur Zotit (xh.sh.), në këtë mënyrë: “O Zot! Kërkoj mëshirën Tënde! Mos më lër ballë për ballë me dëshirat vetjake as sa hap e mbyll sytë! Ma rregullo çdo gjendje timen! Me të vërtetë, nuk ka zot tjetër përveç Teje!..” (Ebu Davud, Edeb, 100-101.)

Kjo mënyrë e të shprehurit e të Dërguarit të Allahut (a.s.), edhe pse kishte një nefsi të dëlirë që ia kishte edukuar Allahu Teala, sigurisht që është për të na udhëzuar ne. Edhe Bajezidi Bistami, rahmetull-llahi alejh, thotë: “Çdo sëmundje e kam mjekuar dhe shëruar, por nuk kam parë gjë më të vështirë se mjekimi i nefsit. Ndërkohë për mua nuk kishte gjë më të pavlefshme dhe të lehtë se nefsi.”

Miqtë e Zotit na e kanë shpjeguar me gjuhën e tyre domosdoshmërinë për edukimin e nefsit. Nëse ata do t'i shprehnin të këqijat e nefsit me të gjithë ligësinë e tyre, njeriu nuk do të kishte mundësi ta edukonte nefsin për shkak të frikës dhe dëshpërimit. Fakti që mbreti nuk i tha burrit të shkretë në histori: “Të ka hyrë një gjarpër nga goja.” – tregon pikërisht këtë që thamë më lart. Edhe këto shprehje të mëposhtme që transmetohen sikur të jenë hadithe fisnike, nxjerrin në pah këtë të vërtetë:

“Nëse do t'ua shpjegoja armikun që keni brenda, trimave do t'u plaste tëmthi. Për këtë arsye, as nuk do të merrnin dot ndonjë rrugë, as nuk do t'ia dilnin mbanë për të bërë ndonjë punë. Si rezultat, do të përpëliteshin nga dëshpërimi. Në trup nuk do t'u ngelte fuqi për adhurim, në zemër nuk do t'u ngelte forcë dhe nuk do të përparonit në besim. Atëherë, unë ju edukoj me heshtje dhe pa ua nxjerrë jashtë atë që keni brenda.”

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i lartësoi njerëzit, të cilët gjendeshin në errësirën e injorancës, në gradën e sahabëve të tij duke i edukuar dhe pastruar. Ai (a.s.), solli në pah një civilizim të virtyteve nga ajo shoqëria e krimeve, tmerreve, zullumeve dhe fanatizmave. Ndërkohë këtë e bëri duke përdorur metodën e mësimi shpirtëror hap pas hapi. Ai ua mundësoi atyre që të bëheshin pasqyra ndaj diellit të udhëzimit që ndriçoi të gjithë botën.

Edhe miqtë e Zotit, të cilët janë trashëgimtarët e tij, heshtin dhe nuk e thonë çdo të vërtetë që e dinë. Këtë e bëjnë për të mirën e bashkëbiseduesit. Përveç të tjerash, nuk e nxjerrin në pah atë që bashkëbiseduesit e tyre kanë në zemër dhe i mbulojnë gabimet e të tjerëve. Ata i edukojnë njerëzit më shumë me vepra se me fjalë. Miqtë e nderuar të Zotit, ndikojnë te zemrat e ashpësuara dhe të forcuara si hekuri, nëse ato kanë aftësi t'i afrohen përshtpirtshmërisë, siç e zbuti Davudi, alejhi's-salam, hekurin.

Miqtë e Zotit i bindin nxënësit e tyre për t'i edukuar dhe për t'ua vënë kraharorin vështirësive në këtë rrugë, sepse nxjerrja e gjarprit të nefsit që gjendet brenda njeriut, nuk është aspak e lehtë. Ai mund të nxirret vetëm me një mijë e një rijazate dhe përpjekje.

Hazreti Bajezidi Bistami përsëri thotë: “Nefsin e bëra të vazhdonte në udhëtim drejt takimit me Zotin. Për sa i përket çështjes së këtij udhëtimi,

nefsi reagoi dhe më bëri të përjetoja vështirësi të ndryshme. Për këtë arsye, edhe unë iu drejtova audiencës së Allahut të Lartësuar duke i mënjnuar të gjitha dëshirat e neftsit në lidhje me këtë botë!”

Imam Gazaliu, rahmetull-llahi alejh, e tregon kështu gjendjen e tij në kulmin e dijes:

“Isha i preokupuar me dijet shkencore dhe të sheriatit. Kisha shumë nxënës. Mendova për gjendjen time. Vura re se isha i rrethuar nga pasione të ndryshme. Mendova për nijetin që kisha për dijen. Atë nuk e gjeta të pastër për hir të Allahut Teala, por të përzier me dashurinë ndaj pozitës dhe famës. Absolutisht e kuptova se isha në një dallgë shkatërruese apo buzë greminës. Me vete thashë:

‘Eja, nxito! Tashmë të ka ngelur një pjesë shumë e shkurtër nga jeta. Nëse dija që ke marrë nuk kalon në praktikë dhe jetën reale, nuk është gjë tjetër përveçse një mashtrim. Cili do të jetë fundi yt nëse tani nuk i ndërpret lidhjet e panevojshme dhe nuk i largon pengesat? Atëherë më ndodhi diçka. Gjashtë muaj ngela i habitur duke rënkuar dhe duke qarë në luginën e çudisë ndërmjet arratisjes nga kjo bote, nga njerëzit e lidhur me të e nga dëshirat kundrejt saj dhe dëshirës për Ahiretin. Zemra filloi të më vuante shumë. E pashë dobësinë time dhe e kuptova. Vura re se vullneti dhe mundësia për të zgjedhur kishin dalë plotësisht nga duart e mia. Pastaj e luta Allahun Teala duke iu përgjyruar si një njeri i kapluar nga një hall i pazgjidshëm dhe sëmundje e pashërueshme.

Më së fundi, siç thuhet edhe në ajetin fisnik: **“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën juve trashëgimtarë në tokë?!...”** (Neml, 62), Allahu Teala ma pranoi lutjen dhe ma zgjoi zemrën. Dëshira për pasuri dhe pozitë mu hoq. Çdo gjëje ia ktheva kurrizin dhe u preokupova me përmendjen e Allahut, me pastrimin e zemrës dhe përsosmërinë e moralit. Pastaj e kuptova në mënyrë absolute se ata që

dëshirojnë të takohen me Allahun dhe që janë rrugëtarë të udhëzimit, janë të mëdhenjtë mistikë. Sjellja dhe morali më i bukur gjendet te ata, sepse gjendjet e atyre të dukshme dhe të padukshme burojnë nga drita e profecisë.” (Shik. Gazali, el-Munkidhu mine’d-Dalal, Stamboll 1994, fq. 35-39.)

Në këtë përpjekje ka receta të hidhura. Siç ishte sjellja e mbretit në histori, aty duhet të merren masa të domosdoshme dhe serioze. Mbi të gjitha, për çdo dhimbje të duhet një ilaç i veçantë. Hazreti Bajezidi Bistami e tregon me këto përngjasime përpjekjen e tij fazë pas faze:

“Dymbëdhjetë vjet isha hekurpunuesi i neftsit tim. Atë e vendosa në shakullin e rijazatit dhe e nxeha me zjarrin e përpjekjes. Pastaj e vendosa në kudhrën e kritikës dhe e rraha me çekiçin e qortimit e modestisë. Pastaj, pesë vjet u bëra pasqyra e zemrës sime. Domethënë, atë e mora nën kontroll. Këtë pasqyrë e bëra të shkëlqente me ibadete dhe adhurime të ndryshme ndaj Allahut Teala. Pastaj, përgjatë një viti e pashë me vëmendje duke marrë mësim. Vura re se në shpirtin tim gjendej një fatkeqësi e madhe që buronte nga mburrja, nga besimi ndaj adhurimeve dhe nga pëlqimi i veprave të mia. Për ta hequr edhe këtë të keqe, u përpoqa edhe pesë vite të tjera. Më së fundi, besimi im arriti përsosmërinë dhe unë përsëri e arrita kënaqësinë shpirtërore të Islamit.

Edhe Hazreti Halid Bagdadi në një letër të tij e ka shprehur kështu rëndësinë e kujdesit ndaj mashtrimeve të neftsit në ibadete dhe adhurime: “Përdore të gjithë fuqinë tënde në adhurimet shpirtërore dhe fizike! Krahas kësaj, detyroje neftsint ta pranojë mendimin se asnjëherë nuk ke bërë ndonjë vepër të pranueshme, sepse shpirti i adhurimeve është nijeti. Ndërsa nijeti është i pranueshëm vetëm kur të jetë i sigurtë. Si mos të të duhet ty sinqeriteti kur u duhet edhe atyre që janë më të mëdhenj se ti?! Beto hem në Allahun Teala se që nga dita kur më ka lindur nëna e deri më sot, nuk besoj se kam bërë ndonjë vepër të

*“Nëse
Ramazani
i Bekuar kalohet
zgjuar duke bërë dhikër,
kjo gjendje do të vazhdojë
edhe në pjesën tjetër të vitit.
Nëse në këtë muaj vërehet
ndonjë mangësi ose dobësi,
gjurma e saj do të shihet
edhe gjatë gjithë
vitit.”*



pranuar të Allahu, të nderuar te Ai dhe që nuk do të merrem në llogari për të. Nëse nuk e sheh nefsin si të falimentuar në të gjitha punët e mira, atëherë kjo është pika më e fundit e injorancës. Nëse e pranon atë si të falimentuar, atëherë mos e shkapëput shpresën nga mëshira e Allahut!”

Nefsi është një bela e atillë që kërkon përpjekje të mëdha dhe të vazhdueshme, në mënyrë që të mbrohemi nga e keqja e tij. Prandaj nefsi nuk është një gajle e zakonshme dhe e parëndësishme që mund të mënjanohet krejt lehtë.

Përsëri nuk duhet të harrojmë se;

Nderi i fitores...

Nderi i një fitoreje është në proporcion me emocionet e bukura që përjetohen dhe vështirësitë që përballohen për ta arritur atë. Në çdo lloj vështirësie me të cilën njeriu përballlet për të shpëtuar nga skllavëria e nefsit e shejtanit dhe për të fituar lirinë e shpirtit, ka një kënaqësi fisnike. Ata që arrijnë ta kuptojnë këtë, i pinë me kënaqësi ilaçet e hidhura të njohësve të gnozës islame. Edhe një e vërtetë që e bën më të lehtë kuptimin e kësaj është krahasimi i të dy botëve. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i ka thënë vajzës së tij të nderuar, Hazreti Fatimes (r.a.):

“Bijë, në të dyja botët (njëherësh) nuk ka lumturi. Prandaj duhet të durosh në këtë botë, në mënyrë që ta arrish lumturinë dhe prehjen në botën tjetër!” Në këtë mënyrë, na e ka kujtuar se festa në botën tjetër bëhet duke duruar kundrejt vështirësive dhe problemeve në këtë botë. Nga ana tjetër, njeriu duhet të marrë mësim dhe edukime të ndryshme që e pjekin dhe e përsosin, në mënyrë që të pranohet në vendin e shpërblimit, pra, në Xhenet.

Vështirësitë e pjekin njeriun duke e rrahur. Shikojini gurët në breg!.. Si rezultat i dallgëve që i rrahin përgjatë shekujve, nuk u ka ngelur asnjë anë e mprehtë dhe janë bërë të pathyeshëm si shembulli i granitit.

Njeriu përjeton vështirësi kur përpiket për ta edukuar nefsin, por më së fundi e arrin lehtësinë. Ai përjeton vështirësi, por në sajë të këtyre të fundit shfaqet mëshira. Në ajetet fisnike thuhet: **“Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi! Me të vërtetë, pas vështirësisë vjen lehtësimi!”** (Inshirah, 5-6)

Ja, kjo është festa e vërtetë. Festa e vërtetë është njohja e Allahut dhe arritja e dashurisë së Tij.

Festa e vërtetë është kalimi nga fazat e tmerrshme të tubimit në Ditën e Gjykimit, hyrja në Xhenet dhe arritja për të parë bukurinë e Allahut Teala. Siç shprehet edhe Hazreti Haxhi Bajram Veliu, është takimi me të Dashurin.

Festë nuk do të thotë që nefsi të arrijë rehatinë, të hajë, të pijë dhe të argëtohet në këtë botë. Dyrnjaja është vendi i kryerjes së detyrave. Ndërsa Ahireti është vendi i shpërblimit apo i ndëshkimit sipas kryerjes së detyrave në këtë botë.

Të argëtohesh deri në masën sa ta humbësh veten, të jetosh duke u dëfryer dhe ta kalosh të gjithë jetën nëpër dallgët e zbatimjes apo argëtim, do të thotë të gëlltisësh një gjarpër të zi si shembulli i burrit që flinte nën pemë. Fundi i një jete të tillë është humbje. Për këtë arsye, festat kërkojnë një kujdes dhe interesim të veçantë, sepse, për shembull, festa e Bajramit të Fitrit është si një pushim në fund të një adhurimi, ibadeti dhe mësimi një mujor, por edhe ky pushim duhet të përjetohet sipas orientimit të Islamit për ta fituar kënaqësinë dhe pëlqimin e Allahut Teala, i Cili na e ka dhuruar edhe Ramazanin, edhe festën e Bajramit të Fitrit.

Ndërsa një besimtar që është në luftë me nefsin e tij duhet ta kalojë në jetë festën, pra ditën e gëzimit, si një ditë për gëzimin e të tjerëve. Pra, besimtari duhet ta vlerësojë këtë ditë si një iniciativë për t'i gëzuar dhe për t'i bërë t'u qeshin fytyrat jetimëve, të vetmuarve dhe të gjithë vëllezërve të tij besimtar që gjenden afër apo në skajin tjetër të botës. Nëse festën do ta pranojmë si ditë të ngrënies dhe pirjes, një rob që nuk i lë të lirë frerët e nefsit duhet të shfaqë kujdes të veçantë për hallallin e çdo kafshate, për t'i ndarë gjërat me të tjerët, për të dhënë për hir të Allahut dhe për ta bërë si rregull të ngrënë me emocionin për ta shfrytëzuar energjinë që përftohet në adhurimin ndaj Zotit (xh.sh.).

Festat duhet t'i vlerësojmë si mundësi për t'i vizituar prindërit, të afërmit, fqinjët dhe njerëzit tanë që kanë ndërruar jetë në vend se t'i perceptojmë si pushime.

Përfundimisht, nefsin nuk duhet ta lëmë të lirë qoftë edhe për një çast. Lutja e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, është transmetuar kështu në një hadith fisnik: *“O Zot! Jepi nefsit tim devotshmëri dhe pastroje atë! Ti je Ai që mund ta pastrosh atë më së miri. Ti je poseduesi dhe Zoti i saj.”* (Muslim, Dhikr, 73.)

Edhe një kuptim tjetër i kësaj lutjeje është ky:

Pastrimi vjen vetëm nga Zoti (xh.sh.)...

Sado që njeriu të preokupohet me rijazete dhe përpjekje për ta pastruar nefsin e tij, Ai që në të vërtetë mund t'ia pastrojë atë është vetëm Allahu Teala. Në ajetet fisnike thuhet:

“...Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush nga ju nuk do të ishte pastruar kurrë (prej gjynaheve); Allahu pastron atë që dëshiron Vetë. Allahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.” (Nur, 21)

“A nuk i ke parë ata që e kujtojnë veten të dëlirë? Jo, Allahu dëlir kë të dojë dhe askush nuk do të pësojë as padrejtësinë më të vogël.” (Nisa, 49)

Suksesi që arrihet hap pas hapi kundër nefsit pa u strehuar te Allahu Teala dhe pa iu përgjyruar Atij, shndërrohet në një mashtrim tjetër të nefsit, sepse njeriu, për shkak të kësaj, fillon të pandehë se është dikush. Kështu, edhe disa të varfër indianë, disa murgj të mbyllur nëpër manastire dhe njerëz të tjerë të ngjashëm me këta, por që nga aspekti i besimit janë larg nga Zoti (xh.sh.), mund të fitojnë disa aftësi në luftën me nefsin. Ama qëllimi nga lufta me nefsin nuk është shtimi i aftësisë dhe mendjemadhësisë së tij, por për ta bërë atë të përkushtuar ndaj adhurimit të Zotit (xh.sh.). Për këtë arsye, lufta me nefsin nuk merr fund asnjëherë. Miqtë e Zotit që e kanë kuptuar këtë, asnjëherë nuk i kanë lëshuar nga duart e tyre frerët e nefsit.

Në mënyrë që të mos më turpërohet nefsi!

Njëri prej të mëdhenjve kishte rastisur në një të moshuar që kishte ngarkuar dru në kurrizin e tij dhe po ecte me vështirësi. Ai i tha duke e parë gjendjen e tij: “O i moshuar! A nuk ke besim te Allahu, i Cili është Furnizues, që edhe në këtë moshë e heq këtë vuajtje? Apo nuk ke asnjë njeri që të përkujdeset për ty?”

Druvari i moshuar i ngriti sytë nga qielli, i hapi duart dhe u lut vetëm me njetin për t'ia hequr mangësinë e perceptimit shpirtëror bashkëbiseduesit të tij: “O Zot! Shndërroi këta në florinj!” Në momentin kur e bëri këtë lutje, drutë menjëherë u shndërruan në florinj. Burrin, i cili dëshmoi këtë mrekulli të madhe, këtë herë e kaploi një shastisje tjetër. Ai e pyeti veten: “Përse mbart dru një njeri që ka arritur një gradë të tillë?” Druvari i moshuar i tha: “Bir! Këtë e bëj, në mënyrë që



Përfundimisht, nefsin nuk duhet ta lëmë të lirë qoftë edhe për një çast. Lutja e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, është transmetuar kështu në një hadith fisnik: “O Zot! Jepi nefsit tim devotshmëri dhe pastroje atë! Ti je Ai që mund ta pastrosësh atë më së miri. Ti je poseduesi dhe Zoti i saj.”

(Muslim, Dhikr, 73.)

nefsi të më njohë si rob dhe të mos dalë jashtë kornizës së adhurimit, sepse pranimi te Zoti (xh.sh.), është në proporcion me orientimin e drejtë në adhurim...”

Lutja e mëposhtme që krijesa më e mirë, Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë (a.s.), ia ka mësuar njërit prej njerëzve më të mirë pas peygamberëve, Hazreti Ebu Bekrit (r.a.), është dëshmia më konkrete për këtë. Ata e kanë vazhduar pa ndërprerje luftën me nefsin pa marrë parasysh gradat apo pozitat dhe përgjyrimin ndaj Allahut Teala për fitimin e kësaj lufte nuk e kanë neglizhuar qoftë edhe për një çast. Një ditë, Hazreti Ebu Bekri (r.a.), i bëri këtë kërkesë të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguari i Allahut! M’i mësoni disa fjalë të bekuara, në mënyrë që t’i them në mëngjes dhe mbrëmje!”

I Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i mësoi këtë lutje për ta thënë në mëngjes, në mbrëmje dhe kur të shtrihej për të fjetur. Edhe ne le të shpresojmë një përfundim të mirë për këtë shkrim me lutjen profetike:

“O Zot që ke krijuar qiejt dhe tokën, botët e dukshme dhe ato të padukshme! O Zoti dhe Poseduesi i çdo gjëje! Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Teje. Ty të kërkoj mbrojtje nga e keqja e nefsit, nga e keqja e shejtanit dhe nga ftesa e tij për të të bërë shirk Ty.” (Ebu Davud, Edeb, 100-101/5067; Tirmidhi, Deavat, 14/3392.)

Amin!..



KABID-BASIT

EDHE PAKËSIMI, EDHE BOLLËKU ËSHTË PREJ TIJ

— Ilir Hoxha —

Emrat Kabid dhe Basit, të cilët zënë vend ndër emrat e bukur të Zotit tonë, kanë kuptimin, ngushtues dhe zgjerues. Këta janë dy emra të kundërt të njëri-tjetrit, por që e plotësojnë njëri-tjetrin.

Gjerësia e kuptimit të këtyre emrave është aq e madhe, sa përfshijnë brenda vetes të gjitha ndodhitë e jetës. Ne mund ta shohim manifestimin e këtyre emrave në çdo fushë të jetës, që prej dhënies dhe marrjes së shpirtave, e deri tek shpërndarja e rrizkut. Nëse Allahu e mban, apo e ngushton diçka, s'ka asnjë forcë ta hapë apo ta lirojë. E kur Ai e shpërndan, nuk ka më nevojë për asgjë.

Është shumë interesante se, megjithëse në listën e Esmat-i Husna (Emrave të Bukur të Allahut) Kabid dhe Basit gjenden në formën e emrit, në Kuranin Fisnik, ato përdoren vetëm si folje. Kjo na tregon se situata e bollëkut dhe e ngushticës, nuk janë rregull i vazhdueshëm dhe absolut, por se në pjesë të ndryshme të jetës, njëra ose tjetra do të përjetohet patjetër. Dhe kjo nënkupton ekuilibrin dhe harmoninë e Allahut të Madhëruar midis emrave Kabid dhe Basit. Për arsye të këtij ekuilibri dhe harmonie që kanë emrat me kuptime të kundërta, dijetarët Islamë shprehen se këta emra duhen menduar gjithmonë së bashku.

Në këtë botë, as gjendja e ngushtësisë (kabid) dhe as gjendja e bollëkut (basit) nuk janë të përhershme dhe të vazhdueshme. Që të dyja këto gjendje janë kalimtare. Mirëpo, rreziku i vërtetë nuk është për njerëzit që përjetojnë ditë kalimtare të gjendjes së ngushtimit, por hapja dhe bollëku i

mirësive të kësaj bote para njerëzve që meritojnë ndëshkimin hyjnor. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar ka thënë se këtyre njerëzve u jepen mirësitë e kësaj bote vetëm që t'u shtohet ndëshkimi. (shih. Al-i Imran, 178.)

Gjendja e ngushtimit (kabid) mund të ndodhë edhe me shfaqjen e të këqijave, por edhe me zhdukjen e të mirave. Mirëpo, një besimtar i mirë, beson se në të dyja këto ka një urtësi, sepse Allahu është mbizotëruesi i çdo gjëje dhe çdo situatë. Edhe në mosdhënien, edhe në dhënien e Tij, ka një urtësi dhe, asgjë që vjen prej Allahut nuk është e keqe. Neve mund të na duket si e keqe, por ai që është falënderues edhe në gjendjen e ngushtësisë, arrin gradën e kënaqësisë me atë që i jep Allahut, gjë e cila e bën atë të kalojë sprovën dhe të nxjerrë një mirësi prej asaj që duket e keqe. Ky është sukcesi i vërtetë, sepse ajo që do na bëjë të marrim vlera tek Zoti ynë, është reagimi që shfaqim ndaj atyre që na ndodhin.

Në misticizëm, fjala Kabid, është një term që shpreh gjendjen e bllokuar të njeriut në aspektin shpirtëror. Ndonjëherë, njeriu përjeton bllokim, tension dhe nuk i vjen asgjë në mendje. E ndonjëherë është i hareshëm, i sigurt në vetvete, ka mendje dhe zemër të hapur dhe asgjë nuk mund ta mërzisë. Që të dyja këto gjendje janë prej Allahut. Por për çdo njeri gjendjet e ngushtimit dhe zgjerimit janë të ndryshme dhe, në të shumtën e rasteve nuk u dihet shkaku. Po sipas mistikëve, as rënia në vështirësi (kabid) dhe as dalja prej saj nuk janë në dorë të njeriut. Për këtë arsye, mistikët mendojnë se, në vend që të luftojë për



të dalë nga gjendja e ngushtë (kabd) që ka rënë, njeriu duhet ta pranojë atë si një sprovë dhe të bëjë durim derisa ajo gjendje të kalojë. Veprimet e sforcuara për ta kaluar këtë gjendje, janë edhe në kundërshtim me rrugën e tasavufit (misticizmit), por e shtojnë edhe më tepër gjendjen e ngushtimit. Mbi të gjitha, kjo gjendje duhet konsideruar si një mundësi e vyer për t'u kthyer në vetvete, për t'i dhënë kuptim atyre që përrjetojmë, për t'u drejtuar nga kërkimi i faljes dhe për t'u afruar edhe më shumë me Krijuesin e Madhëruar. Gjithashtu, edhe në gjendjen e një bollëku (bast) që vjen papritur, ne duhet të ruajmë qetësinë dhe edukatën, duke u përpjekur të mos lazdrohemi e të mos harbohemi.

Sipas autorit të veprës *“Komentimi i Esmā-i Husnā”*, Ali Osman Tatlisu, ajo që i ka hije njeriut në kohë vështirësie/ngushtësie (kabd), është që, edhe nëse ndikohet prej humbjes së mirësive, ai nuk duhet të hutohet shumë dhe nuk duhet të bjerë aq poshtë sa të humbasë virtytin e quajtur “durim”. Ndërsa në kohë bollëku (bast), njeriu nuk duhet të lazdohet, të kaplohet prej krenarisë dhe entuziazmit të tepërt dhe nuk duhet të gëzohet aq shumë sa të harrojë falënderimin e Allahut. Po ashtu, ai nuk duhet ta harrojë kurrë se të gjitha këto gjendje vijnë prej Allahut dhe se të gjitha kanë urtësi të fshehura. Ai duhet ta lidhë zemrën e tij vetëm pas kënaqësisë së Allahut dhe duhet t'i vazhdojë në mënyrë të përpiktë të gjitha detyrat si rob i Tij.

Arritja e suksesit në këtë çështje e ruan robin edhe nga shumë sëmundje, sepse sipas shkencës së psikologjisë, aftësitë dhe kapacitetet që nuk përdoren për arsye të ndryshme, ose prodhojnë sëmundje, ose zhduken duke humbur funksionin e tyre, gjë e cila e kufizon shumë njeriun. Për këtë arsye, për sa kohë të jemi në këtë jetë,

duhet të dimë se gjendja e ngushtësisë (kabd) është kalimtare dhe nuk duhet ta humbasim kurrë shpresën. Kjo ka një rëndësi të madhe edhe në aspektin e besimit, edhe në aspektin e shëndetit tonë shpirtëror.

Disa njerëz janë vendi ku manifestohet emri Basit i Allahut të Madhëruar. Në sajë të tyre, Allahu u jep rehati dhe bollëk njerëzve të tjerë. Në këtë grup njerëzish futen edhe shokët tanë, të cilët me një shaka na kthejnë buzëqeshjen në një moment kur jemi të hidhëruar dhe me një fjalë na qetësojnë shpirtin. Shembull i kësaj ka qenë edhe një prej sahabëve të Profetit tonë të nderuar (a.s.), Nuajman bin Amr (r.a.)...

Në këto dy pika, duhet pasur kujdes edhe në ligjërimet tona. Të flasësh vazhdimisht duke tërhequr vëmendjen vetëm në çështjet negative, ose të flasësh me naivitet vetëm për gjëra pozitive, e dobësojnë zgjuarsinë dhe kujdesin. Për këtë arsye, i Dërguari Allahut (a.s.), në këshillat e tij nuk ka këmbëngulur asnjëherë vetëm në njërin prej këtyre, por sipas vendit i ka përdorur të dyja. Po ashtu edhe në lutjet e tij, ai është shprehur se, që të dyja këto gjendje janë prej Allahut dhe në çdo situatë ka kërkuar prej Tij bollëk dhe mirësi. Për rrjedhojë, edhe ne po i japim fund kësaj teme me një nga lutjet që Profeti ynë (a.s.), e ka bërë më shpesh:

“O Allah! Askush nuk mund ta pakësojë atë që Ti e ke falur me bollëk, ta shtojë atë që Ti ke pakësuar, ta udhëzojë atë që ke devijuar, ta devijojë atë që ke udhëzuar, të japë atë që Ti nuk e jep, të pengojë atë që Ti e jep, të afrojë atë që ka mbetur larg mëshirës Tënde dhe të privojë nga kjo mirësi atë që Ti e ke afruar pranë mëshirës Tënde. O Allah! Na dhuro me bollëk prej mirësive, begative dhe thesareve të Tua të mëdha!”



- 4 -

Refleksione

— Nuredin Nazarko —

141. Nëse njeriu nuk kënaqet me atë që ka, do të kërkojë atë që i mungon me shpresën se do ta arrijë. Mos harro! Çdo gjë ka mangësitë e veta dhe jo më kot është thënë se vete të vendosësh vetulla, por nxjerr dhe sytë.
142. Pa mall e gjë erdhi njeriu. Pa mall e gjë do të kthehet.
143. Ja do t'i rezistosh djegies nga etja, ja do të zhuritesh prej shuarjes së saj.
144. Shpirtrat e shëmtuar nuk durojnë dot bukurinë e shpirtrave të lartë. Kusur nuk lënë pa e shëmtuar të lartën, por në ligësinë e tyre do të digjen.
145. Lakmia për fronin të bën të përdorësh kryerjen e të mirave si perde të qëllimit. Mos harro! Dikund do të pengohesh dhe perdja do të bjerë.
146. Tradhtia e atyre me të cilët ke ndarë një bark është tradhtia më e rëndë. Mos u pikëllo! Asgjë nuk do të zgjasë përgjithmonë mbi këtë botë.
147. Për të mbërritur tek dashuria duhet shkelur me krenari mbi argjend e flori.
148. Edhe i marri ka fatin e vet.
149. Ditët ndërrojnë në jetën e njeriut. Ato që vështirë ndërrojnë janë virtytet dhe veset. Lufto ta pastrosh veten nga veset.
150. Mund të mbulohesh nga papastërtitë dhe të të nënçmojnë. Mos u shqetëso! Mirësia e zemrës do të të lajë e pastrojë. Ki durim!
151. Njihja vlerat dhe potencialet vetes. Rrallë qëllon të gjenden njerëz që çmojnë vlerat dhe potencialet e tjetrit.

152. Edhe në mos besofshin në aftësitë e tua mos u jep. Vazhdo çel udhën tënde.
153. Mos prit që pasardhësit e tu të jenë të gjithë njësoj. Vlerësoi dhe çmoji në aftësitë e tyre me drejtësi, dashuri dhe mëshirë.
154. Dashuria për flori djeg të vjetër e të ri, të varfër e të pasur. Vetëm diamantet nuk shqetësohen prej saj.
155. Nëse di për kundërshtarin atë që ai kujton se nuk e di do ta vësh përfund. Prandaj vlerësohet më tepër mendja se forca.
156. Zemërgurët nuk duan t'ia dinë për të mirat që u kë bërë. Nëse do të bien në hise dhe të kanë në dorë edhe sytë e ballit t'i nxjerrin.
157. Nëse je zanatçi i mirë dhe punon me drejtësi, dyert e hairit nuk të mbyllen.
158. Fryrjet e të djallëzuarve të përvëlojnë shpirtin. Mjerë kush helmohet prej tyre.
159. Bota është tregu ku ziejnë të gjithë zërat. Dëgjo me veshët e zemrës që të njohësh miqtë e tu.
160. Hakmarrja e të ligut është e rëndë, por përballohet.
161. Kush nuk të ka dashur në vështirësi, nuk të do as në mirësi.
162. Edhe në të përfshiftë etja dhe uria mos e shtri dorën e bekuar drejt shtriganëve. Nuk ka vjelë kush fruta të ëmbla nga pemët e liga dhe nuk ka shuar etjen kush nga burimet e papastra.
163. Zërat e bukur këndojnë meloditë më të ëmbla, por një shpirt i zi nuk këndon dot ëmbëlsisht.
164. Nuk duhet neglizhuar problemet e vogla. Mblidhen pak nga pak dhe bëhen ortek.
165. Zëri është veçori karakteristike. Që të jetë edhe më i veçantë zbukuroje me sjellje të mira dhe të virtytshme.
166. Nuk duhet lejuar përballja e pastërtisë femijërore me djallëzinë e të poshtërve. Në ndodhtë kjo përfundimi është i qartë.
167. Mos e ndiz zjarrin e hakmarrjes, duke mos i shpërblyer shërbyesit e tu. Mos harro! Është zjarr i egër që shuhet me vështirësi.
168. Mos u trego i hutuar e i pavëmendshëm ndaj gjërave me rëndësi. Do të humbësh shumë.
169. Durimi është çelësi jetës. Nëse humb çelësin nuk e çel dot atë derë.
170. Mëshira ndaj të ligut është shkatërrim i drejtësisë.
171. Ajo që është shkruar të vijë nuk kthehet pas. Ajo që është shkruar të shkojë nuk mund të qëndrojë.
172. Dredhitë e të ligut nuk kanë të sosur. Duhet syçeltësi për t'iu ruajtur leqeve që ngre i pabesi.
173. Kush refuzon këshillat e më të urtëve me siguri do të mësojë duke vuajtur. Mësim i vështirë do të jetë dhe për më tepër nuk dihet në do të qëndrosh dot në këmbë.
174. Ziliqarët janë më të poshtër njerëz. Në i njohsh qëndroju larg. Në mos i njohsh provë të rëndë ke përpara. Forcohu në sinqeritet që të kallen në të tyren zili, të digjen e të bëhen hi.
175. Të paditurit i bëjnë fresk njëri – tjetrit dhe iu duket se rrojnë në mbretërinë e mençurisë.
176. Amaneti nuk duhet shitur edhe nëse flori i madh të hidhet në prehër. As varfëria, as pasuria nuk zgjatin përgjithmonë, por virtytet mbeten me të zonë.
177. Kënaqësia e shpirtzinjve qëndron në turimin e tjetrit. Nëse të qëllon një i tillë në pjesë, mprish shpatën e durimit dhe kalit mburojën e shpresës.
178. Për të mbërritur në viset që fort i dëshiron, e vetmja pengesë janë ato vise.
179. Ëndrrat janë frymëzim. Ndodh që në to të gjejmë çelësin e zgjidhjes kur nuk e gjejmë askund tjetër. Por jo çdo ëndërr është një çelës.

"Njeriut të sotëm mund t'i merret çdo gjë përveç kujtimit".



Ismail Muçej

jeta dhe vepra

Kumtesë në veprimtarinë shkencore
"Ismail Muçej, një jetë në shërbim të dijes",
organizuar nga medreseja "Haxhi Sheh Shamia",
më datë 13/05/2018.

— Gilman S. Kazazi —

Modeli i prof. Ismailit, shërben për gjeneratat e reja si **shembull dhe burim përkushtimi** me studimin dhe përpjekjen individuale për t'u formuar si intelektual, si studiues, si veprimtar fetar, qytetar dhe kulturor.

Ai është një nga figurat dhe personalitetet që kanë lënë **gjurmë në përhapjen dhe zhvillimin e kulturës islame** në vendin tonë.

Do ta kisha të pamundur ta jap të plotë figurën e prof. Ismailit po të mos isha bazuar në:

- takimin me zonjë Vildane Muça, kujtimet e saj dhe dorëshkrimi i jetëshkrimit të hartuar nga vetë prof. Ismaili. Ky dorëshkrim quhet "Shënime rreth një pjese të jetës sime." dhe përbëhet nga tetë faqe.

- jetëshkrimin e shënuar nga studiuesit e nderuar Faik Luli, Islam Dizdari dhe Nexhmi Bushati, në librin e tyre "Në kujtim të brezave", fq: 665-684.

- në copëza nga shkrimet e prof. Ismailit në gazetën "Drita Islame".

Ismail Muçej u lind më 14 Dhjetor, 1924, në fshatin Spas të Kukësit. Rrjedh nga një familje me taban fetar. Babai, Hysejni me prejardhje nga Gjakova, ka përfunduar medresenë e Prizrenit dhe ka ushtruar aktivitetin si hoxhë. Ai ka njohur mirë gjuhën arabe, turke dhe frëngjishten. Ndërsa nëna, Zyhraja, rrjedh nga një familje shkodrane.

Më 1932 ka ardhur pranë dajave në Shkodër, për të filluar dhe vazhduar shkollën fillore. Më 1937 i është akorduar bursa për të filluar studimet e mesme në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës. Mbas 8 viteve ka përfunduar studimet në të, me rezultate të shkël-

qyera. Ai, gjithashtu, u edukua privatisht edhe nga elita e hoxhallarëve shkodranë.

Që nga moshë e rinisë dhe në vazhdim është marrë me shkrime, përkthime, studime, veprimtari intelektuale dhe politike (pjesëtar në organizatën e Ballit Kombëtar).

Është interesante të theksojmë se artikullin e parë e shkroi në përkujtim të vdekjes së Hafiz Adem Kazazit (1890-1944). Sot, po kthehet një borxh moral, një Kazazi i ri po përgatit për herë të parë një biografi për të.

Në rininë e tij, ka shërbyer si sekretar i Komitetit Bamirës Mysliman të Shkodrës; është punësuar edhe në arsimin shtetëror, si mësues, si sekretar i Seksionit të Arsimit në Kukës; drejtor i shkollës fillore në Krumë të Hasit; inspektor arsimit në Pukë; bashkëpunëtor i rregullt i revistës "Kultura Islame", organ i Komitetit Mysliman Shqiptar.

Më 1952, kur ishte akoma në Pukë, ishte i fejuar me Melianë, një bijë nga familja Djepaxhia dhe po përgatitej që të transferohej në Shkodër dhe të maritohej, por arrestohet. Arrestohet me akuzën zyrtare "kontaktet me diversantët për të rrëzuar pushtetin", por u shtua edhe një akuzë tjetër gojore, "...e pa imagjinuar nga unë, se gjoja kisha përgatitur planin për të vrarë Enver Hoxhën dhe si pasojë u dënova me vdekje, pastaj 20 vjet, e më pas afër 12 vitesh u lirova." – shënon prof. Ismaili.

Më 1963, pas 11 vitesh, në moshën 39 vjeçe, lirohet nga burgu dhe detyrohet të punojë si punëtor krahu. Zotnia i nderuar u burgos, u keqtrajtua nga sistemi i kohës por nuk i mohoi bindjet e veta fetare, nuk iu

nënshtua politikave shkatërruese, nuk e mbështeti antifetarizmin. Edhe ky **prizëm i qëndresës dhe durimit** vlen si model për ne. Prof. Ismaili shprehet: *“Duke qenë ashtu i lidhur këmbë e duar, moralisht shumë i lartë. ... ndihesha shumë krenar, asnjë mërzitje, përveç shqetësimit për gjendjen e prindërve e të vëllezërve. Isha i lidhur ngusht me këndimin e Kuranit dhe të lutjeve.”* Përkujtimi i njerëzve të tillë është jo vetëm një akt njerëzor por edhe një mësim për brezat e rinj të hoxhallarëve, që të mos bien pre e mashtrimit dhe e aventurierëve politikë.

Periodua e burgut, me gjithë vështirësitë, vuajtjet fizike dhe shpirtërore, ka luajtur rolin e një shkolle të jetës. Kontaktet me të gjitha kategoritë e njerëzve në burg, mjedis i cili grumbullonte intelektualë të shkolluar në shkolla perëndimore dhe orientale, mësues, oficerë, hoxhallarë, priftërinj, tregtarë e deri te punëtori i thjeshtë, krijonte një frymë kulture e pjekurie, një universitet jete. Prof. Ismaili shënon: *“Në burgun e Burrelit ishin mbledhur njerëz të elitës intelektuale e patriotike, aty ishte një shkollë për mue, ku mësova gjermanishten e turqishten, i kalonim ditët duke diskutuar çështje kulture dhe patriotike.”*

Në burg, zotni Ismaili takohet me mësuesin, edukatorin dhe eruditin nga Elbasani, prof. Etëhem Haxhiademi, i cili mes tjerash e këshillon të hartojë një fjalor arabisht-shqip.

Me një punë këmbëngulëse, rreth 20 vjeçare, prof. Ismail H. Muçej ka hartuar dy fjalorë: Arabisht-shqip me 45.000 fjalë e 20.000 shprehje, si dhe shqip-arabisht me 25.000 fjalë e 30.000 shprehje, të cilët po të gjejnë rrugën e botimit arrijnë në 3300 faqe libri.

Përveç këtyre dy fjalorëve, I. H. Muçej ka përkthyer nga gjermanishtja një metodë për të mësuar gjuhën arabe duke u mbështetur në kritere didaktike e pedagogjike.

Krahas fjalorit dhe metodës për mësimin e arabishtes, ai përktheu dhe përgatiti për botim disa vepra, prej tyre: “Feja dhe misioni i saj”, “Pse përqafova Islamin?”, “Rendi i ri botëror” etj.

Pas ndryshimit të sistemit monist, zotnia i tij ka kryer detyra të shumta, prej tyre: anëtar i kryesisë të Komunitetit Mysliman; drejtor për çështjet e kulturës pranë këtij Komuniteti; kryeredaktor i gazetës “Drita Islame”; mësues i arabishtes në medresenë e Shkodrës “Haxhi Sheh Shamia”.

Ismail Muçej e drejtoi gazetën “Drita Islame” për gjatë viteve 1991-1999. Për detyrën e kryeredaktorit është me interes të shkëpusim një fragment nga fjalimi i tij, botuar në gazetën “Drita Islame”, nr. 5, mars 1995, fq. 1. Në këtë artikull përçohet ndjenja e përgjegjësisë, vendosmëria, synimi dhe thjeshtësia e tij:

“Ne i dolëm të zotë kësaj barre të rëndë e shumë delikate për të larë borxhet që kemi ndaj institucioneve fetare që na patën pajisur me kulturë fetare... kemi hyrë në vitin e katërt që po e nxjerrim një gazetë fetare dyjavore “Drita Islame”, drejtimi i të cilës më është

besuar mua e me tre kolegë të redaksisë. Më tepër si diletant, flas për veten time jemi përpjekur që me këtë të hedhim disa shkëndija të kulturës islame. Është e natyrshme që kërkesat e kohës janë më të mëdha, por kaq janë aftësitë e mundësitë materiale.”

Ismail Muçej nuk është kufizuar me shkrime vetëm në gazetën “Drita Islame”, por ka qenë bashkëpunëtor edhe në organe tjera të shtypit, si: “Rinia Islame”, “Balli i Kombit”, “Rilindja Demokratike”, “Rimëkëmbja” etj.

Karakter i artikujve të tij ka qenë i larmishëm, fetar, politiko-shoqëror, historik, edukativ, gjuhësor, etj. Mes artikujve lexojmë: kujtime, reportazhe, replika, përkthime, çështje fetare, problematika shoqërore, qasje edukative etj.

Ai është vlerësuar si publicist, studiues, poliglot, sepse njeh gjashtë gjuhë të huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, arabisht dhe turqisht. Prof. Ismaili shënon: *“Njohja e këtyre shumë gjuhëve të huaja më kanë zgjeruar kulturën dhe më kanë ndihmuar për zgjidhjen e problemeve të jetës.”*

Ndërsa për raportet me librin, prof. Ismaili i shpreh si më poshtë: *“Librin nuk e lëshoj nga dora. Ai mbetet miku më i dashur i imi.”*

Në gazetën “Drita Islame”, nr. 11, gusht 1994, fq. 3, në një artikull të botuar për mësuesin dhe hoxhën e tij, Haxhi M. Bekteshi, prof. Ismaili përcjell ca fragmente nga jeta e tij. Këto fragmente të shkëputura shpalosin vullnetin e prof. Ismailit në kërkimin e diturisë dhe edukatën e tij ndaj mësuesit:

*“...në vitin 1940, në ditët e luftës italo-greke, kur të gjitha shkollat u mbyllën për asye luftime, më duhej t'i vazhdoja mësimet privatisht, sidomos ato teologjike, kështu që trokita në shumë porta, por ajo më bujarja, shtëpia e eruditit të njohur Haxhi M. Bekteshi, m'u hap me një të trokitur. Ai pranoi pa ngurim të më radhiste ndër studentët që mësonte çdo ditë. Fillim në sintaksën arabe, e më pas me pedagogjinë fetare me anë të teksteve të njohur: “**Ta'limul Muteal-lim**”¹ “**Ejjuhel Veledu**”² dhe metodën e të predikuarit të fesë. ... Nga ana ime, çdo Natë të Mirë i drejtohem Zotit me lutje fetare përkatëse që shpirtin e e tij ta lartësojë, ashtu siç u mundua ai me sa ishte gjallë, të na lartësojë e të na i pasurojë dituritë tona.”*

Prof. Ismaili zë një vend të merituar në qarqet intelektuale të qytetit tonë, por edhe më gjerë. Ai është njohës dhe vlerësues i kulturave të ndryshme, të Lindjes dhe Perëndimit. Jeta dhe veprimtaria e tij sjell ndër ne mesazhe të qarta dhe na bën thirrje për të qenë gjithmonë fetarë të mirë, studiues të saktë, familjarë të rregullt, qytetarë shembullor për të mirën e qytetit dhe vendit.

1. Me autor Burhanud-din Ez-Zernuxhi, (vd. shek. i VII h.).

2. Me autor Ebu Hamid El-Gazali, (vd. 505 h.).



RRUGËT MODERNE QË TË SHPIEN NË IMORALITET

— Sami Byjkkajnak —

Në vendin tonë ka shumë të rinj që bien në humnerën e imoralitetit. Imoraliteti i syrit, imoraliteti i këmbëve, imoraliteti i duarve dhe të gjitha imoralitetet e tjera që mund të quhen të tilla, i kanë kapluar mendjen dhe veprimet rinisë, madje myslimani i çdo moshe po hyn në këtë presion. Imoraliteti është i ndaluar në të gjitha fetë. Ndërsa feja jonë, Islami, jo vetëm imoralitetin, por i ka ndaluar edhe të gjitha sjelljet apo veprimet që të shpien te imoraliteti. Kështu, Zoti i Lartësuar, për t'i ndaluar robërit e Tij që të mos drejtohen ndaj rrugëve që përfundojnë në imoralitet, thotë:

“Dhe mos iu qasni imoralitetit, se ai është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!” (Isra, 32)

Ne duhet ta dimë edhe qasjen që kishte në këtë

çështje i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, i cili është shembulli më i bukur për ne. Siç tregon një sahab i quajtur Ebu Umame (r.a.), në lidhje me këtë çështje, një i ri që sapo ishte bërë mysliman, shkoi te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: “O Pejgamberi i Allahut! Më jep leje për të bërë imoralitet, sepse nuk po e mbaj dot veten.” Sahabët që gjendeshin aty u kthyen nga i riu dhe u përpoqën t’ia ndërprisnin fjalën duke i thënë: “Hesht! Hesht!” I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, u kthye nga i riu dhe i tha: “*Afrohu!*” I riu u afrua te i Dërguari i Allahut (a.s.). Pejgamberi ynë i nderuar i tha: “*Ulu!*” Edhe i riu u ul. I Dërguari i Allahut (a.s.), e pyeti: “*A do të të pëlqente nëse dikush do ta bënte këtë gjë me nënën tënde?*” I riu tha: “Jo, për Zotin nuk do të më

pëlqente.” I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: “Edhe njerëzve, ashtu si ti, nuk do t’u pëlqente që dikush ta bënte këtë gjë me nënën e tyre. A do të të pëlqente nëse dikush do ta bënte këtë gjë me vajzën tënde?” I riu u përgjigj: “Jo, për Zotin nuk do të më pëlqente.” Pejgamberi, alejhi’s-selam, i tha: “Edhe njerëzit, ashtu si ti, nuk do të pranonin që dikush ta bënte këtë gjë me vajzën e tyre pa pasur lidhje martesore. A do të pranoje nëse dikush do ta bënte këtë gjë me motrën tënde?” I riu u përgjigj: “Jo, për Zotin nuk do të pranoja.” I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha: “Edhe njerëzit, ashtu si ti, nuk do të pranonin që dikush ta bënte këtë gjë me motrën e tyre. A do të pranoje nëse halla jote do ta bënte diçka të tillë?” I riu tha: “Jo, për Zotin nuk do të pranoja.” I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, i tha: “Edhe njerëzit nuk e pranojnë këtë për hallën e tyre. A do të pranoje nëse teza jote do ta bënte këtë gjë?” I riu tha: “Jo, për Zotin nuk do të pranoja.” Pastaj i Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

“Si mund ta pranosh për të tjerët diçka që nuk e pranon për vete dhe për të afërmit e tu?” Pastaj e vendosi dorën në supin e të riut dhe u lut për të: “O Zot! Falja mëkatet këtij të riut, pastroja zemrën nga ndjenjat dhe mendimet e tilla dhe ruaja nderin!” Sahabi që e transmeton këtë ngjarje, thotë: “I riu pas kësaj nuk kërkoi më ta bënte këtë vepër të paligjshme.” (Ahmed ibn Hanbel, Musned, 5/256-257.)

Tani ka kaq shumë faktorë që i afrojnë të rinjtë drejt imoralitetit, saqë rrugët, sokakët dhe lagjet janë të mbushura plot me të rinj të pavetëdijshëm. Televizionet e inkurajojnë imoralitetin. Kompjuteri dhe interneti ka plot faktorë të tillë negativë. Ja, pikërisht në këtë gjendje Allahu Teala thotë: “Mos iu afroni imoralitetit! Dilini për zot nefsit tuaj!” Edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, na paralajmëron: “Mos tentoni t’i afroheni një vepre të tillë!” Në të njëjtën kohë na jep edhe përgëzimin për privilegjin e qëndrimit nën hijen e Arshit të Allahut Teala në Ditën e Kiametit kur nuk do të ketë hije tjetër përveç kësaj hijeje.

Ne jemi ballë për ballë me sprovën e nefsit. Nëse nuk i japim rëndësi luftës me nefsin, e cila pranohet si “lufta e madhe” që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), u ka thënë sahabëve të tij kur po ktheheshin nga lufta dhe, nëse nuk gjendemi në vende që na ndihmojnë kundër nefsit në këtë luftë, atëherë është çështje momenti për t’u mposhtur nga armiku ynë që quhet nefsi. Sepse lufta ndaj nefsit në të njëjtën kohë do të thotë zbatim i ligjit hyjnor “mos iu afroni imoralite-

tit”. Askush nuk e ka të mundur që të jetë i sigurt nga nefsi i tij. Edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.), është lutur çdo ditë: “O Zot! Mos më lër në dorën e nefsit tim as sa hapja dhe mbyllja e syve!”

Të thuash: “Unë mund të shëtis nëpër vende ku dominon morali i ulët. Sidoqoftë mund t’i dal për zot nefsit tim...” - dhe të pohosh justifikime në formën: “Unë mund të hyj nëpër tunelet e errëta të internetit, sepse i besoj vetes. Mund të flas me gjininë tjetër, sepse jemi vetëm shokë dhe po bisedojmë...”, nuk është gjë tjetër përveçse mashtrim i vetes. Kështu, punët që fillojnë me një bisedë, më vonë i zvarrisin të rinjtë drejt mëkatit. Pastaj njeriu fillon ta pranojë mëkatit sikur të ishte një veprim normal. Më së fundi, zvarritet drejt humnerës së mëkatit dhe rrokulliset në të.

Për shembull, faqet e internetit me emrin “martesa islame”, po na i zvarrisin të rinjtë tanë drejt mëkatit sikur po u japin fetva duke i pasqyruar si normale këto punë. Ata që i shpërndajnë fotografitë private të tyre nëpër rrjetet sociale dhe ata që justifikohen duke thënë se “nuk ka gjë për një bisedë apo se nuk ka gjë për një shikim”, shihet se e gjejnë veten në humnerën e imoralitetit, madje vihet re se e humbin veten aq shumë saqë fillojnë tregtinë e imoralitetit.

Për këtë arsye, të gjithë individët myslimanë, pra të rinjtë, të moshuarit apo edhe ata që janë në moshë të mesme, domethënë të gjithë ne, duhet ta ndalojmë veten në një mënyrë që na ka hije nga punët që të zvarrisin drejt imoralitetit. Në të njëjtën kohë, në një qoshe të mendjes sonë duhet të gjendet fjala e Jusufit (a.s.): “**Unë nuk e shfajësoj veten, sepse nefsi (i njeriut) është fort i prirur për të keqe...**” (Jusuf, 53) Nisur nga kjo, ata që i besojnë nefsit të tyre, po shikojmë se po gjenden nëpër humnera. Këto janë humnera aq të tmerrshme saqë edhe shikimi drejt tyre e tmerron njeriun. Nëse përpiqemi për t’i gjetur rrugët e frenimit të nefsit, ndihmësi ynë do të jetë Allahu i Madhëruar. Atëherë dora e Allahut Teala do të jetë mbi ne.

O njeri, mos i beso nefsi! Nefsi të urdhëron të keqen. Prandaj frenoje veten dhe lidh shoqëri me të mirët, në mënyrë që rruga, zemra dhe veprat e tua të jenë të bukura! Mos thuaj: “Një herë është kjo!” Sepse, një gjë që bëhet një herë, bëhet edhe me mijëra herë. Qëndro larg imoralitetit dhe gjërave të ndaluara, në mënyrë që zemrën ta kesh të pastër dhe veprat të sinqerta!



Kthehu tek Allahu

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: **“O robërit e Mi që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe, mos i këputni shpresat nga mëshira e Allahut. Ai (Allahu) i fal të gjitha gjynahet tua, Ai është Mëkatfalës dhe i Mëshirshëm”**. (Ez Zumer: 53)

Të gjithë e dimë që Allahu (xh.sh) ka cilësitë më të larta, ai kujdeset për ne qysh kur jemi në barkun e nënave tona. Ai na ushqen edhe aty ku nuk na shkon mendja. Ai drejton dhe udhëzon kë të dojë, por habia më e madhe është me ata njerëz, të cilët Allahu (xh.sh) i ka krijuar, i ruan dhe u jep rrizkun, iu jep jetën dhe jua merr atë, por megjithatë këta njerëz i largohen çdo ditë Allahut, Zotit të botëve. Ku po shkojnë këta njerëz. Pse po i largohen Zotit të gjithësisë?!

Iu drejtohem të gjithë atyre që mendojnë se janë larg Allahut (xh.sh), se nuk mund të kthehen përsëri tek ai dhe mendojnë se nuk mund t`ua falë kush gjynahet. Dijeni se mëshira e Tij është e pakufishme. Allahu (xh.sh) e pret robin e Tij që të pendohet, derisa shpirti nuk i ka dalë prej trupit. Allahu (xh.sh) e ka të hapur gjithmonë derën e mëshirës, për të gjithë ata që e duan mëshirën dhe faljen e Tij.

Shejtani i mallkuar me strategjinë e tij është shumë i specializuar sesi ta humbë njeriun. Në fillim i pëshpërit njeriut: “Ti je njeri i mirë. Nuk ka problem nëse bën disa gabime të vogla, sepse ke shumë të mira”. Kështu njeriu futet çdo ditë e më tepër në rrugën e gjynahut, derisa vjen një ditë, që rrjetat e djallit e kanë rrethuar nga të katër anët. Atëherë ai

dëshiron të kthehet tek Allahu (xh.sh), e ndjen se vetëm Zoti mund t`ia falë këto gabime. Por shejtani i thotë: “Po të doje të ktheheshe, të ishe kthyer sa kishe kohë, sepse tani është shumë vonë. A e shikon sa gjynahe ke bërë. Ato nuk i mban as qielli e as toka, prandaj nuk ka kush të t`i falë gabimet e tua”.

O njeri! Ti që bërë një gabim dhe shkove e re në kurthin e shejtanit, mos bëj një gjynah akoma më të madh, duke menduar se nuk ka kush që mund t`i falë gjynahet e tua. Nëse mendon kështu, dije se këtu ka filluar rruga jote për xhehenem. Allahu (xh.sh) që të ka krijuar ty, ka mundësi dhe fuqi t`i falë gjynahet e tua, sepse të krijoi gabimtar, por të ka dhënë mundësinë që të përmirësohesh dhe të kërkosh falje. Prandaj mbaje gjithmonë të ndezur optimizmin dhe shpresën tek falja e Allahut (xh.sh).

Ka njerëz që thonë se gabimet e tyre janë të shumta dhe se nuk mund t`i falë kush. U themi këtyre njerëzve, se edhe ne besimtarët që falim namaz dhe agjërojmë, i mbështetemi shpresës dhe mëshirës së Allahut (xh.sh). Ne nuk kemi besim tek punët tona, por tek falja e Allahut (xh.sh). Prandaj edhe ju o njerëz që e ndjeni gabimin e mëkatit, kthehuni tek Allahu (xh.sh) se do të gjeni falje dhe mëshirë të madhe.

Një njeri shkon tek profeti (a.s) duke i rënë me grushta kokës së tij dhe duke thënë tre herë rresht: “I mjeri unë për mëkatet e mia”. Profeti Muhamed (a.s), i cili e dinte fare mirë se ku e ka problemin

ky njeri, e kap fort për krahu dhe i tha: **“O njeri mos fol kështu, por thuaj: “O Zot! Falja Jote është më e madhe se mëkatet e mia. Tek mëshira Jote shpresoj më shumë sesa tek punët e mia, prandaj më fal mua”**. Pasi ky njeri tha tre herë kështu, profeti (a.s) ia ktheu: **“Ngrihu tani, se Zoti t’i fali gjynahet”**.¹ Prandaj duhet që gjithmonë t’i mbështetemi faljes dhe mëshirës së Allahut (xh.sh), më tepër sesa punëve tona që bëjmë, qofshin ato punë, namaze, agjërim, sadaka apo diçka tjetër.

Sikur falja të llogaritej me peshore njerëzore, sa herë të përmendej dikush që ka vlarë dikë, menjëherë do na shkonte mendja se në ç`vend të xhenehemit do ta ketë vendin ai person. Dijeni se nuk ndodh kështu me Allahun (xh.sh). Sikur i gjithë njerëzimi të heqë dorë prej dikujt dhe të mos kishin besim tek ai njeri as prindërit e tij, atë person nuk e lëshon Allahu (xh.sh), sepse është krijesa e Tij.

Një njeri nga popujt e kaluar arriti të vrasë 99 vetë. Imagjiloni se çfarë zemre ka pasur ky njeri, si nuk i është dridhur dora dhe ka vlarë 99 njerëz, sikur po vriste 99 zogj. Një ditë prej ditësh e ndjeu se këto mëkate mund t’i falte vetëm Allahu (xh.sh), e ndjeu se jeta nuk mbaron me kaq. Shkoi dhe takoi një dijetar, që po falej në majën e një mali dhe i tha: “Unë kam bërë shumë gabime, por dua të pendohem. Të lutem më trego se çfarë duhet të bëj”. Kur ky dijetar merr vesh, se çfarë ka bërë ky njeri, i thotë: “Si paske mundur të bësh diçka të tillë? Nuk t’i fal njeri këto krime”. Atëherë ky njeri i zemëruar nga përgjigja e dijetarit, i zemëruar se po i mbyllej dera e pendimit, e vret edhe dijetarin dhe thotë: “Le të bëhen 100, le të bëhet ç`të bëhet”.

Por përsëri në zemrën e tij ekzistonte shpresa, se Allahu (xh.sh) mund t’ia falte gabimet dhe kërkon dikë që t’i tregojë se si mund të pendohet tek Allahu (xh.sh).

Një besimtar i thjeshtë i thotë: “Në qoftë se ti dëshiron të pendohesh, dije se derën e ke të hapur, derisa nuk të ka dalë akoma shpirti, por largohu prej këtij vendi, se këtu ka njerëz të ligj, shko më mirë në fshatin tjetër”.

Ky njeri me dëshirën e madhe për t’u penduar, niset drejt fshatit tjetër, duke menduar nëse Allahu (xh.sh) do t’ia falte gjynahet, do t’ia falte vrasjen pa të drejtë të 100 personave. Por duke ecur në drejtim të fshatit ku kishte besimtarë, atij i vjen exheli, i vjen vdekja.

Melekët e mëshirës dhe melekët e dënimit vijnë për ta marrë dhe nisin të debatojnë mes tyre se

1. **Hadith i pranuar.** Hakimi (1544). Dhehebiu thotë: “Përcjellësit janë të gjithë medinas dhe nuk janë të vlerësuar negativisht”.

kush do ta merrte.

Melekët e dënimit thanë: “Do ta marrim ne, sepse ka bërë shumë gjynahe”.

Melekët e mëshirës thanë: “Do ta marrim ne, sepse ka dashur të pendohet”.

Atëherë Allahu (xh.sh) u dërgon një melek tjetër, i cili u thotë: “A t’ju tregoj si të veproni? Mateni rrugën që ka bërë ky njeri nga fshati që është larguar dhe rrugën që ka mbetur për të arritur tek fshati ku ishte nisur. Nëse gjendet më afër fshatit me njerëz të këqinj, ai është njeri i keq. Nëse është më afër fshatit me njerëz të mirë, ai është njeri i mirë”.

Melekët e matën gjatësinë e rrugës. A e mendoni vallë se si dolën gjatësitë? Ky njeri kishte kaluar mesin dhe i ishte afruar fshatit me besimtarë vetëm **një pëllëmbë**. Madje thuhet, se ky njeri në momentet që po i dilte shpirti, ishte zvarritur me trupin e tij, derisa më në fund e kishte lënë kraharorin e tij drejt fshatit ku ishin besimtarët. Atëherë shpirtin ia morën melekët e mëshirës së Allahut (xh.sh). Kjo është mëshira e Allahut (xh.sh). Kësaj mëshire iu mbështet ai njeri, që vrau 100 vetë. Kësaj mëshire i mbështetem unë dhe ti. Kësaj mëshire le t’i mbështetet çdo njeri, që ka dëshirë të pendohet tek Allahu (xh.sh). Nuk ka gjë që e ndal faljen e Zotit.

Kur profeti Ibrahim (a.s) pa një njeri, që po bënte imoralitet, u lut kundër tij dhe ai person vdiq si jobesimtar. Pas disa ditësh Ibrahim (a.s) sheh një njeri, duke vlarë një tjetër. Përsëri lutet kundër tij dhe ky person vdes si jobesimtar. Kur sheh përsëri një njeri që po vidhte, ai lutet edhe kundër këtij personi. Ai lutej kundër këtyre njerëzve, sepse vjedhja, vrasja dhe imoraliteti janë nga mëkatet e mëdha.

Atëherë Allahu (xh.sh) i thotë: “O Ibrahim. Lëri të qetë krijesat e mia. Mos u lut kundër tyre. Këta njerëz për të cilët u lute, që t’i mallkoj dhe ata vdiqën jobesimtarë, Unë ose do t’i falja, ose do t’ua merrja shpirtin, por do të bëja që trashëgimtarët e tyre të ishin besimtarë, ose do të ishin jobesimtarë dhe do të meritonin xhehenemin, prandaj nuk është nevoja t’i mallkosh ti”. Kjo është mëshira e Allahut (xh.sh), mëshirë tek e cila duhet të shpresojmë të gjithë.

Ti mund të sëmuresh, sepse je njeri, por nxiton të marrësh mjekime, sepse dëshiron të shërohesh. Kur ecën rrugës, rroba jote mund të bëhet pis, por ti nxiton ta pastrosh rrobën tënde. Ti je njeri dhe sado të mudohesh, do të bësh gabime, prandaj nxito për tek falja e Allahut (xh.sh). Është e papranueshme, që ti të mos kthehesh tek Allahu (xh.sh) pas gjynahut që ke bërë.

Babai ynë, Ademi (a.s) bëri gabim. Kur Zoti e futi në xhenet, në mes gjithë të mirave, i tha: “Adem

ke të drejtë të shkosh ku të duash, vetëm atë pemë mos e prek”. Ai duke treguar dobësinë njerëzore, shkoi dhe preku pikërisht atë pemë, të cilën ia ndaloi Allahu (xh.sh), por menjëherë e ndjeu gabimin dhe tha: “O Zot! Unë kam bërë gabim prandaj më mëso se si duhet të pendohem”. Allahu (xh.sh) i tha: “**Thuaj: O Zot! Ne i bëmë padrejtësi vetes tonë. Nëse nuk na fal e nuk na mëshiron, ne do të jemi nga të humburit**”. Earaf 23. Ku do të futesh vallë nëse nuk të fal Zoti?! Prandaj gjithmonë kij shpresë tek falja e Allahut (xh.sh).

Allahu (xh.sh) thotë në një hadith kudsij: “**O robi Im! Në qoftë se ti më lutesh Mua dhe kërkon falje tek Unë, Unë do të t`i fal gabimet të gjitha e tua, sepse askush nuk më ndalon për këtë. O robi Im! Nëse do të vije tek Unë me gabime që kanë arritur sa retë në qiell dhe do të kërkoje falje tek Unë, Unë prapë do të t`i falja gabimet, sepse nuk ka gjë që më ndalon. O robi Im! Sikur të bëje gabime që do të mbulonin gjithë rruzullin tokësor, pastaj të vije tek Unë, duke e mbajtur të pastër fjalën LA ILAHE IL ALLAH, duke mos më vënë shok Mua, të gjitha këto gjynahe do të t`i ktheja në sevape**”.²

Prandaj gjithmonë duhet t`i kthehemi Allahut (xh.sh). Dera e pendimit është e hapur për të gjithë ata, që shpresojnë tek falja e Allahut (xh.sh).

Ajeti kuranor: “**O robërit e Mi që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe, mos i këputni shpresat nga mëshira e Allahut. Ai (Allahu) i fal të gjitha gjynahet tuaja, Ai është Mëkatfalës dhe I Mëshirshëm**” (Zumer: 53), ka zbritur kur Vahshiu, personi që vrau Hamzain, xhaxhanë e profetit (a.s), dëshiroi të kthehet tek Allahu (xh.sh).

Ai i çon një letër profetit (a.s), ku i thotë: “O profet i Zotit! Unë dua të pendohem por ia kam frikën një ajeti në Kuran, ku thotë se ai që i ka vënë shok Allahut (xh.sh), që ka bërë imoralitet dhe që ka vlarë tjetrin pa të drejtë, do ta marrë dënimin e tij. Unë kam vlarë Hamzain, kam bërë imoralitet dhe i kam vënë shok Allahut (xh.sh), prandaj kam

frikë se Zoti nuk m`i fal gjynahet”.

Atëherë zbret një ajet kuranor ku thotë: “**..përveç atyre që u penduan, besuan dhe bënë punë të mira. Këta njerëz Allahu ua kthen gabimet në punë të mira**”. (Furkan: 70).

Vahshiu tha: “Allahu (xh.sh) ka vënë kusht që të bëjmë punë të mira, mirëpo unë jam dembel dhe nuk bëj punë të mira, prandaj kam frikë se Allahu (xh.sh) nuk do të më falë”. Atëherë zbret ajeti: “**O robërit e Mi që e keni ngarkuar veten me shumë gjynahe, mos i këputni shpresat nga mëshira e Allahut. Ai (Allahu) i fal të gjitha gjynahet tuaja, Ai është Mëkatfalës dhe i Mëshirshëm**”. (Zumer: 53)

Le ta dijë çdo njeri se e ka një Zot, ka Allahun (xh.sh), i Cili nëse dëshiron, nuk pyet për gabimet e njerëzve edhe sikur të arrijnë kupën e qiellit, por i fal të gjitha. Ke një Zot, që ta ka hapur derën e pendimit dhe pret me padurim, që t`i kthehesh Atij. Nëse të duket sikur je me mijëra kilometra larg Allahut (xh.sh) dhe se për t`u kthyer duhet të bësh përsëri mijëra kilometra, dije se çëshja është shumë më e thjeshtë se kaq. Allahu (xh.sh) kërkon prej teje një pendim të sigurtë, kërkon vetëm një levizje zemre dhe në atë moment do ta gjesh Allahun (xh.sh) pranë teje. Ky është Allahu (xh.sh), Zoti ynë, prandaj ktheju fuqishëm Allahut (xh.sh).

A nuk është turp për ty, që me mijëra njerëz pendohen dhe kërkojnë falje tek Zoti dhe Zoti i fal ata, kurse ti akoma nuk po pendohesh? Deri kur do të presësh?

Zoti nuk na mëson që për t`u penduar, duhet të shkosh e të rrëfesh gabimet e tua përpara dikujt, sado i madh qoftë ai. Nuk është nevoja as të ngrihesh në mes të xhamisë dhe te deklarosh se je njeri i keq.

Allahu (xh.sh) kërkon prej teje një dhimbje zemre për gjynahun që ke bërë, një pendim shpirtëror dhe pas kësaj Ai t`i kthen gabimet e tua në sevape.

A nuk mund ta bësh diçka të tillë?! A e di se Allahu (xh.sh), i Cili me pushtetin e Tij drejton qiellin dhe tokën, drejton diellin dhe hënën, gëzohet pa masë kur robi i Tij pendohet.

2. **Hadith i pranuar.** Tirmidhiu (3540). Shejh Albani e vlerëson h - dithin të vërtetë, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson të pranuar për shkak të dëshmimeve përforcuese.

Profeti (a.s) tregon: **“Një njeri ka dalë në një rrugë të gjatë në mes të shkretëtirës me devenë e tij. Në këtë deve ka ushqimin dhe pijen e tij. Atë e kap gjumi dhe kur zgjohet, shikon se deveja e tij ka ikur. Nuk i ka ikur vetëm deveja, por i ka ikur jeta e tij. Ai tashmë nuk as bukë e as ujë, çfarë do të bëjë ai në mes të shkretëtirës! Atëherë kur bindet se nuk ka nga të shkojë, ai shtrihet nën hijen e një peme, duke pritur vdekjen. Kur zgjohet, shikon se ai nuk ka vdekur. Jo vetëm kaq, por ai shikon se deveja e tij është kthyer bashkë me ushqimin dhe pijen e tij. Atëherë nga gëzimi i madh ai në vend që të thotë: “O Zot! Ti je Zoti im e unë jam robi Yt”, ai thotë: “O Zot ti je robi im e unë jam zoti yt”. Zoti kënaqet me pendimin e robit të Tij, më shumë se ç’kënaqet robi i Tij në këto momente”.**³

Ky është Allahu (xh.sh). Ai pret prej nesh vetëm një rikthim shpirtëror, vetëm një lëvizje të zemrës dhe Ai i fal gabimet tona. Nëse ia ke frikën një kafshe apo një njeriu, ti largohesh prej tij dhe shkon në një vend më të sigurtë. Por nëse ke frikë nga gjynahet e tua, ku do t’i fshihesh Allahut (xh.sh).

Prandaj profetët thoshin: “Vraponi drejt Zotit tuaj, se nuk keni ku të shkoni tjetër. Unë jam lajmëtar i qartë për ju”. Nëse ia kemi frikën Allahut (xh.sh), nuk kemi se ku të shkojmë, por përsëri tek Ai do të kthehemi.

Prandaj ju që i lexoni këto rreshta. Tregojuni njerëzve se në çdo moment mund t’i kthehen Allahut (xh.sh) dhe të mos i humbin kurrë shpresat nga mëshira e Zotit, sepse Ai i fal të gjitha gabimet.

Duhet patur parasysh edhe diçka tjetër!

Duhet të kemi shpresë tek mëshira e Allahut (xh.sh), atëherë kur të dhemb zemra nga bredësia e saj. Nëse bën gabim pas gabimi dhe thua: “Zoti i fal gabimet tona”, dijeni se kjo është prej shejtanit dhe jo prej Allahut (xh.sh).”

Kur Ademi (a.s) bëri gabim, e ndjeu gabimin e tij. A që vrau 100 vetë, e ndjeu gabimin e tij edhe ai fshatari që shkoi tek profeti (a.s), e ndjeu gabimin e tij.

Ti do të mëshirohesh prej Allahut (xh.sh), nëse e ndjen gabimin tënd dhe pendohesh për të. Nëse vazhdon me mëkate, duke menduar se Zoti e paska mëshirën e madhe, mund të arrish deri aty, sa të të ngurtësohet zemra. Pas kësaj zemra nuk ndjen nevojën për pendim, ashtu siç nuk ndjen trupi i vdekur dhimbjen kur i bëjnë gjilpërë. Prandaj në momentin që e ndjen gabimin dhe pendohesh për të, dije se atëherë ke fituar faljen e Allahut (xh.sh) dhe shpërblimin e tij.

Është edhe një pikë që duhet theksuar!

Nëse i ke hyrë diku në hak, duhet t’ia kthesh hakun atij njeriu. Allahu (xh.sh) fal të gjitha gabimet që janë mes teje dhe Atij, kurse gabimet që bëjmë me njëri – tjetrin falen, duke i kërkuar hallallin personit që i ke hyrë në hak.

Ata që e ndjejnë se kanë shumë gabime, le të marrin abdes dhe të falin dy rekatë namaz për Allahun (xh.sh). Pastaj të luten me një pendim të sinqertë, që Zoti t’i falë. Vetëm kaq mjafton për t’u kthyer tek Allahu (xh.sh). Ne kemi shumë gabime dhe e ndejmë peshën e tyre, prandaj lus Zotin të na bëjë që ta ndejmë nevojën për faljen e Tij. Të gjithë ata njerëz që i kanë rrethuar mëkatet nga të katër anët, le ta dinë se ka një Zot, që i fal të gjitha gabimet, ka një Zot, i Cili pret pendimin e robërve të Tij, përderisa nuk u ka dalë shpirti nga trupi.

I lutemi Allahut (xh.sh) të na bëjë të ndjeshëm ndaj mëshirës hyjnore. Lus Zotin t’i falë gabimet tona, ato që i dimë dhe ato që nuk i dimë. Ato që nuk i dimë janë shumë më tepër se ato që i dimë. I lutemi Allahut (xh.sh), të na falë ne, prindërit tanë dhe të gjithë ata që e duan faljen e Allahut (xh.sh). I lutemi Zotit, të na japë shpresë dhe optimizëm, të na bëjë nga ata që kanë besim dhe i mbështeten mëshirës së Allahut (xh.sh) më shumë seç mbështeten tek punët e tyre, se vetëm ajo na fut në xhenetet e Allahut (xh.sh). I lutemi Zotit, të fusë në zemrat tona dashurinë për xhenet dhe për çdo punë që të çon drejt tij, të fusë në zemrat tona urrejtjen për xhehenem dhe për çdo punë që çon drejt zjarrit të xhehenemit.

Allahu (xh.sh) na mëshiroftë të gjithëve.

Amin!..

3. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (6308) dhe Muslimi (2744).



Aventura martesore

— Esin Akdeniz Tyxhar —

Martesa... Bashkimi i dy botëve të ndryshme... Që kur u shfaq ekzistenca njerëzore, që nga Hz. Ademi dhe Hz. Havaja, ajo është aventura e një burri dhe një gruaje që dalin nga vetmia dhe bëhen “ne” (bashkohen)...

Dy njerëz të ndryshëm bashkohen me një emocion e shpresë të madhe dhe me shumë ndjenja të tjera të bukura që nuk kanë emër. Jetesa familjare që prehet, dëshirohet dhe shpresohet nga zemrat me entuziazmin që japin ndjenjat, falin një emocion të madh. Në këtë mënyrë, realizohet martesa.

Martesa është një jetë e re, është shpresë dhe është gjëja e duhur. Është dashuri për njeriun e ngelur në vetmi, është gëzim dhe për më tepër, është ngjyrë që i shtohet jetës. Të gjithë e bëjnë martesën duke e shpresuar atë të ngjashme me imagjinatat e lumturisë...

Por ky institucion shprese dhe mirësie, nganjëherë mund të mos jetë siç imagjinohet dhe siç mund të shpresohet. Imagjinatat, më shumë janë gjëra që përjetohe nëpër zemra. Nëse kalohen në jetë, bëhen ideale. Nëse përjetohe vazhdimisht, bëhen të mrekullueshme.

Por kufizimi i botës moderne dhe ato që duhet të ndodhin për shkak të syzeve që media u ka vendosur të gjithëve, ato që mund të ndodhin dhe ato që dëshirohen nga martesa, janë ngatërruar me njëra-tjetrën...

Martesat nëpër telenovela që nuk i kanë ndodhur askujt, që nuk shtjellojnë jetën dhe që nuk janë afatgjata, shtojnë dëshpërimin. Ato përjetojnë ndjenjën: “Më duket se ka problem vetëm në martesën tonë!” Divorcet e shtjelluara shumë dhe përforcimi i tyre në jetë po me anën e medias, mund t’ua shkurtojë jetën martesave.

Institucioni i martesës, si në çdo vend të botës, edhe në vendin tonë po kalon një periudhë shumë problematike. Statistikat e divorceve kanë treguar se në dhjetë vitet e fundit divorcet janë shtuar në mënyrë të ndjeshme, madje është konkluduar se një në çdo dy martesa përfundon me divorc.

Individi i suksesshëm rritet vetëm në një mjedis të shëndetshëm familjar. Familja e shëndetshme mund të bëhet vetëm në mjedise ku martesat janë të lumtura. Nëse dëshirojmë që shoqëria në të cilën jetojmë, të jetojë në mirësi, duhet të studiojmë me të gjitha detajet mjediset e familjeve

në të cilat është pakësuar durimi në martesë ku bashkëshortët nuk e durojnë dot njëri-tjetrin, është shtuar zemërimi, sundon dëshpërimi e brenga. Pikat në të cilat përjetohen më shumë këto, duhet të ndriçohen sa të jetë e mundshme.

Aventura për t'u bërë "Ne" ndërkohë që ishim "Unë"

Sigurisht që askush nuk martohet duke menduar: "Nesër do të përballem me këto probleme!" Askush nuk dëshiron që të mos jetë i lumtur. Por aventura për t'u bërë "ne", ndërkohë që ishim "unë", ka shqetësimet e saj si çdo fillim. Çështje fare të papritura dhe detaje të parëndësishme ndodhin përballë çiftit të ri si një bombë më vete.

Fejesa, nishani, të afërmit, kërkesat, ceremonitë ndërmjet atyre që "duhet të bëhen" dhe atyre që "mund të bëhen", janë sprovat e para të çiftit të ri. Shtrimi i shtëpisë, zgjedhja e mobilieve, kursimet, allishverishet, dhuratat... Ato që pëlqehen, ato që merren pa u pëlqyer, çastet në të cilat hesitet për shkak se është turp, debatet disa ditore pa nijet të keq, fjalët që thonë apo nuk thonë personat e tretë, apo fjalitë e lëndimit që fillojnë me "Mua deshi të më thoshte..."

Në këtë mënyrë, një burrë dhe një grua, e mbajnë shpresën gjallë dhe hyjnë në shtëpinë e dynjasë me shpresat që përjetojnë në mendjen e tyre duke i kapërcyer rastet e rrezikshme që mund të shfaqen.

Ajo që tashmë ka filluar të përjetohet është një jetë e re e të rinjtë që kanë jetuar me familjet e tyre para martesës dhe që i kanë ndarë me to shumë përgjegjësi, që më parë nuk e kanë pandehur, ose më saktë e kanë ditur por nuk kanë pasur aspak përvojë nga ajo...

Veçanërisht për gruan, sjelljet që ka shfaqur më parë dhe për të cilat është lavdëruar, duartrokitur dhe mirëpritur nga të tjerët, tashmë janë bërë detyra dhe çështje të obliguara. Çdo ditë është e detyrueshme që shtëpia të jetë e pastër, e rregullt dhe ushqimet të jenë gati.

Këto janë gjëra që nganjëherë mund të kryhen lehtë për gratë e sapomartuara. Ndërsa nganjëherë shfaqet nevoja për të pyetur nënat: "A i hidhej qepë supës së thjerrzës? Cila markë ishte më e mirë për maja? Sa pika limoni duheshin për ta mbajtur të freskët pilafin?" Gjithmonë ka pyetje për t'u pyetur. Edhe nënat i kanë të gjitha përgjigjet... Nënat që mund të arrihen gjithmonë me telefon. Në këtë mënyrë vazhdon trafiku i telefonit.

Por ky trafik telefoni, gjithmonë nuk mund të japë rezultate pozitive për të rinjtë që përpiqen të bëhen "ne" duke formuar një vatër të re. Pastaj është e vështirë të vendoset se sa duhet të mbështeten të rinjtë që akoma nuk janë rritur në

sy të prindërve! Pak apo më shumë? Apo duhet një mbështetje e vazhdueshme dhe e pa ndërprerë? Kjo, nganjëherë duke mos u kuptuar, kthehet në mendimin e "mbështetjes së vazhdueshme".

Mbështetjet e përzemërta

Të rinjve që po përpiqen të bëhen "bashkëshortë" në një vatër që po formohet, u jepet "mbështetja e përzemërt" e nënës, babait, vjehrrës, vjehrrit, kunatës, hallës, dajës dhe tezes. Mbështetja është një fuqi shumë e vlefshme ashtu siç edhe quhet. Por ajo është e nevojshme nëse duhet. Përndryshe është një fuqi e çuar dëm dhe një israf. Ajo është edhe "barrë" nëse nuk ka nevojë. Të "vërtetat" që secili i ka nxjerrë nga eksperiencat e tij, mundohet t'ia mësojë nuses dhe dhëndrit të ri. Ata dëshirojnë t'i bëjnë të përfitojnë nga përvojat e tyre në mënyrë që t'i ndalojnë nga rënia në të njëjtat gabime.

Në fakt nuk ekziston vetëm një e vërtetë në lidhjet dhe martesat ndërmjet njerëzve. Nuk duhet të harrohet se "çdo martesë është e veçantë" dhe karakteri i çdo familjeje është i ndryshëm. Martesat ngajnë me njëra-tjetrën, por nuk mund të jenë të njëjta. Edhe pse të gjithë njerëzit mund të kenë anë të njëjta, ata posedojnë karaktere, kapacitete, zakone dhe veçori krejt të ndryshme personale. Martesat janë të veçanta. Ndërsa këshillat janë të rëndësishme dhe udhërrëfyese.

Nëse këshilluesi nuk është këmbëngulës, u jep mundësi të rinjve të lidhin martesën dhe të zbulojnë karakterin e njëri-tjetrit, përndryshe kaosi vazhdon. Të gjitha këshillat dhe ndarjet e përvojave të të afërmeve që fillojnë me "qëllimin e mirë", për shkak të injorancës, e kalojnë ekstremin e dashurisë duke u kthyer në një "kor me shumë zëra". Në këtë kor të gjithë përsërisin me zë të lartë përvojat që kanë kaluar përgjatë viteve. Çifti që ka marrë rrugën për t'u bërë "ne", nën këtë zhurmë të thatë nuk mund ta dëgjojnë zërin e njëri-tjetrit. Këtë zhurmë mund ta quajmë "Kori i Fëmijëve".

Kori i Fëmijëve

Deri në pesë-dhjetë vitet e fundit kryetarja e "Korit të Fëmijëve" zakonisht ishte nëna e djalit. Vjehrrat haptas ose në mënyrë të fshehtë janë sunduese të forta në formimin e këtij ekuilibri të ri. Ato kanë gjithmonë fjalë për të thënë dhe mbështetje për të dhënë në ekuilibrin brenda shtëpisë si p.sh: "Djali im është shumë i rregullt, djali im nuk i ha kurrë bamjet, djali im fle pak kur kthehet nga puna."

Këtu qëllimi është i mirë: "Të mos humbin kohë; të tregoj që ata të mos mundohen shumë për të njohur njëri-tjetrin. Të rinjtë të kalojnë mirë dhe të mos grinden."



Por në vatrën e re familjare, çifteve nuk u jepet rasti për t'i treguar veten njëri-tjetrit. Në fakt aty ekziston mesazhi: “Ju jeni akoma të vegjël, nuk jeni rritur ende! Prandaj nuk mund të jetoni pa praninë tonë!” Ndërkohë fjala që thuhet më shumë është: “Të jenë mirë në follenë e tyre!”

Por nga foleja akoma dëgjohej zëri i lartë i korit. Sa keq që të rinjtë brenda këtij kallaballëku i thonë ato që dinë me zë shumë të lartë “duke bërtitur”, kruajnë veshët ose kaplohen nga një heshtje e madhe.

Pavarësisht këtij kori të zhurmshëm, ka edhe shumë martesë që vazhdojnë pa u ndarë. Nëse ky kor i madh në këto shtëpi ka arritur përputhshmërinë dhe harmoninë, domethënë, e ka arritur ekuilibrin, zëri shumëngjyrësh “i korit të fëmijëve” e vazhdon ekzistencën me strukturën e tij të zhurmshme si një kor “jo qetësues” por “që bën detyrën e tij” për atë që këndon dhe për atë që dëgjon.

Nëse të tjerët heshtin ose e ulin zërin kur flet ndonjëri i kësaj strukture të zëshme, formohet një ekuilibër i brendshëm. Për shembull, nëse nusja hesht kur flet vjehrra, nëse dhëndri dëgjon kur flet nusja, nëse nusja nuk nxehet dhe nuk ankohet kur flet kunata, ky kor e gjen ekuilibrin e tij dhe episodi vazhdon. Sigurisht që të jetosh këto që thuhet, dihet që nuk janë aq të lehta sa të thuhet apo të shkruhet. Çdo ditë e shikojmë se ky ekuilibër merr vite dhe formohet duke e përjetuar dhe provuar. Derisa të formohet ky

ekuilibër, thyhen shumë zemra, derdhen shumë lot dhe kalojnë shumë vite.

Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve kërkojnë durim dhe përpjekje. Kërkojnë mundësinë e diskutimit të dëshirave reciproke dhe ndryshimit. Kërkojnë qëllim të mirë dhe virtyt. Kërkojnë perceptimin e shpresave që imagjinohen dhe që përjetohej në zemra. Kur njerëzit të kuptojnë shpresat e tyre dhe t’ua bëjnë të qartë bashkëbiseduesve, zhvillohet “të kuptuarit e njëri-tjetrit. Në të kundërt fillojnë “grindjet”.

Grindja dhe ndryshimi

Kordoni e shpreh grindjen si “çasti kur del në pah e vërteta në lidhje”. Grindja ndodhet dhe duhet të ndodhet në strukturën e çdo martesë. Grindja nuk duhet të zhduket, por duhet të administrohet. Bashkimi i dy botëve të ndryshme është një grindje në vetvete. Por kjo grindje është një grindje që mund të shndërrohet në kompromis. Nëse ka kompromis, do të thotë se ka një martesë të lumtur. Nëse nuk ka, grindja ekzistuese kthehet në burim debati, kthehet në zënkë e zhurmë, kthehet në pikëllim dhe humbje.

Me kalimin e kohës, grindjet në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve mund t’i shtjellojmë në vete. Çdokush pret nga tjetri ato që duhet t’i ketë vetë. Shumica dërmuese e çifteve që kanë probleme familjare, aplikojnë për terapi duke thënë:

“I nderuar specialist! Unë kam... halle, por gruaja nuk më kupton. Si mund ta ndryshoj atë?!”

Asnjë fuqi dhe asnjë specialist i suksesshëm, nuk mund ta realizojë ndryshimin nëse nuk duan



individët. Ndryshimi ndodhet në botën e brendshme të njeriut dhe është i lidhur me vullnetin e tij. Gruaja burrin dhe burri gruan e tij, në asnjë mënyrë nuk mund ta ndryshojë me imponim. Nëse ndryshimi bëhet me imponim, atëherë shfaqet dhuna. Me kalimin e kohës, ndoshta mund të “bindet”, por kjo bindje ushqehet me “zemërim” dhe “urrejtje” sapo t’i jepet shansi ngaqë nuk është mbështetur nga vullneti. Nisur nga kjo, ajo e tregon veten me një sjellje tjetër reaguese sapo t’i jepet shansi dhe shpesh herë shfaqet një gjendje patologjike e sëmurë.

Nëse ndryshimi bëhet me dëshirë, shndërrohet jo në zënkë, por në paqe, jo në zemërim, por në dashuri, jo në urrejtje, por në tolerancë. Në shtëpi të tilla ka dashuri dhe mirëkuptim. Shtëpitë në të cilat ka dashuri, e rrisin me dashuri brezin e ri, u japin shpresë për të ardhmen dhe i rregullojnë problemet duke i diskutuar në vend që të sillen sikur nuk ka. Me durim dhe me shpresë...

Ndryshimi bëhet me vullnet dhe ushqehet me sakrificë. Njeriu duhet ta njohë veten, kufijtë dhe ato që (nuk) duhet t’i bëjë dhe vetëm me një aventurë të tillë duhet të bëhet “ne”. Përndryshe, ai që merr përsipër edhe përgjegjësitë që i përkasin palës tjetër dhe e bën këtë me njet të mirë, do të thotë se “i ka marrë përsipër rolet që priten nga pala e kundërt dhe i ka bërë me një dëshirë të madhe”. Ndërsa kjo, të gjitha punët që më parë bëheshin me dëshirë, i kthen në një barrë të përballueshme dhe në një burim dëshpërimi i cili nuk ka emër.

Një detaj dhe pika e këputjes

Detyrat që nuk janë caktuar që në fillim dhe që nuk janë ndarë në mënyrë të barabartë, shpresat dhe të gjitha çështjet që nuk janë diskutuar, nënvlerësohen duke thënë: “Sidoqoftë e gjejnë vendin e tyre me kalimin e kohës!” Por çdo çështje e neglizhuar, rritet me kalimin e kohës dhe kthehet në ortek gjigant nën të cilin mund të mbetesh pa e kuptuar edhe se çfarë është. Çdo gjëje i humb kuptimi, bëhet aq e vogël saqë nuk mund të diskutohet edhe me ato që të rrethojnë dhe këputet me një detaj të parëndësishëm. Ai detaj është detaj ashtu siç edhe quhet. Por ai detaj i vogël mund të jetë ngjarja e fundit që mund të shpie në këputjen e lidhjes dhe pika e fundit që e mbush kupën. Të gjithë thonë diçka dhe komentojnë në lidhje me këtë ngjarje të fundit, japin mendime dhe këshillojnë. Ndërsa çiftet që nuk e kanë gjetur veten dhe që nuk e kanë kuptuar martesën, shpesh herë heshtin, zemërohen ose flasin shumë dhe ankohen gjithmonë. Atëherë, dy njerëzit që përpiqeshin për të qenë “ne”, bëhen dy njerëz të ndarë, madje dy të huaj.

Gabimi më i madh në këtë periudhë është të folurit “rreth ngjarjes që ishte shkak për ndarjen”. Shpesh herë ky proces është shumë rraskapitës... Këtu ka një pikë që kalohet: Ajo ngjarje është vetëm maja e dukshme e ajsbergut. Nën ujë ndodhet një ajsberg shumë i madh i cili nuk mund të imagjinohet. Ky ajsberg është formuar me akumulimin e gjërave të vogla.

Përfundim

Sipas statistikave të institucionit mbi studimet familjare, në çdo dy martesë, ka një divorc. Dome thënë, zemrat e bashkuara me shpresë, e humbin qetësinë, mbruhën me zemërim dhe përfundojnë në urrejtje. Kjo nxjerr në pah “ushtrinë madhështore të të zemëruarve” duke marrë pranë nxehjet dhe lëndimet. Këtyre familjeve të dëshpëruara u shtohen më së paku dy veta.

Sipas Jacobsonit dhe Christensen, “shqetësimi brenda familjes” përkufizohet si vështirësia që përjetojnë bashkëshortët në komunikim dhe në çështjen e zgjidhjes së problemeve, problem që krijohet prej jetesës së përbashkët dhe vështirësia për të pranuar ndryshimin e njëri-tjetrit.

Yelsma është shprehur se shqetësimet ndërmjet bashkëshortëve në martesë, “janë shprehjet verbale që kanë lidhje me raportin verbal, paafësinë për të debatuar, sulmin verbal të tepërt të njërit prej bashkëshortëve kur tjetri sulmon më pak verbalisht, me masën se sa i pranon njëri prej bashkëshortëve shprehjet verbale negative të bashkëshortit tjetër sulmues dhe me sa hidhen pas shpine këto sjellje”.

Martesa e lumtur dhe e qetë, para së gjithash, realizohet me një “komunikim të shëndoshë”. Aq sa është e rëndësishme që shprehjet e komunikimit të përdoren në mënyrë dhe kohë të saktë, po aq është e rëndësishme edhe aftësia e palës së kundërt (bashkëbiseduesit) për të kuptuar. Mesazhi që dërgohet me një gjuhë teknike, së pari duhet të shikohet nga pala e kundërt, pastaj të përvetësohet dhe më në fund të lexohet. Ç’ë do se edhe gjuha e të lexuarit, është shumë e rëndësishme. Në këto shprehje nuk duhet të përdoren shkurtime dhe nuk duhet të neglizhohet asgjë duke menduar se do të kuptohet.

Një shembull

Tani ejani dhe të ndjekim një film:

Kur burri vjen në shtëpi në mbrëmje, gruaja vazhdon të bëjë punët që ka në kuzhinë. Ajo është lodhur shumë gjatë gjithë ditës me punët e shtëpisë dhe fëmijët. Për shkak të punëve të shumta të bashkëshortit, nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë në shëtitjen e fundjavës së të birit që shkon në shkollë. Djali është mërziur për shkak se kanë shkuar të gjithë shokët e tij dhe që nga ajo ditë, vazhdimisht sillet keq. Edhe pak më parë e rrahu vëllain e vogël megjithëse nuk i kishte bërë asgjë. Vëllai i vogël dëshiron ta bëjë përpara syve të të tjerëve më të dhimbshme sjelljen e padrejtë që i bëri vëllai i madh dhe qan duke bërë titur edhe pse nuk e ka vrarë aq shumë. Një kaos i vërtetë...

Punët nuk kanë mbaruar akoma. Gruaja po përgatit tryezën e ushqimit. Në njërin anë përpiqet të zbrazë makinën larëse të enëve dhe në anën tjetër u flet atyre që po grinden. Pastaj në vetvete thotë për bashkëshortin: “Nuk paska pasur kohë për fëmijët për shkak të punëve që nuk mbarojnë! Shiko, fëmija nuk shkoi dot edhe në shëtitje që bëhet një herë në vit. E çfarë? Nuk paska qenë në dijeni për këtë! Ç’është kjo punë kështu? U bë një muaj që djali na tregon datën e shëtitjes...”

Në ato momente bashkëshorti hyn në shtëpi. Në dorë ka qesen e bukës dhe qesen me porositë e disa të tjera që janë mangët. Është lodhur gjatë gjithë ditës. Mbi të gjitha, ditët e fundit është rritur numri i atyre që janë hequr nga puna. Çdo ditë po shtohet numri i shokëve që nuk u rezistojnë kushteve të rënda të punës në kompani. Edhe sot, një i ri i fejuar, doli duke bërë titur me të madhe. Ai mendonte se, sikur i riu të ishte i martuar, nuk do ta ndahej kaq lehtë nga puna. Krahas këtyre mendimeve, në shtëpi nuk donte të shkonte duarbosh. Kështu që i mori ato që i kishin ngelur në mendje dhe u nis për në shtëpi. Kur burri hyri në kuzhinë dhe po kërkonte vend për të lënë qeset, i buzëqesh bashkëshortes dhe e pyet:

-Si je? Pastaj, duke i treguar qesen e bukës që ka në dorë, i thotë:

-Merri këto! Nuk e di ku t’i vendos.

Bashkëshortja vazhdon të mendojë aty ku e la më parë dhe i thotë:

-Sigurisht që nuk mund ta dish. Nëse nuk interesohesh për shtëpinë, nuk mund ta dish... Qoftë edhe një herë nuk u interesove për këtë shtëpi...

Burri nxehet:

-Çfarë? Nuk qenkam interesuar fare?

Gruaja përsëri i thotë: -Po, nuk je interesuar fare!, duke shtuar edhe zemërimin që kishte ndaj fëmijëve më parë...

-Fare?

-Po, fare!

Heshtje... Gruaja hesht dhe është e zemëruar. Ndërsa burri i tensionuar dhe i lënduar... Këto biseda i bëjnë çiftet të mendojnë: “Çfarë po flasim? Si arritëm në këtë pikë?”

Debatet fillojnë në një pikë të paimaginueshme dhe dalin në tema të tjera pa e kuptuar se si ndodh. Edhe kurthet më të mëdha fillojnë këtu. Zemërimet dhe lëndimet burojnë më shumë nga fjalët se sa nga ngjarja për të cilën debatohet. Faktikisht ky është kurthi më i madh i martesave...

Për të mos rënë në kurth, mos u ankoni, por flisni. Dëgjojeni bashkëbiseduesin dhe përsëriteni atë që keni kuptuar.

Dashuria

— Fatma Allada —

Të kujtolesh për të gjitha gabimet e tua...

Të harrosh vdekjen me shpresë se të gjitha mëkatet do të të falen. Një bisedë e sinqertë me një pasqyrë. Ëndrra që fjalja e fundit të shkruhet në një fletë krejt të pastër. Le të jetë një fund që t'i bëjë të gjitha fillimet ta kenë zili...

Një erë që i largon të gjitha erërat e rreme. Një kufi që nuk kalohet dot as nga engjëjt. Një dashuri që nuk të djeg edhe kur e merr parasysh djegien... Edhe në qoftë se ke flatra, nuk fluturon dot drejt zjarrit, sepse gjithmonë një pjesë e jotja shikon drejt ujit.

Të gjithë e përsërisin faktin se zemra është e ndarë në dy pjesë. Kujtojnë se ndarja është she-mbulli i dashurisë më të fuqi-shme. Nuk e dinë se dashuria është pronë e një qenieje supreme dhe të vetme; e që zemrat që ndahen janë shkak për të shkuar drejt njësi-mit.

Kur e shijon begatinë e dashurisë në këtë botë, fillon udhëtimi i vërtetë... Hapet një derë që të merr nga falsiteti për të dërguar tek e vërteta. Disa nuk i shikojnë dyert dhe fiksohen pas të rrejshmes; disa të tjerë ndodhen aty për ta hapur derën. Dashuria është kalimi në botën e Ahiretit para se ta mbushës zemrën me bukuritë e kësaj bote.

Do të vijë dita kur të biesh pre e dashurisë. Kjo është një sprovë për atë që e kupton... Hapja e një dere nuk është e lehtë. Marrja e çelësit është e shoqëruar me dhimbje. Ose e kalon provimin, ose mbetesh. Një pikë loti bëhet një gllënjë uji, të gjithë fitimtarët përcillen për në arsh. Afrohesh me Zotin tënd, Ai t'i tregon të gjitha të fshehtat e jetës. Zemra e ndarë përgjysmë fillon të gjallërohet... Zemra jote e gjen Atë që është i denjë për t'u dashur dhe adhuron vetëm Krijuesin.

Qëllimi yt nuk është një njeri... Ai është vetëm fillimi, është një shkak. Është vetëm një e folur në gjuhën tonë. Një hollësi e jetës sonë.

Duhet kujdes i madh për një zemër që ndjen mall. Duhet të kemi respekt për një zemër të ndarë në dy pjesë. Kush e di, mbase respekti do ta ndihmojë që të hap atë derë që nuk gjendet lehtë. Ka vetëm dy përfundime: ose ankoresh pa pushim për fatin tënd ose vuan në hesh-tje me qetësi, duke e kuptuar vlerën e kësaj dhurate të madhe...

Dashuria i meriton të gjitha lëvdatat. Në këtë univers të krijuar vetëm për hir të dashurisë, jeto më të bukurën e dashurive. Malli që ndjehet për Krijuesin është shkak i çdo gjëje. Ky zakon fillon me një njeri, pastaj zemra nuk mjaftohet me kaq dhe lartësohet drejt qiejve...

Kur jetohet dashuria, lulëzojnë lulet.

Natyra e krijuar nga dashuria të ndihmon. Sytë të tregojnë rrugën që të çon drejt Allahut. Zemra ushqehet me dashuri. Shpirti tashmë është gati për të përjetuar kënaqësi, por edhe dhimbje.

Dashuria duket bukur vetëm tek ata që e meritojnë...





Vlerat e qumshtit të DHISË

Sipas të dhënave qumështi i dhisë përmirëson shëndetin në shumë mënyra të ndryshme.

INFLAMACIONI

Qumështi i dhisë nuk shkakton inflamacion, ndaj rekomandohet për njerëzit që vuajnë nga inflamacioni i zorrëve.

METABOLIZMI

Studimet kanë konfirmuar se qumështi i dhisë rrit përthithjen e hekurit dhe bakrit sidomos tek njerëzit që kanë probleme me tretjen.

I NGJASHËM ME QUMËSHITIN E NËNËS

Një nga vlerat kryesore të qumështit të dhisë është se ngjan shumë me qumështin e gjirit.

Përmbajtja kimike e tij është shumë e përafërt me qumështin e gjirit, ndaj tretet dhe asimilohet më lehtë nga organizmi.

MË PAK YNDYRNA

Sipas informacioneve përmasat e molekulave të yndyrnave tek qumështi i dhisë janë më të vogla se ato tek qumështi i lopës.

Kjo e bën qumështin e dhisë më të lehtë në tretje.

SHUMË ACIDE YNDYRORE

Qumështi i lopës përmban 17% acide yndyrore, ndërsa ai i dhisë plot 35%.

Kjo e bën qumështin e dhisë më të pasur në aspekt ushqyesish.

50% e njerëzve që janë të ndjeshëm ndaj qumështit, e kanë më të lehtë të konsumojnë qumështin

e dhisë se atë të lopës.

Qumështi i dhisë përmban jo vetëm kalçium por edhe triptofan, një amino acid i rëndësishëm për organizmin.

ALERGJITË

Qumështi i lopës ka lidhje më të fortë me alergjitë dhe sekrecionet e tepërta për shkak të molekulave të mëdha të yndyrës.

Qumështi i dhisë nuk shkakton alergji dhe është më i butë me stomakun.

USHQYESIT E PASUR

Qumështi i dhisë është përdorur tradicionalisht për të ushqyer dhe rigjallëruar sistemin nervor.

Ai ka një dendësi të madhe ushqimore dhe në një gotë të vetme plotëson 35 përqind të nevojës ditore për kalçium.

Një gotë me qumësht dhie ofron shumë fosfor, vitaminë B-12, proteinë dhe kalium.

SISTEMI IMUNITAR

Qumështi i dhisë përmban selenium, një mineral i rëndësishëm për sistemin imunitar dhe mbarëvajtjen e organizmit.



Qershia



Qershitë bëjnë të mundur uljen e kolesterolit në trup. Madje ndryshe nga shumë fruta të tjera, për përdoruesit e qershive vjen edhe një lajm i mirë nga mjekësia popullore. Pasi ata mund të hanë sasi të mëdha qershisë dhe të mos shëndoshen, përkundrazi ky frut bën të mundur rënien nga pesha si dhe kontrollojnë nivelin e yndyrave në gjak.

Gjetjet shkencore e viteve të fundit kanë treguar disa veti kimike që përmban qershia si anthocyanins, melatonin, dhe kapacitetin për të absorbuar oksigjen në radikale, që do të thotë se të mirat shëndetësore që na vijnë nga qershia janë shumë të mëdha. Qershitë janë të mira për konsum për shumë arsyeje. Ato kanë kolesterol të ulët dhe janë një burim i vitaminës C, Vitamina A, Perillyl, ellagic acid dhe melatonin.

Qershitë ndihmojnë në problemet e tretjes pasi ato kanë përmbajtje të lartë fijesh, qershia thekshëm ndihmon në dhimbjet e muskujve dhe gjithashtu ndihmon në uljen e niveleve të urateve. Ndihmon gjithashtu në lehtësimin e dhimbjes së vazhdueshme të kokës dhe rrit sasinë e ujit në trupin tuaj e cila në afat të gjatë nxit energjinë e një individi dhe shkallen e metabolizmit. Le të shikojmë se çfarë përbërje të shëndetshme ka qershia.

Qershia është e njohur shkencërisht për flavanoidet antioxidant Bio i gjetur në përbërjen kimike. Këto flavanoidet Bio janë të dobishme në rritjen dhe rregullimin e nivelet e pH në trupin e një individi.

NDIHMION KUJTESËN

Qershitë kanë qenë të njohur për ndihmesën për një memorie të mirë dhe në parandalimin e humbjes së kujtesës. Kjo është vërejtur nga një komponent i gjetur në qershshi i njohur si anthocyanin që është provuar të jetë e mirë për trurin.

RRIT GJUMIN

Kjo është një tjetër veti e qershisë. Njerëzit të cilët konsumojnë qershshi bëjnë gjumë më të thellë se sa ata që nuk i hanë. Kjo është për shkak se qershia përmban një hormon të njohur si melatonin. Melatonin është i njohur për rregullimin të cikleve të gjumit në trup. Për një gjumë më të mirë, më të

relaksuar dhe të kënaqshëm është e këshillueshme konsumimi e qershisë.

KUNDËR PLAKJES

Melatonin gjithashtu vepron si një agjent kundër plakjes dhe ndihmon në ngadalësimin e procesit të plakjes. Kjo do të thotë se njerëzit që hanë qershshi mund të duken më të rinj për një periudhë më të gjatë se sa ata që nuk i konsumojnë.

KUJDESI PËR LËKURËN


Një nga përfitimet e qershive është se në sajë të melatonin është gjetur se ndihmon në dhënien e cilësisë së butë të lëkurës.

TRAJTIMI MJEKËSOR

Trajtimi mjekësor nëpërmjet përdorimit të frutave të qershisë është një praktikë që ka filluar që në kohët e lashta. Sot, të hahet qershshi besohet se lehtëson dhimbjet për ata që vuajnë nga artriti. Gjithashtu, konsumimi i qershisë besohet se trajton të gjitha format e inflamacionit.

PARANDALON SËMUNDJET

Një nga përfitimet e qershive është se ato përmbajnë një substancë të njohur si melatonin, e cila shkatërron organizmat që shkaktojnë sëmundje dhe kështu parandalon marrjen e sëmundjeve. Konsumimi i qershisë rrit shanset për shërimin e çdo sëmundje. Kjo është për shkak se qershitë kanë veti ushqyese që ndihmojnë në luftën kundër të gjithë sëmundjeve.



MIKROBET "SHËTITËSE" NËPËR BOTË

Rreth 20 vjet më parë, shkencëtarët filluan të gjenin viruse të ngjashme gjenetikiisht në mjedise shumë të ndryshme dhe zona të ndryshme në mbarë botën. Tani ata kanë gjetur një përgjigje për këtë zbulim të tyrin:

Shkretëtira me thatësi të Saharës, në fakt është e mbushur me jetë - me jetë mikroskopike. Por këto mikrobe nuk qëndrojnë në rërë.

Miliona lloje virusesh dhe bakteresh, disa prej tyre vdekjeprurëse, shkojnë dhe "fshihen" lart të atmosferës dhe së bashku me copëzat e pluhurit të shkretëtirës, udhëtojnë rreth e rrotull botës.

Një ekip shkencëtarësh nga e gjithë bota, kanë detajuar shpërhapjen e këtyre mikrobeve në një distancë të largët. Nëse ka disa viruse në Shkretëtirën e Saharës, ato mund të shkojnë deri në Amazonë, për shkak të rrymave atmosferike; ose ka disa viruse

nga sipërfaqja e oqeanit që mund të shkojnë deri në Europë.

Shkencëtarët ngritën platforma vëzhgimi në malet Sierra Nevada të Spanjës, ku zbuluan se çdo ditë, në një metër katrore depozitoheshin qindra mijëra bakterie dhe rreth një miliard viruse.

Ata zbuluan se shumica e viruseve shkonin në ajër nga spërkatjet e detit dhe barteshin nga copëza organike më të lehta, duke u mbajtur pezull në ajër.

Shkencëtarët thonë se viruset qëndrojnë sipër në atmosferë për periudha të gjata kohe para se të kthehen në Tokë përmes shiut dhe stuhive të pluhurit.

E rëndësishme se u zbulua një numër jo i vogël, madje numri është shumë i madh dhe mund të gjenden viruse identike, ose thajse identike në vende të ndryshme dhe në kushte tepër të ndryshme.

REZISTENCA NDAJ VAKSINAVE

Vaksinat mund të na mbrojnë nga 23 viruse të ndryshme dhe dy lloje kanceri. Vitet e fundit janë duke u zhvilluar një numër më i madh vaksinash, përfshirë një për virusin HIV, që shkakton SIDË-n. Me gjithë këto përparime, shumë njerëz zgjedhin të mos bëjnë vaksinat as për vete, as për fëmijët:

Punonjësit e shëndetësisë përpiqen së tepërmi për vaksinimin e çdo fëmije kundër poliomeilitit, në mënyrë që asnjë fëmijë të mos vuajë më nga pasojat gjymtuese të kësaj sëmundjeje.



Ka edhe sëmundje të tjera, të cilat mund të eliminohen, si psh fruthi; por edhe pse ekziston një vaksinë shumë e efektshme për fruthin, jo të gjithë fëmijët vaksinohen kundër sëmundjes. Në vendet perëndimore kjo ndodh kryesisht ngaqë prindërit zgjedhin të mos i vaksinojnë fëmijët.

Vitin e kaluar, në Evropë më tepër se 14 mijë njerëz u prekën nga fruthi. Numrin më të madh të rasteve e pati Rumania.

Një studim i ri tregon se në Shtetet e Bashkuara

refuzimi për vaksinat kthehet në prirje infektive: nëse një komunitet refuzon vaksinimin, edhe komunitetet ngjitur ndjekin të njëjtin shembull.

Një numër pacientësh i besojnë keqinformimet që ata lexojnë në internet për lidhjen e pavërtetë mes vaksinave dhe autizimit, megjithëse studimet nuk e provojnë këtë. Pastaj ata përhapin këtë informacion të gabuar tek prindër të tjerë dhe nuk kanë më frikë nga sëmundja.

PËRHAPJA E BAKTERIES REZISTENTE NDAJ ANTIBIOTIKËVE

Shkencëtarët janë të tronditur nga shpejtësia me të cilën rezistenca ndaj antibiotikëve të fuqishëm është në gjendje të përhapet nga kafshët tek njerëzit. Një studim i ri tregon se si rezistenca anti-mikrobike ndaj një ilaçi kyç mund të përhapet nga një fermë derrash në Kinë, tek speciet njerëzore dhe shtazore nëpër botë, brenda një periudhe disa vjeçare.

Kolistin është ilaçi i fundit që përdoret për t'i shpëtuar jetën e njerëzve kur të gjitha ilaçet e tjera dështojnë. Është përdorur pak në klinikë. Dhe pastaj pati disa shqetësime rreth toksicitetit dhe efekteve anësore. U përdor kryesisht në bujqësi, pastaj tek derrat dhe pak tek pulat. Por kohët e fundit, për shkak të mungesës së alternativave të tjera, njerëzit kanë shtuar interesimin në përdorimin e këtij antibiotiku. Sidomos gjatë pesë apo 10 vitet e fundit përdorimi klinik i këtij ilaçi është shtuar shumë", thotë drejtor i institutit të gjenetikës në universitetin e Londrës.

Por edhe ky antibiotik po humbet fuqinë e tij.

Bakteriet vdekjeprurëse si E. Coli ose salmonella mund të zhvillojnë rezistencë ndaj ilaçeve. Një studim i ri i Universitetit të Londrës, ka identifikuar

shpejtësinë me të cilën gjeni i ndryshuar që i reziston kolistin-it u shfaq në mesin e viteve 2000. U shfaq vetëm një herë. Dhe ka shumë të ngjarë të jetë shfaqur tek derrat, ndoshta në Kinë, dhe u përhap me shpejtësi në të gjithë botën. U përhap në lloje të ndryshme të specieve dhe ka prekur edhe njerëzit. Pra, tani e gjejmë atë në shumë prej bakterieve më të rëndësishme me të cilat përballemi në spitale, dhe është absolutisht kudo.

Bakteria rezistente është gjetur edhe në ujërat e detit në plazhet braziliane.

Ky studim u përqendrua vetëm në një gjen rezistent. Shumë bakterie po zhvillojnë forma të tjera të rezistencës.

Shkencëtarët paralajmërojnë kohët e fundit se rezistenca ndaj antibiotikëve mund të çojë në "fundin e mjekësisë moderne". Shkencëtarët po punojnë për "forcimin" e ilaçeve ekzistuese si kolistini për t'i dhënë atyre fuqi shtesë kundër bakterieve rezistuese. Në aspektin afatgjatë, studiuesit thonë se nevojiten më shumë investime në zhvillimin e ilaçeve të reja, si dhe rishikimin e mënyrës se si përdoren antibiotikët në bujqësi dhe në klinika.



Lexo me emrin
e Zotit tënd, i Cili
krijoi (gjithçka),
e krijoi njeriun
nga një droçkë gjaku!
Lexo! Zoti yt është
Bujari më i madh,
i Cili, me anë
të penës ia mësoi,
ia mësoi njeriut
ato që nuk i dinte.

(Ikra, 1-5)